



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në: “Ekonomiks”**

**ofruar nga**

**Universiteti i Tiranës**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

**Prof. As. Anila Boshnjaku**

**Dr. Erinda Imeraj**

**Nëntor/2025**

**Tabela përmbledhëse me të dhënat për programin e studimit Bachelor në: “Ekonomiks”  
ofruar nga Universiteti i Tiranës**

1	IAL aplikues:	Universiteti i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Ekonomiksit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në: “Ekonomiks”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 395, datë 21.09.1991.  UMAS nr. 110, datë 04.03.2022
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr. 297, datë 20.07.2012,
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	Tre vite akademike / 6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 kredite (ECTS)
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe/ Angleze
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	V.a 2022-2023: 49 PAE / 7 PAK V.a 2023-2024: 50 PAE/ 7 PAK V.a 2024-2025: 52 PAE/ 6 PAK
18	Numri i studentëve:	2022-2023:101 studentë; 2023-2024:89 studentë; 2024-2025:84 studentë.
19	Komente / të tjera:	

## **PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Programi i studimit Bachelor në: “Ekonomiks” ofrohet nga Departamenti i Ekonomiksit, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës. Ky është një nga departamentet më të mëdha të fakultetit, me një staf prej 34 pedagogësh efektivë dhe mbajnë tituj akademikë si Profesor, Profesor i Asociuar dhe Doktor Shkencash. Departamenti është themeluar në vitin 1952, duke krijuar një traditë të gjatë në arsimin dhe kërkimin shkencor.

Programi i studimit është i regjistruar sipas Urdhrit nr. 297, datë 20.07.2012, të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Ofrimi i programit të ciklit të parë Bachelor në: “Ekonomiks” ka filluar në vitin akademik 2008–2009. Programi ofrohet me kohë të plotë në gjuhën shqipe, ndërsa që prej vitit 2022 edhe në gjuhën angleze, bazuar në Urdhrin nr. 116, datë 04.03.2022, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Programi është në përputhje me nivelin e gjashtë të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe zhvillohet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, përfshirë VKM nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruar nga IAL”.

Qëllimi i programit është përgatitja e specialistëve me njohuri të thelluara në parimet e ekonomisë, menaxhim dhe metoda sasiore, në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Studentët që diplomohen nga ky program aftësohen të punojnë si këshilltarë ekonomikë, analistë të politikave publike, analistë tregjesh financiare, menaxherë bankash, analistë biznesi, si dhe të ndjekin programe të mëtejshme master.

Kohëzgjatja normale e programit është tre vite akademike dhe realizohet me 180 kredite ECTS. Njësia përgjegjëse për monitorimin e tij është Departamenti i Ekonomiksit. Programi synon të përgatisë specialistë me njohuri të plota në fushën e ekonomiksit, të aftë për analiza ekonomike, modelime statistikore dhe interpretim të fenomeneve makro e mikroekonomike. Studentët pajisen me kompetenca të rëndësishme për tregun e punës, duke krijuar mundësi karriere në institucione publike e private, banka, kompani konsulence dhe organizata ndërkombëtare.

Departamenti i Ekonomiksit bashkëpunon me institucione vendore dhe universitete ndërkombëtare, ndër të cilat: Universiteti i Bambergut (Gjermani), Universiteti Teknik i Budapestit (Hungari), Universiteti i Straffordshire (Britani) dhe Universiteti i Nebraskës (SHBA). Këto bashkëpunime rrisin cilësinë e procesit mësimor dhe ofrojnë mundësi mobiliteti për studentët dhe staf.

Duke u mbështetur në traditën e gjatë akademike, cilësinë e stafit, bazën ligjore të fortë, si dhe bashkëpunimet ndërdisiplinore dhe ndërkombëtare, programi Bachelor në: “Ekonomiks” përfaqëson një program të suksesshëm dhe të kërkuar në tregun e punës, duke kontribuar në formimin e specialistëve të rinj dhe duke forcuar pozitën e Universitetit të Tiranës si qendër ekselence në arsimin e lartë.

## **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;**

Në janar 2025, Departamenti i Ekonomiksit pranë Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti i Tiranës (FEUT), dorëzoi në ASCAL aplikimin për akreditimin e programit të ciklit të parë Bachelor në “Ekonomiks”. Në zbatim të “Manualit për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit, 2017”, ASCAL caktoi dy ekspertë të jashtëm, të cilët kishin detyrën të shqyrtonin dokumentacionin e paraqitur, të realizonin vizitën në institucion dhe të hartonin raportin përfundimtar të vlerësimit.

Grupi i vlerësimit të jashtëm (GVJ) përbëhej nga Prof. As. Anila Boshnjaku, pedagogje në Universitetin Bujqësor të Tiranës, dhe Dr. Erinda Imeraj, pedagogje në Universitetin Epoka. Procesi u mbështet nga Koordinatorja Teknike e ASCAL, Msc. Alma Arapi, e cila siguroi lehtësimin e punës gjatë të gjithë fazave të vlerësimit.

Fillimisht, ekspertëve iu vu në dispozicion dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni. Pas një periudhe kohe të përcaktuar për shqyrtim dhe përgatitjen e pyetjeve, u hartua edhe axhenda e vizitës në institucion. Vizita u zhvillua në datat 17–18 shtator 2025 në ambientet e FEUT, ku grupit të ekspertëve iu krijuan kushte të posaçme për të zhvilluar takimet sipas programit të planifikuar. Dokumentacioni shtesë i kërkuar pas vizitës u vendos në sistemin e informacionit të ASCAL në datën 23.09.2025.

Pas analizimit të materialeve dhe zhvillimit të intervistave me përfaqësues të ndryshëm të institucionit, GVJ përgatiti vlerësimin e programit Bachelor në “Ekonomiks”, në përputhje me standardet përkatëse dhe kriteret e akreditimit. Raporti përfshin gjithashtu një analizë të pikave të forta dhe të aspekteve që kërkojnë përmirësim, si dhe rekomandime konkrete për institucionin. Dokumenti final është produkt i punës së përbashkët të dy ekspertëve dhe pasqyron një qëndrim të unifikuar.

*Universitet i Tiranës”, është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 28.10.2025, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 138 / 12 Prot, datë 28.10.2025. Universiteti i Tiranës, njofton në ASCAL më datë 04.11.2025, me anë të shkresës, datë 09.10.2024 “Kthim përgjigje për Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit”, IAL përcolli komentet me shkresë zyrtare Datë 04.11.2024.*

*Lënda:* Mbi komentet e dërguara nga Departamenti i Ekonomiksit lidhur me Draft- Raportin e vlerësimit të jashtëm të programit të studimit Bachelor në: “Ekonomiks”, ofruar nga Fakulteti i Ekonomisë i Universitetit të Tiranës.

*Nga :* Anila Boshnjaku  
Erinda Imeraj  
Antare të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm

Datë : 10.11.2025

Referuar komenteve të dërguara përmes Memos së datës 04.11.2025, nga departamenti i Ekonomiks, lidhur me Raportin e Vlerësimit të jashtëm për programin e studimit Bachelor në Ekonomiks, Grupi i vlerësimit të jashtëm sqaron si më poshtë:

Për Standardin IV.3 "Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies.", janë bërë të gjitha vlerësimet pozitive, duke konstatuar se: *'FEUT dhe Departamenti i Ekonomiksit kanë siguruar që programi i studimit Ekonomiks të ketë në përgjithësi në dispozicion literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies. Kështu, biblioteka është e pajisur me një numër të konsiderueshëm titujsh, në gjuhën shqipe si edhe në gjuhë të huaja, kryesisht anglisht. Në mënyrë të formalizuar përditësohet fondi.'*

Ne vlerësojmë angazhimin e Departamentit të Ekonomiksit në këtë drejtim për përmirësime të mëtejshme edhe me mbështetjen e projekteve të ndryshme. Por, duke qënë se *pasi* GVJ shqyrtoi svllabuset e lëndëve dhe rezultoi se në disa prej tyre si: Historia e ekonomisë botërore, Mikroekonomi, Statistikë e aplikuar, Menaxhim, Mikroekonomi 2, literatura të mos ishte e përditësuar, **i qëndrojmë konstatimit tonë që "Në disa syllabuse rezulton që literatura të mos jetë e viteve të fundit."**

Për Standardin VI.I "Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit", në RVJ janë bërë të gjitha vlerësimet pozitive , duke konstatuar se: *"Universiteti i Tiranës ka ngritur struktura të qarta dhe ka miratuar instrumente të posaçme për monitorimin dhe vlerësimin e aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik. Roli qendror i Senatit Akademik në sigurimin e cilësisë garanton mbikëqyrjen institucionale. Në këtë kuadër, janë miratuar Rregullorja për Sigurimin e Cilësisë, Manuali i Vlerësimit të Performancës së Personelit Akademik dhe instrumente të tjera që rregullojnë edhe vlerësimin e personelit ndihmës"*.

Por në takimin e realizuar me përfaqësues të NJSBC na rezultoi se ata nuk kishin informacion të plotë . **prandaj i qëndrojmë konstatimit tonë se "Nga takimi me përfaqësues së NJSBC rezultoi se është e nevojshme që ata të kenë një informacion dhe kontribut më të qënësishëm në procesin e vlerësimit të cilësisë dhe raportimet përkatëse sipas shkallës hierarkike dhe të përfshijnë ekspertë të jashtëm në vlerësim".**

*Në përfundim , mendojmë se nuk ka vend për ndryshime në draft RVJ*

## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në: “Ekonomiks”

### I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

<b>Standardi I.1</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, (në vijim, GVJ) shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar nga Institucioni dhe që është pjesë e Dosjes së Vetë Vlerësimit (në vijim DVV), duke konstatuar se programi i studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Ekonomiks”, i ofruar nga Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, është në përputhje me interesat kombëtare dhe me drejtimit strategjike të zhvillimit të arsimit të lartë në vend. Ky program mbështetet në Statutin e Universitetit të Tiranës dhe harmonizohet plotësisht me objektivat institucionale, akademike dhe shkencore të përcaktuara në Strategjinë e Zhvillimit të UT për periudhën 2023–2028, të cilës i kanë paraprirë Strategjia e Zhvillimit 2018–2023 dhe Plani Strategjik për Kërkimin Shkencor 2018–2022.</p> <p>Përfundimi i këtij programi u mundëson studentëve përgatitje solide në fushën e ekonomiksit, duke i pajisur ata me aftësi analitike, mjete për analizën e të dhënave, si dhe me një mënyrë të strukturuar të menduarit kritik. Diplomantët e këtij programi kanë mundësi të gjera punësimi në institucione publike dhe private, organizata kombëtare dhe ndërkombëtare, kompani dhe institucione kërkimore, duke qenë të aftë të kontribuojnë në analizën dhe vlerësimin e problematikave ekonomike bashkëkohore.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>• <i>Regjistrimi i formës të diplomave të programeve të studimit Bachelor të UT-së.pdf</i></li><li>• <i>Propozim për hapjen e programit të studimit.pdf</i></li><li>• <i>Statuti UT.pdf</i></li><li>• <i>Strategjia kombëtare e arsimit.pdf</i></li><li>• <i>Strategjia e Zhvillimit e UT-së.pdf</i></li></ul>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e	Programi i studimit Bachelor në: “Ekonomiks” në FEUT është konceptuar dhe zhvilluar në përputhje të plotë me misionin e UT, të përcaktuar në Statut (neni 5), ku theksohet se: “Universiteti kontribuon në zhvillimin e shoqërisë përmes tri

<p>institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>shtyllave të misionit të arsimit të lartë publik: kërkimi shkencor, edukimi dhe shërbimi ndaj publikut, të cilat vazhdimisht e pasurojnë dhe informojnë njëra-tjetrën.”</p> <p>Përputhshmëria e programit me misionin institucional mbështetet edhe nga dokumentet strategjike të shqyrtuara nga GVJ, si Strategjia e Zhvillimit të UT 2023–2028, Rregullorja e UT, si dhe Plani i Zhvillimit i Departamentit të Ekonomiksit. Ky i fundit nënvizon se “Qëllimi kryesor i planit strategjik të departamentit është përcaktimi i drejtimeve kryesore për zhvillimin e departamentit në përputhje me strategjinë e zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2023–2028, si dhe përcaktimi i prioriteteve dhe masave konkrete që do të ndërmerren nga departamenti” (fq. 3).</p> <p>Këto dokumente dëshmojnë qartë se fusha e veprimtarisë së programit të studimit është plotësisht e harmonizuar me atë të institucionit, duke siguruar koherencë ndërmjet objektivave akademike dhe misionit të përgjithshëm të UT.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Statuti UT.pdf</i></li> <li>• <i>Strategjia e Zhvillimit e UT-së.pdf</i></li> <li>• <i>Rregullorja e Universitetit të Tiranës.pdf</i></li> <li>• <i>Studimi i tregu të punës të UT-së.pdf</i></li> <li>• <i>Studim i tregut të punës i Departamentit të Ekonomiksit.pdf</i></li> <li>• <i>Plani i Zhvillimit i Departamentit të Ekonomiksit.pdf</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.</p>	<p>GVJ konstatoi se përmbajtja e DVV-së në lidhje me këtë kriter është e plotë dhe gjithëpërfshirëse. Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në: “Ekonomiks”, i ofruar nga FEUT, është konceptuar dhe zhvilluar mbi bazën e dokumenteve kryesore të zhvillimit institucional. Ky program lidhet ngushtë me vizionin, prioritetet dhe objektivat e përcaktuara në Strategjinë e Zhvillimit të UT 2023–2028, në Statutin dhe në Rregulloren e universitetit. Në rregullore është parashikuar një gamë e gjerë profesioneve dhe drejtimeve akademike, brenda të cilave bën pjesë edhe fusha e ekonomiksit.</p> <p>Në Strategjinë e Zhvillimit të UT theksohet si objektivi kryesor përmirësimi i cilësisë së arsimit dhe nxitja e inovacionit në procesin e studimeve. Po ashtu, ndër synimet kryesore të saj janë fuqizimi i kërkimit shkencor dhe arritja e ekselencës akademike. Këto objektiva gjejnë pasqyrim të drejtpërdrejtë në</p>

	<p>strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit në Ekonomiks, i cili u ofron studentëve përgatitje të avancuar teorike dhe praktike, duke i orientuar drejt një formimi të qëndrueshëm profesional dhe akademik.</p> <p>GVJ vlerëson se ky program është plotësisht në funksion të realizimit të misionit dhe vizionit institucional të UT, duke kontribuar njëkohësisht në zhvillimin e kapitalit njerëzor, në mbështetjen e inovacionit dhe në përforsimin e rolit të kërkimit shkencor në shërbim të shoqërisë. Për këtë arsye, GVJ shprehet se kriteri përmbushet në mënyrë të plotë.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Statuti UT.pdf</i></li> <li>• <i>Strategjia e Zhvillimit e UT-së.pdf</i></li> <li>• <i>Rregullorja e Universitetit të Tiranës.pdf</i></li> <li>• <i>Plani i Zhvillimit i Departamentit të Ekonomiksit.pdf</i></li> <li>• <i>Strategjia institucionale për mësimdhënien në UT.pdf</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Institucioni demonstroi se zotëron përvojën, kapacitetet dhe burimet e nevojshme për ofrimin e programit të studimit Bachelor në: “Ekonomiks”. Departamenti i Ekonomiksit, me një traditë që prej vitit 1952, ka krijuar një profil të konsoliduar akademik, i mbështetur nga një staf me kualifikime të larta shkencore dhe përvojë të gjatë pedagogjike. Programi është ndërtuar mbi bazën e dokumenteve themelore të UT, si Statuti, Strategjia e Zhvillimit 2023–2028 dhe planet zhvillimore të departamentit, duke garantuar përputhje me vizionin institucional dhe prioritetet kombëtare për arsimin e lartë. Përmbajtja e tij akademike është e gjerë dhe e balancuar, duke integruar njohuritë bazë të ekonomiksit me lëndë të specializuara, kërkim shkencor dhe zhvillim aftësisht praktike. Këto elemente dëshmojnë se institucioni ka aftësinë të ofrojë një program cilësor, që i përgjigjet standardeve akademike dhe nevojave të tregut të punës.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Statuti UT.pdf</i></li> <li>• <i>Plani i Zhvillimit i Departamentit të Ekonomiksit.pdf</i></li> <li>• <i>Tabelat përmbledhëse.pdf</i></li> <li>• <i>Plani Mesimor Bachelor në Ekonomiks.pdf</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 5.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën</p>	<p>Programi i studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Ekonomiks”, i ofruar nga Departamenti i Ekonomiksit në FEUT, rezulton të jetë në përputhje të plotë me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë bazë përgjegjëse. Qëllimi i tij është formimi i specialistëve në fushën e ekonomisë, përmes ofrimit të</p>

<p>akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>njohurive teorike dhe praktike që pasqyrojnë kërkesat e tregut të punës dhe zhvillimet social-ekonomike të vendit. Programi zhvillohet me kohë të plotë, në gjuhën shqipe, dhe siguron 180 kredite ECTS, duke respektuar standardet e përcaktuara në direktivat kombëtare dhe evropiane për arsimin e lartë. Bazuar në Urdhrin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr. 297, datë 20.07.2012, programi është regjistruar me kodin 000618.</p> <p>Gjatë vizitës u evidentua nga GVJ mungesa e paraqitjes së kodit të ri të programit, sipas Vendimit Nr. 310, datë 11.5.2022, "Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Në dokumentacionin shtesë është dorëzuar kodi i propozuar nga Departamenti 636BA0311S, në përputhje me vendimin e sipërpërmendur, por dokumentacioni mbetet ende i paplotësuar me vendimin përfundimtar të miratimit të kodit.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Strategjia e Zhvillimit e UT-së.pdf</i></li> <li>• <i>Plani i Zhvillimit i Departamentit të Ekonomiksit.pdf</i></li> </ul>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ, pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga institucioni në DVV dhe të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB) të përgatitur për këtë standard, konstaton se ky i fundit është përpiluar në mënyrë të saktë, të plotë dhe me referenca të qarta e lehtësisht të aksesueshme.</p> <p>Nga analiza rezulton se programi i studimit Bachelor në: "Ekonomiks" është i ndërtuar në përputhje me vlerat dhe prioritetet e zhvillimit të vendit, ndërsa institucioni zotëron përvojën, kapacitetet njerëzore dhe infrastrukturën e nevojshme për ofrimin cilësor të tij. Njësia kryesore (FEUT) dhe njësia bazë (Departamenti i Ekonomiksit) paraqesin një koherencë të plotë me fushën akademike e kërkimore, si dhe me drejtimet strategjike ku ky program bën pjesë.</p> <p>Dokumentacioni mbështetës (Statuti, rregulloret dhe planet strategjike) është i përgatitur në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe i strukturuar sipas objektivave zhvillimore.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<b>Standardi I.2</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimin profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	<p>Nga analiza e Statutit të Institucionit (Kreu II) dhe Rregullores së UT (Kreu III), GVJ vëren se në këto dokumente janë përcaktuar qartë elementë kyç të funksionimit institucional, si organizimi, struktura, detyrat, përgjegjësitë dhe bashkëpunimi ndërmjet njësive përbërëse. Secila prej këtyre njësive gëzon liri akademike dhe organizative (neni 7 i Statutit) për të zhvilluar veprimtaritë mësimore, kërkimore-shkencore, inovative dhe krijuese, në përputhje me misionin dhe objektivat e institucionit. Statuti (nenet 12 &amp; 14) përshkruan në mënyrë të detajuar përgjegjësitë e fakulteteve dhe departamenteve, ndërsa rregullorja institucionale përcakton më tej organizimin, përbërjen, funksionimin dhe përgjegjësitë e komisioneve të përherëshme në nivel institucional dhe fakulteti. Rregullorja e njësive bazë mbështet ndarjen e detyrave brenda departamentit, duke siguruar funksionim të qartë e transparent.</p> <p>Gjithashtu, GVJ konstaton se njësia bazë angazhohet rregullisht në analiza vjetore të punës, të zhvilluara në mbledhjet e thirrura nga Dekanati dhe përgjegjësi i Departamentit, ku trajtohen aspektet e procesit të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.</p> <p>Në përfundim, GVJ konfirmon se ky kriter është plotësisht i përmbushur.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Statuti UT.pdf</i></li> <li>• <i>Rregullore e Universitetit të Tiranës</i></li> <li>• <i>Rregullorja për sigurimin e cilësisë në UT</i></li> <li>• <i>Rregullore për organizimin dhe funksionimin e NJSBC</i></li> <li>• <i>Manual i sigurimit të cilësisë UT</i></li> <li>• <i>Manual i vlerësimit të personelit akademik</i></li> <li>• <i>Paketa e instrumenteve të cilësisë</i></li> <li>• <i>Raporti Vjetor i Departamentit</i></li> </ul>
<b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të	GVJ konstaton se sipas pikës 4 në Strategjinë e Zhvillimit Institucional, në UT është në fokus përforsimi i angazhimit shoqëror, shtrirjes dhe dukshmërisë me synim të ketë ndikim

<p>studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>mbi shoqërinë nëpërmjet aktiviteteve të tij në veçanti duke arsimuar novatorët e rinj, duke paraqitur gjetjet e hulumtimit tek publiku i gjerë dhe gjithashtu nëpërmjet rritjes së aktiviteteve të transferimit të njohurive dhe projekteve të bashkëpunimit me ekonominë.</p> <p>Gjithashtu sipas Planit Strategjik të Departamentit të Ekonomiksit, Prioriteti 4 është: Forcimi i ndërveprimit me Biznesin, Sektorin Publik dhe Shoqërinë ku disa nga synimet e këtij prioriteti janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Lidhja sa më e mirë e kurrikulës mësimore me Nevojat e Biznesit,</li> <li>• Nxitja e programeve të praktikave të paguara për të motivuar studentët të angazhohen më shumë në tregun e punës,</li> <li>• Futja e mentorship-it nga drejtues biznesesh,</li> <li>• Partneritete për Kërkime dhe Projekte të Përbashkëta,</li> <li>• Përfshirja e Studentëve në Projekte,</li> <li>• Kontributi në Politikat Publike.</li> </ul> <p>Aktualisht Fakulteti i Ekonomisë ka nënshkruar 45 marrëveshje ndërinstucionale me institucione vendase (Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Instituti i Statistikave – INSTAT, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, AKSHI, bankat e nivelit të dytë, bizneset etj.), dhe 26 marrëveshje ndërinstucionale në fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit (Universiteti i Torinos, Universiteti i Beogradit, Universiteti i Poitiers – Francë, ISCTE Business School, Universiteti i Pavidas, Universiteti i Luksemburgut etj.). Një listë e plotë e marrëveshjeve në kuadrin institucional është pjesë e DVV.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Marrëveshjet ndërinstucionale</i></li> <li>• <i>Mobilitete personeli akademik</i></li> <li>• <i>Studentë FE Erasmus</i></li> <li>• <i>Mobilitete Studentë të huaj në FE</i></li> <li>• <i>Strategjia e Zhvillimit e UT-së 2023 - 2028</i></li> <li>• <i>Projekte ndërkombëtare që zbatohen në UT</i></li> <li>• <i>Plani i Zhvillimit i Departamentit të Ekonomiksit</i></li> <li>• <i>Tabela Përmbledhëse</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan</p>	<p>Nga lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit në nivel njësie kryesore, GVJ konstaton shumë institucione me të cilat mundësohet bashkëpunimi për realizimin e praktikave</p>

<p>marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>profesionale dhe mësimore, si INSTAT, Ministria e Financave dhe Ekonomise, AKSHI apo dhe banka te ndryshme te nivelit te dytë, etj. Përmbajtja e këtyre marrëveshjeve është dorëzuar e plotë në DVV dhe mesa GVJ konstaton, aty parashikohet bashkëpunimi për të mundësuar punën në praktikë të studentëve të FEUT, përfshi edhe studentët e programit të studimit Bachelor në: “Ekonomiks”. Stafit akademik konfirmoi gjatë vizitës në Institucion bashkëpunimin e ngushtë me aktorët e tregut në favor të rritjes së cilësisë së aktivitetit mësimor për studentët e këtij program studimi.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Marrëveshjet ndër-institucionale</i></li> <li>• <i>Aktivitete projekti Integrimi i vendeve të Ballkanit Perëndimor në këndvështrimin e konkureshmërisë dhe efijencës ekonomike</i></li> <li>• <i>Tabelat përmbledhëse</i></li> </ul>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi DVV si dhe nga takimi në institucion rezulton se Departamenti i Ekonomiksit analizon dhe shqyrton në raportet periodike edhe ecurinë dhe realizimin e marrëveshjeve në funksion të programit si nëpërmjet kontakteve me partnerë ashtu edhe në takime të specialisteve të këtyre të fundit me stafin dhe studentet.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Raporti i Vetëvlerësimit të Brendshëm</i></li> </ul>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Mbështetur në shqyrtimin e dokumentacionit të DVV, konstatohet se Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamenti i Ekonomiksit (FEUT) zhvillojnë bashkëpunime të gjera si brenda ashtu edhe jashtë institucionit. Sipas GVJ, janë nënshkruar shumë marrëveshje bashkëpunimi me institucione të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit, si edhe me kompani e biznese. Këto marrëveshje synojnë garantimin e një procesi mësimor të plotësuar me aktivitete mbështetëse, si praktika profesionale, konferenca dhe leksione të hapura, në funksion të arritjes së objektivave të programit.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
--	----------------	-----------------------	----------------------	-----------------------

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I				X
--------------------------------------------------	--	--	--	---

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1 Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Duke u mbështetur në dokumentacionin e dorëzuar, përfshirë Planin Mësimor, Rregulloren e Programit të Studimit, Rregulloren e Universitetit dhe Raportin e Vlerësimit të Brendshëm, GVJ vlerëson se programi i studimit Bachelor në: “Ekonomiks”, i ofruar nga FEUT, është i strukturuar në lëndë të vlerësuara me kredite dhe është i harmonizuar me kërkesat e legjislacionit kombëtar në fuqi (Ligji nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë”) si edhe me parimet e Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi zhvillohet me kohë të plotë në gjuhën shqipe, ka një kohëzgjatje trevjeçare të organizuar në gjashtë semestra, dhe në përfundim të tij studenti akumulon 180 kredite (mesatarisht 60 kredite në vit), duke përfituar diplomën universitare Bachelor në: “Ekonomiks”.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Statuti UT.pdf</i></li> <li>• <i>Rregullorja e Universitetit të Tiranës.pdf</i></li> <li>• <i>Rregullore e programit Bachelor FEUT.pdf</i></li> <li>• <i>Plani Mesimor Bachelor në Ekonomiks.pdf</i></li> <li>• <i>Tabelat përmbledhëse.pdf</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike</p>	<p>GVJ konfirmon se në Rregulloren e programit (neni 5) përcaktohet qartësisht se programet e studimit të ciklit të parë synojnë të ofrojnë njohuri themelore mbi metodat dhe parimet shkencore të përgjithshme, si edhe aftësi të nevojshme për një gamë të gjerë profesionistësh dhe specialitetesh. Po ashtu, aty theksohen misioni dhe objektivat e programit, të cilat sipas vlerësimit të GVJ, janë në përputhje me përgatitjen e studentëve si specialistë të fushës së ekonomiksit.</p>

<p>të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Analiza e Planit Mësimor tregon se programi i studimit Bachelor në: “Ekonomiks” përfshin një kombinim të lëndëve dhe moduleve të detyrueshme dhe me zgjedhje, duke mbuluar në mënyrë të plotë disiplinën kryesore dhe fusha të tjera të lidhura si financa, menaxhimi, marketingu, matematika dhe statistika. Si program i nivelit 6-të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), ai synon të transmetojë njohuri bazë mbi metodat dhe parimet shkencore, si edhe të zhvillojë aftësi specifike që i përgatisin studentët për një spektër të gjerë profesionesh dhe specialitetesh.</p> <p>Gjithashtu, përmbajtja e syllabuseve dhe programeve lëndore të shqyrtuara nga GVJ dëshmon se studentët fitojnë kompetenca profesionale dhe akademike, si edhe njohuri të aplikuara për adresimin e problematikave të ndryshme që lidhen me drejtimin ekonomik të njësive publike dhe private.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Rregullore e programit Bachelor FEUT.pdf</i></li> <li>• <i>Plani Mesimor Bachelor në Ekonomiks.pdf</i></li> <li>• <i>Syllabuset e lëndëve.pdf</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Mbështetur në pasqyrën e hartuar nga institucioni “Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese” evidentojmë se organizimi i kurrikulës respekton kriteret e përcaktuara në VKM nr 41, datë 25.01.2018 sipas tipit të veprimtarisë nga A tek E si më poshtë:</p> <p>Lëndët e kategorisë A zënë 18.33 % të numrit të krediteve ndaj nivelit maksimal prej 20 % që është kriteri;</p> <p>Lëndët e kategorisë B zënë 52.78 %; të numrit të krediteve ndaj nivelit maksimal prej 55 % që është kriteri;</p> <p>Lëndët e kategorisë C zënë 15.56 %; të numrit të krediteve ndaj nivelit maksimal prej 15 % që është kriteri;</p> <p>Lëndët e kategorisë D zënë 10 %; të numrit të krediteve ndaj nivelit maksimal prej 15 % që është kriteri;</p> <p>Lëndët e kategorisë E zënë 3.33 %; të numrit të krediteve ndaj nivelit maksimal prej 5 % që është kriteri;</p> <p>Gjithashtu, për programet e studimit Bachelor përqindja totale e lëndëve të kategorive A dhe B nuk duhet të jetë më pak se 70%, kriter ky që përmbushet nga ky program studimi, ku kategoritë A dhe B së bashku përfaqësojnë 71.11% të krediteve.</p>

	<p>Bazuar në kriteret e miratuara për një program Bachelor shohim se struktura e programit përmbush kriteret e vendosura.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Rregullore e programit Bachelor FEUT.pdf</i></li> <li>• <i>Plani Mesimor Bachelor në Ekonomiks.pdf</i></li> <li>• <i>Tabelat përmbledhëse.pdf</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmblyëse.</p>	<p>Në Planin Mësimor të programit të studimit parashikohet zhvillimi i Praktikës Profesionale në semestrin e gjashtë, e cila është vlerësuar me 3 ECTS dhe i përket lëndëve të kategorisë D. Gjithashtu, detyrimi përmblyës i programit realizohet në formën e Mikrotezës, e cila sipas Planit Mësimor mbart 6 kredite. GVJ vlerëson se ky kriter është i përmbushur, megjithatë sugjeron rishikimin e volumit të orëve të planifikuara për Praktikën Profesionale dhe të ngarkesës në kredite, me qëllim që t'i jepet një peshë më e madhe këtij komponenti praktik. Ky rekomandim mbështetet edhe nga gjetjet e Studimit të Tregut të Punës të realizuar nga Departamenti.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Rregullore e programit Bachelor FEUT.pdf</i></li> <li>• <i>Plani Mesimor Bachelor në Ekonomiks.pdf</i></li> <li>• <i>Rregullore e diplomimit.pdf</i></li> <li>• <i>Studim i tregut të punës i Departamentit të Ekonomiksit.pdf</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 5.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Nga shqyrtimi i Rregullores së Institucionit dhe të Programit Bachelor, konkretisht Kreu III, GVJ konstaton se organizimi i studimeve në programet e ciklit të parë është i strukturuar në 180 kredite, me kohëzgjatje normale jo më pak se tre vite akademike, duke respektuar plotësisht kërkesat ligjore në fuqi. Procesi i pranimit në këto programe, si edhe planifikimi i kuotave, realizohet në përputhje me dispozitat ligjore. Kuotat për çdo program studimi propozohen nga departamenti përkatës dhe miratohen nga Senati Akademik.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Rregullorja e Universitetit të Tiranës.pdf</i></li> <li>• <i>Rregullore e programit Bachelor FEUT.pdf</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë</p>	<p>FEUT ofron programin e studimit <b>Bachelor në: “Ekonomiks”</b> prej vitit 1991, duke qenë ndër institucionet e para që e kanë integruar këtë drejtim. Nga informacioni i</p>

<p>studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>vlerësuar nga GVJ, rezulton se programi Bachelor me këtë emërtim në institucionet e tjera të arsimit të lartë në Shqipëri zhvillohen në disa prej tyre. Përmbajtja e programit përmban në pjesën me të madhe lëndë që zhvillohen në programe të ngjashme Bachelor brenda vendit (mbi 70 % e programit është e njëjtë).</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Plani Mesimor Bachelor në Ekonomiks.pdf</i></li> <li>• <i>Tabelat përmbledhëse.pdf</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 7.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Mbështetur në raport, programi rezulton i pajisur me kod, në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 80/2015. Megjithatë, në kuadër të procesit të kodifikimit të parashikuar nga VKM nr. 310, datë 11.05.2022, GVJ konstaton se ky proces nuk është pasqyruar në raport dhe as në dokumentacionin shoqëruar të dorëzuar. Në dokumentacionin shtesë është dorëzuar kodi i propozuar nga Departamenti 636BA0311S, në përputhje me vendimin e sipërpërmendur.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Raporti i Vetëvlerësimit të Brendshëm</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 8.</b> Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjisllacionin në fuqi.</p>	<p>NA</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ, mbështetur në shqyrtimin e dokumentacionit dhe të dhënave të dorëzuara, konstaton se programi i studimit Bachelor në: "Ekonomiks" i ofruar nga FEUT është i përputhur me legjisllacionin kombëtar në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Elementet përbërëse të tij janë të përcaktuara qartë dhe të bëra publike përmes Planit Mësimor, Rregullores së Programit dhe rregulloreve institucionale, duke garantuar transparencë dhe qartësi për studentët dhe palët e interesuara. Programi synon përgatitjen e specialistëve të aftë në fushën e ekonomiksit, duke ofruar njohuri të avancuara dhe aftësi analitike e praktike të domosdoshme për përballjen me sfida komplekse profesionale.</i></p>

	<p><i>GVJ vlerëson se programi përfshin në mënyrë të qartë praktikën profesionale dhe detyrimet përmblylëse, të cilat përbëjnë një komponent thelbësor të formimit akademik dhe profesional të studentëve. Megjithatë, sugjerohet rishikimi i peshës së praktikës profesionale, me qëllim që të reflektojë më mirë kërkesat e tregut të punës dhe të rrisë ndikimin e saj në procesin e diplomimit.</i></p> <p><i>Në përfundim, GVJ konfirmon se programi përmbush kriteret e përcaktuara, duke garantuar bazën ligjore, organizative dhe akademike për ofrimin e tij, ndërkohë që sugjerimet e mësipërme synojnë përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë dhe përputhjes me standardet kombëtare dhe evropiane.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi II.2</b>	
<b>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në: “Ekonomiks” është FEUT, i cili ushtron funksionet dhe detyrat e tij në përputhje me legjislacionin në fuqi. UT ka kaluar me sukses akreditimin institucional me Vendim nr. 4, datë 27.01.2023, ndërsa aktualisht është i përfshirë në procesin e akreditimit të programeve të studimit.</p> <p>FEUT përbëhet nga gjashtë njësi bazë, të cilat përmbushin kriteret ligjore të përcaktuara në nenin 23 të Ligjit nr. 80/2015: Departamenti i Ekonomiksit; Departamenti i Financës; Departamenti i Kontabilitetit; Departamenti i Marketing Turizmit; Departamenti i Menaxhimit; si dhe Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar.</p> <p>Pas shqyrtimit të të dhënave mbi përbërjen e stafit efektiv dhe atij me kontratë, GVJ vlerëson se njësia kryesore (FEUT) dhe njësia bazë përgjegjëse për programin (Departamenti i Ekonomiksit) përmbushin plotësisht kërkesat ligjore dhe akademike për numrin dhe nivelin e kualifikimit kualifikimit të stafit akademik të brendshëm (PAE) dhe atë me kontratë (PAK) siç shihet edhe më poshtë.</p> <p>Stafi akademik në Fakultetin e Ekonomisë për vitin akademik</p>

2024-2025 është si më poshtë vijon:

Tituj/Grada	2024-2025	
	PAE	PAK
Prof.dr	28	6
Prof.Asc.Dr	50	12
Dr/Doc	41	40
Dr.proc	49	48
Msc	0	115
<b>Totali</b>	<b>168</b>	<b>221</b>

Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në: “Ekonomiks” në FEUT është Departamenti i Ekonomiksit. Referuar të dhënave të RVB, GVJ konstaton se kjo njësi bazë përmbush kërkesat ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të stafit akademik të brendshëm (PAE) dhe atë me kontratë (PAK). Gjatë vitit akademik më të fundit 2024-2025 (sipas tabelës 1 në RVB) ky departament ka 36 PAE (Gjatë këtij viti, dy profesorë – Prof. Dr. Dh. Kule dhe Prof. Dr. R. Duka – kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës si PAE dhe janë miratuar si PAK) dhe 11 PAK që qëndrojnë në raportet 77%/23%; gjatë vitit akademik 2023 – 2024 janë 37 PAE dhe 11 PAK (77%/23%); gjatë vitit akademik 2022 – 2023 janë 37 PAE dhe 14 PAK (73%/27%). Strukturimi i stafit akademik sipas kualifikimit të tyre paraqitet në detaje në tabelën më poshtë.

Kualifikimi i stafit akademik të Departamentit Financë Kontabilitet	2022-2023		2023-2024		2024-2025	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof. Dr	5		5		5	1
Prof. Asoc.	11		11		14	1
Dr/Phd	14	4	14	3	10	2
Dr. Proc.	7		7		7	4
Msc.	0	10	0	8	0	3
<b>Gjithsej</b>	<b>37</b>	<b>14</b>	<b>37</b>	<b>11</b>	<b>36</b>	<b>11</b>

	<p>Numri dhe raporti i orëve mësimore të realizuara nga stafet akademike PAE / PAK në tre vitet e fundit akademike (sipas të dhënave të tabelës 12 në RVB) është në përputhje me kërkesat sipas legjislacionit në fuqi sipas të cilit PAE duhet të realizojnë të paktën 75% të ngarkesës mësimore në auditor.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Rregullorja e Universitetit të Tiranës.pdf</i></li> <li>• <i>Tabelat përmbledhëse.pdf</i></li> <li>• <i>Raporti Vjetor i Departamentit të Ekonomiksit.pdf</i></li> <li>• <i>Programet FE 2023-2024.pdf</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p><i>GVJ vëren se përgjigjja e dhënë në RVB nuk është plotësisht relevante me Kriterin nr. 2.</i></p> <p>Bazuar në organogramën e institucionit, shihet se FEUT ka angazhuar personel ndihmës akademik për të mbështetur nevojat e përgjithshme të programeve të studimit që ofron. Angazhimi i këtij personeli rregullohet dhe garantohet nga Statuti dhe rregulloret e institucionit. Sipas Seksionit II të Statutit, personeli ndihmës akademik është pjesë e Departamentit dhe shërben në funksion të njësisë bazë ku është atashuar. Në Tabelën 1 të RVB-së tregohet se FEUT ka gjithsej 7 persona ndihmës akademik, ndërsa Departamenti i Ekonomiksit ka angazhuar 1 person ndihmës akademik për vitin akademik 2024–2025.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Rregullorja e Universitetit të Tiranës.pdf</i></li> <li>• <i>Tabelat përmbledhëse.pdf</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Në UT, përgjegjësi i Departamentit është mbikëqyrësi kryesor i programeve të studimit që ofrohen brenda tij. Sipas Nenit 14, pika 5 të Statutit dhe Nenit 25 të Rregullores së njësisë bazë, njësia bazë e zhvillimit të programit ngarkohet me caktimin e koordinorit të programit të studimit. Koordinatori mund të jetë përgjegjës i njësisë bazë ose një anëtar i personelit akademik të kësaj njësie, me të paktën gradën shkencore "Doktor Shkencash". Sipas këtij neni, koordinori i programit të studimit është përgjegjës për monitorimin dhe drejtimin e aktiviteteve arsimore dhe kërkimore-shkencore, mban dhe arkivon dokumentacionin e veprimtarisë akademike dhe shkencore të personelit, si dhe shërben si koordinori i programit të studimit. Në përputhje me përshkrimin e</p>

	<p>përgjegjësi të koordinatorit të programit, GVJ konfirmon përmbushjen e plotë të këtij kriteri.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Statuti UT.pdf</i></li> <li>• <i>Rregullorja e Universitetit të Tiranës.pdf</i></li> <li>• <i>Vendim për emërtimin e koordinatorit të programit të studimit.pdf</i></li> </ul>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ shqyrtoi dokumentacionin e DVV dhe konfirmoi gjatë vizitës në institucion se njësi kryesore/bazë që ofron programin e studimit Bachelor në: "Ekonomiks" në FEUT përmbush kërkesat ligjore në lidhje me organizimin në struktura përbërëse, numrin e stafit akademik efektiv dhe me kontratë, si dhe nivelin e kualifikimit të tyre, sipas raporteve përkatëse. Për të arritur objektivat e programit, institucioni angazhon gjithashtu personel ndihmës akademik dhe administrativ, detyrat e të cilëve përcaktohen qartë në rregulloret përkatëse. Përgjegjësi i Departamentit ushtron edhe funksionin e koordinatorit të programit, duke mbikëqyrur mbarëvajtjen e programit Bachelor në: "Ekonomiks" në FEUT.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi II.3</b>	
<b>Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga FEUT si njësi kryesore dhe nga Departamenti i Ekonomiksit si njësi bazë, si dhe nga verifikimi gjatë vizitës në institucion, konstatohet se këto njësi disponojnë informacionin e nevojshëm mbi organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. Ky informacion nuk shërben vetëm si evidencë, por është gjithashtu i aksesueshëm për gjithë stafin akademik. Ai përfshin të dhëna të plota mbi programin, si dhe të gjithë bazën rregullative në nivel institucioni, fakulteti, departamenti dhe programi. Gjithashtu, informacioni është i aksesueshëm edhe për studentët e programit përmes website-it të FEUT.</p>

	<p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Statuti UT.pdf</i></li> <li>• <i>Rregullorja e Universitetit të Tiranës.pdf</i></li> <li>• <i>Rregullore e programit Bachelor FEUT.pdf</i></li> <li>• <a href="http://www.feut.edu.al">www.feut.edu.al</a></li> </ul>																			
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i Planit Mësimor të programit Bachelor në: “Ekonomiks” në FEUT (tabela 10 në RVB), GVJ konstatoi se dokumenti siguron informacion të detajuar mbi ngarkesën mësimore dhe aktivitetet e saj, duke përfshirë orët në auditor, aktivitetet jashtë auditorit (në terren) dhe mësimin individual për çdo lëndë, të organizuara sipas semestrave dhe viteve akademike.</p> <p>Numri dhe raporti i orëve mësimore të realizuara nga stafet akademike PAE / PAK në tre vitet e fundit akademike (sipas të dhënave të tabelës 12 në RVB) jepet në vijim dhe është në përputhje me kërkesat sipas legjislacionit në fuqi sipas të cilit PAE duhet të realizojnë të paktën 75% të ngarkesës mësimore në auditor.</p> <table border="1" data-bbox="592 1086 1372 1500"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Orë mësimore</th> <th colspan="3">Programi i Ekonomiks</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>Totali orë në auditor</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2022 – 2023</td> <td>3.375 orë në auditor (78%)</td> <td>975 orë në auditor (22%)</td> <td>4.350</td> </tr> <tr> <td>2023 – 2024</td> <td>3.555 orë në auditor (82%)</td> <td>765 orë në auditor (18%)</td> <td>4.320</td> </tr> <tr> <td>2024 – 2025</td> <td>3.510 orë në auditor (83%)</td> <td>735 orë në auditor (17%)</td> <td>4.245</td> </tr> </tbody> </table> <p>GVJ vëren se ky kriter është i përmbushur</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Rregullore e programit Bachelor FEUT.pdf</i></li> <li>• <i>Tabelat përmbledhëse.pdf</i></li> </ul>	Orë mësimore	Programi i Ekonomiks			PAE	PAK	Totali orë në auditor	2022 – 2023	3.375 orë në auditor (78%)	975 orë në auditor (22%)	4.350	2023 – 2024	3.555 orë në auditor (82%)	765 orë në auditor (18%)	4.320	2024 – 2025	3.510 orë në auditor (83%)	735 orë në auditor (17%)	4.245
Orë mësimore	Programi i Ekonomiks																			
	PAE	PAK	Totali orë në auditor																	
2022 – 2023	3.375 orë në auditor (78%)	975 orë në auditor (22%)	4.350																	
2023 – 2024	3.555 orë në auditor (82%)	765 orë në auditor (18%)	4.320																	
2024 – 2025	3.510 orë në auditor (83%)	735 orë në auditor (17%)	4.245																	
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e</p>	<p>Institucioni, në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor, ka hartuar bazën rregullatore që përcakton kriteret e përgjithshme dhe specifike për pranimin, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve apo studentëve. Në funksion të këtij procesi shërbejnë Statuti i UT, rregullorja e UT dhe rregullorja e</p>																			

<p>përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>programit Bachelor në FEUT. Në tabelat e RVB-së paraqitet informacion për një student të transferuar gjatë vitit akademik 2023–2024. Ky fakt u konfirmua nga GVJ gjatë vizitës në institucion dhe, së bashku me dokumentacionin mbështetës, vërteton plotësimin e këtij kriteri.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Statuti UT.pdf</i></li> <li>• <i>Rregullorja e Universitetit të Tiranës.pdf</i></li> <li>• <i>Rregullore e programit Bachelor FEUT.pdf</i></li> <li>• <i>Tabelat përmbledhëse.pdf (Tabela 21)</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Nga shqyrtimi i programit të studimit rezulton se ai përfshin gjithë elementët përbërës formues teorik praktik për një program të nivelit Bachelor. Nga shqyrtimi i syllabuseve vërejmë se ato hartohen në gjuhë shqipe dhe përmbajnë të gjithë elementët e përcaktuara në Vendimin e KM Nr.41, datë 24.01.2018, i ndryshuar, si :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Emërtimi i lëndës/ modulit;</li> <li>• Viti/ semestri kur zhvillohet lënda;</li> <li>• Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën;</li> <li>• Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit;</li> <li>• Njohuritë paraprake që duhet të ketë studentit për përvetimin e lëndës;</li> <li>• Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë;</li> <li>• Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik;</li> <li>• Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS;</li> <li>• Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre;</li> <li>• Format e vlerësimit të studentëve;</li> <li>• Detyrimet e studentit për lëndën;</li> <li>• Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse;</li> </ul> <p>GVJ vlerësoi cilësinë e syllabuseve të programit të prezantuar në kuadër të këtij vlerësimi. Hartimi i syllabuseve të programit përfshin të gjitha elementët e nevojshëm duke plotësuar kriteret për to. Format e mësimdhënies janë nëpërmjet vlerësimit periodik në seminare (për pjesëmarrje aktive), detyra kurse, provime të ndërmjetme dhe provim final. Nga shqyrtimi i elementeve të syllabusve u konstatua:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ <i>Në disa prej tyre literatura e rekomanduar nuk është viteve të fundit, por i referohet viteve 2005-2015;</i></li> </ul>

	<p>➤ Në një numër të konsiderueshëm të programeve vlerësimi gjatë vitit nëpërmjet formave të kontrollit të dijes (seminare, detyra kursi etj) zë një peshë të ulët ndërkohë që provimi përfundimtar zë 70% - 80% të pikëve;</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Syllabuset e lëndëve.pdf</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>GVJ konstaton se Departamenti dhe personeli akademik i tij janë të angazhuar në mënyrë të vazhdueshme në procesin e rishikimit dhe përmirësimit të planit mësimor. Çdo sugjerim shqyrtohet në mbledhjet e para të vitit akademik dhe më pas ndiqen procedurat përkatëse për reflektimin e ndryshimeve. Gjatë vizitës në institucion dhe takimeve me përgjegjësin e departamentit dhe stafin akademik, u konstatua një angazhim aktiv për përmirësimin e programeve të lëndëve dhe përditësimin e tyre në përputhje me tematika bashkëkohore dhe zhvillimet aktuale në fushën e ekonomisë. Në DVV janë paraqitur dokumente evidencuese që vërtetojnë ndryshimet më të fundit të planit mësimor për programin Bachelor në: “Ekonomiks”.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Plani Mesimor Bachelor në Ekonomiks.pdf</i></li> <li>• <i>Procesverbal mbledhje në fillim viti akademik.pdf</i></li> <li>• <i>Ndryshim në Kurrikul -Shkrimi Akademik.pdf</i></li> <li>• <i>Ndryshim në Kurrikul -Projekti Jean Monnet Module.pdf</i></li> </ul>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në: “Ekonomiks” në FEUT përmban të gjitha elementet e nevojshme të planit mësimor, duke përfshirë informacionin mbi ndarjen e lëndëve sipas semestrave, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor dhe jashtë tij, si edhe të dhëna të detajuara për studentët lidhur me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Gjithashtu, programi përfshin informacion të plotë mbi syllabuset e çdo lënde dhe komponentët formues të tij, brenda dhe jashtë auditorit. GVJ konfirmon se përmbajtja e programit Bachelor në: “Ekonomiks” është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm, në përputhje me procedurat dhe rregulloret përkatëse.</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4 Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	<p>GVJ, duke gjykuar në bazë të dokumentacionit të dorëzuar nga Institucioni, dhe kryesisht Plani Mësimor i programit të studimit dhe programet lëndore gjykon se tërësia e lëndëve të përfshira në program mundëson dhënie të njohurive të nivelit 6 të KSHK, pra aftësim për problem zgjidhje mesatarisht komplekse në praktikë. Këto aftësi dhe njohuri garantojnë kryesisht punësimin e studentëve në tregun vendas të punës në përputhje me nevojat e punëdhënësve për ekonomistë dhe financiarë.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Plani Mesimor Bachelor në Ekonomiks.pdf</i></li> <li>• <i>Rregullore e programit Bachelor FEUT.pdf</i></li> <li>• <i>Tabelat përmbledhëse.pdf</i></li> </ul>
<b>Kriteri 2.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	<p>Programi i studimit Bachelor në: “Ekonomiks” synon të pajisë studentët me kompetenca të përgjithshme dhe të veçanta, duke u mundësuar thellimin e njohurive ekzistuese, përvetësimin e njohurive të reja, si dhe aplikimin e tyre në projekte dhe në përgatitjen e mikrotezës. Analiza e programit tregon se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- në vitin e parë studentët marrin njohuritë bazë që krijojnë themelet teorike;</li> <li>- në vitin e dytë lëndët janë më të avancuara dhe me karakter aplikativ;</li> <li>- në vitin e tretë programi ofron thellimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive të studentëve në kontekste praktike dhe të specializuara.</li> </ul> <p>Duke u mbështetur si në lëndët e përfshira në program, ashtu edhe në praktikën profesionale që ai ofron, programi arrin të përmbushë objektivin e tij për formimin teorik–shkencor, por edhe relativisht aplikativ të studentëve.</p>

	<p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Plani Mesimor Bachelor në Ekonomiks.pdf</i></li> <li>• <i>Rregullore e programit Bachelor FEUT.pdf</i></li> <li>• <i>Syllabuset e lëndëve.pdf</i></li> <li>• <i>Tabelat përmbledhëse.pdf</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në: “Ekonomiks” është hartuar dhe zhvilluar mbi bazën e përvojës së gjatë të Departamentit të Ekonomiksit. Struktura e programit, përmbajtja e lëndëve dhe raporti ndërmjet komponentëve teorikë dhe praktikë janë në përputhje me fushën e studimit, duke reflektuar qartë profilin e ekonomiksit. Programi trajton elementët e nevojshëm që lehtësojnë njohjen dhe ekuivalentimin ndërkombëtar të diplomës, duke i mundësuar studentëve vazhdimin e studimeve në ciklin e dytë apo integrimin në tregun e punës. Kjo përputhje është dëshmuar edhe përmes pjesëmarrjes së studentëve në programet e shkëmbimit Erasmus. Gjithashtu, programi është i harmonizuar me objektivat e përcaktuara në legjislacionin kombëtar dhe në direktivat e Bashkimit European për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p> <p>Mbështetur në deklaratimet e stafit akademik dhe studentëve të programit të studimit për mjaftueshmërinë e aktiviteteve praktike, GVJ konfirmon përmbushjen e plotë të këtij kriteri.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Plani Mesimor Bachelor në Ekonomiks.pdf</i></li> <li>• <i>Rregullore e programit Bachelor FEUT.pdf</i></li> <li>• <i>Studentë FE Erasmus.pdf</i></li> <li>• <i>Vizita në Institucion</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Në programin e studimit Bachelor në: “Ekonomiks” në FEUT, ndarja ndërmjet formimit teorik dhe atij praktik është e strukturuar në përputhje me objektivat formues të programit. Sipas tabelës 13 në RVB, shpërndarja e ngarkesës mësimore është si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 945 orë leksione (formim teorik),</li> <li>• 382.5 orë seminare,</li> <li>• 382.5 orë ushtrime/laboratore,</li> <li>• 75 orë praktikë profesionale,</li> <li>• 30 orë të dedikuara për diplomën, duke arritur një total prej 2685 orësh.</li> </ul>

	<p>Ky kombinim ndërmjet komponentëve teorikë dhe praktikë siguron arritjen e objektivave të programit, zhvillimin e kompetencave të nevojshme dhe krijon mundësi reale për transferim studimesh, mobilitet akademik dhe punësim pas përfundimit të studimeve. Aktivitetet e vazhdueshme në kuadër të programeve të shkëmbimit Erasmus për studentët dhe stafin e konfirmojnë këtë përputhshmëri me standardet ndërkombëtare.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Plani Mesimor Bachelor në Ekonomiks.pdf</i></li> <li>• <i>Studentë FE Erasmus.pdf</i></li> <li>• <i>Tabelat përmbledhëse.pdf</i></li> <li>• <i>Marrëveshjet ndërinstitucionale.pdf</i></li> <li>• <i>Mobilitete personeli akademik.pdf</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Përditësimi i vazhdueshëm i kurrikulave, me synim sigurimin e njohurive të nevojshme për përgatitjen e profesionistëve të ardhshëm, si dhe përditësimi i syllabuseve, përbëjnë një ndër prioritetet kryesore të njësisë bazë për programet ekzistuese të studimit, përfshirë edhe programin Bachelor në “Ekonomiks” Në RVB evidentohet përfshirja e moduleve Jean Monnet në disa lëndë, me fokus përshtatjen e kurrikulës në funksion të thellimit dhe zgjerimit të njohurive mbi Bashkimin Europian. Njëkohësisht, vihet theksi tek përdorimi dhe promovimi i teknologjive bashkëkohore dhe platformave kërkimore si JSTOR, si edhe platformave statistikore dhe ekonometrike, të cilat mbështesin zhvillimin akademik dhe praktik të studentëve.</p> <p>Gjatë vizitës në Institucion, GVJ u informua në lidhje me përmirësimin e vazhdueshëm të syllabuseve që ishte një praktikë e zakonshme e njësisë bazë në çdo fillim viti akademik. Nga analiza e përmbajtjes së syllabuseve në dosjen e programeve lëndore, GVJ konstaton edhe përdorimin e literaturës, kryesisht të viteve të fundit, me përjashtime të vogla që nuk çënojnë cilësinë e materialeve që ofrohen për studentët e këtij programi studimi.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Syllabuset e lëndëve.pdf</i></li> <li>• <i>Procesverbal diskutime grup lëndësh.pdf</i></li> <li>• <i>Procesverbal mbledhje në fillim viti akademik.pdf</i></li> </ul>

<p><b>Kriteri 6.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në: “Ekonomiks” në FEUT është strukturuar në mënyrë të tillë që të sigurojë përfitim e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara. Ai kombinon komponentët teorikë dhe praktikë, duke përfshirë leksione, seminare, ushtrime/laboratore, praktikë profesionale dhe përgatitjen e mikrotezës, në një total prej 2685 orësh. Struktura e programit, shpërndarja e ngarkesës mësimore dhe raporti teori – praktikë janë në përputhje me profilin e ekonomiksit dhe objektivat e programit, duke ofruar një formim të gjithanshëm akademik dhe aplikativ.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Plani Mesimor Bachelor në Ekonomiks.pdf</i></li> <li>• <i>Rregullore e programit Bachelor FEUT.pdf</i></li> <li>• <i>Syllabuset e lëndëve.pdf</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në: “Ekonomiks” ofron njohuritë dhe kompetencat e nevojshme për vijimin e suksesshëm të studimeve në ciklin e dytë, si dhe për integrimin në tregun e punës. Përputhshmëria me standardet ndërkombëtare, përfshirja e moduleve Jean Monnet dhe mundësitë për mobilitet në kuadër të programeve Erasmus kontribuojnë në rritjen e mundësive për punësim dhe vazhdimin e studimeve, në përputhje me kërkesat dhe pritshmëritë e tregut të punës. Ky përfundim mbështetet edhe nga të dhënat që tregojnë se rreth 60% e të diplomuarve të një viti vazhdojnë studimet në ciklin Master.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Plani Mesimor Bachelor në Ekonomiks.pdf</i></li> <li>• <i>Rregullore e programit Bachelor FEUT.pdf</i></li> <li>• <i>Syllabuset e lëndëve.pdf</i></li> </ul>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ, bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni dhe vizitën e realizuar në institucion, konkludon se programi Bachelor në: “Ekonomiks” në FEUT përmbush plotësisht standardin. Programi ofron një strukturë të qartë dhe të ekuilibruar midis formimit teorik dhe praktik, duke mundësuar zhvillimin graduale të njohurive bazë dhe të avancuara, aftësive praktike dhe kompetencave profesionale. Përditësimi i vazhdueshëm i kurrikulave dhe syllabuseve, përfshirja e moduleve Jean Monnet, përdorimi i platformave teknologjike dhe programet e mobilitetit Erasmus sigurojnë përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare dhe rrisin</p>

	<i>mundësitë për vazhdimin e studimeve dhe integrimin e studentëve në tregun e punës.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi II.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</b>	<p>Referuar dokumentacionit të paraqitur në RVB dhe diskutimeve gjatë vizitës në institucion, GVJ vëren se FEUT ka lidhur marrëveshje të shumta ndër-institucionale, të cilat kontribuojnë në procesin e vazhdueshëm të përmirësimit të përmbajtjes së programit dhe përshtatjes së tij me kërkesat e tregut të punës. Studimet e tregut të zhvilluara nga institucioni dhe nga njësi bazë reflektojnë përfshirjen aktive të studentëve dhe alumni në këtë proces, përmes përgjigjeve të mbledhura nga formularët e shpërndarë.</p> <p>Përveç kësaj, zhvillohen takime periodike me aktorë të ndryshëm të tregut për identifikimin e nevojave aktuale, ndërsa leksione të hapura dhe aktivitete ekstra-kurrikulare ofrojnë mundësi shtesë për studentët për të njohur praktikatat dhe kërkesat profesionale në fushën e ekonomiksit. Ky mekanizëm i përfshirjes së partnerëve akademikë, studentëve dhe aktorëve të tregut siguron që përmbajtja e programit të jetë e azhurnuar dhe e përshtatshme për nevojat aktuale të tregut të punës.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Rregullore për funksionimin e Komisionit të Përhershëm të Kurrikulës.pdf</i></li> <li>• <i>Rregullorja për sigurimin e cilësisë në UT.pdf</i></li> <li>• <i>Marrëveshjet ndër-institucionale.pdf</i></li> <li>• <i>Studimi i tregut të punës të UT-së.pdf</i></li> <li>• <i>Studim i tregut të punës i Departamentit të Ekonomiksit.pdf</i></li> <li>• <i>Vizita në Institucion</i></li> </ul>

<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>GVJ vëren se institucioni nxit dhe përfshin vazhdimisht studentët dhe strukturat e tyre në procesin e përmirësimit të programit të studimit. Zyra e Karrierës mban kontakte të përditësuara me studentët e diplomuar (alumni), dhe organizohen takime të veçanta për diskutime mbi përmbajtjen dhe metodologjinë e programeve. Përveç kësaj, çdo vit akademik administrohen pyetësore ku studentët japin mendimet e tyre mbi metodologjinë e mësimdhënies, materialet didaktike dhe mënyrën e vlerësimit, të cilat konsiderohen dhe reflektohen në përmirësimet e programit. Ky angazhim i vazhdueshëm i studentëve dhe alumni siguron që programi të zhvillohet në mënyrë të harmonizuar me nevojat dhe pritshmëritë e pjesëmarrësve në procesin mësimor.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Formular vlerësimi i studentëve që diplomohen.pdf</i></li> <li>• <i>Formular vlerësimi i lëndës nga studentët.pdf</i></li> <li>• <i>Formular vlerësimi i pedagogut nga student.pdf</i></li> <li>• <i>Raporti Vjetor i Departamentit të Ekonomiksit.pdf</i></li> <li>• <i>Vizita në Institucion</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>GVJ vëren se njësia përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në: “Ekonomiks” në FEUT përmirëson, përditëson dhe përshtat programin në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fushat përkatëse, në bashkëpunim me institucione të ndryshme publike e private. Bazuar në marrëveshjet e bashkëpunimit me partnerë të ndryshëm, këta të fundit përfshihen në procesin e përditësimit dhe përshtatjes së programit të studimit.</p> <p>Gjithashtu, organizohen aktivitete me lektorë të ftuar nga institucione të ndryshme, me qëllim integrimin e kërkimit shkencor dhe materialeve të ofruara nga kursi në program. Njësia ndjek gjithashtu praktikën e mira të universiteteve ndërkombëtare, duke siguruar që përmbajtja e programit të jetë e harmonizuar me zhvillimet më të fundit dhe në përputhje me standardet profesionale dhe akademike.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Marrëveshjet ndër-institucionale.pdf</i></li> <li>• <i>Studim i tregut të punës i Departamentit të Ekonomiksit.pdf</i></li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Vizita në Institucion</i></li> </ul>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ gjykon se ky standard përmbushet plotësisht pasi marrëveshjet e bashkëpunimit në FEUT janë funksionale, analizohen dhe mendimet dhe sugjerimet partnerëve institucionalë merren në konsideratë duke shfrytëzuar një larmi mënyrash si pjesëmarrje në Leksione të hapura, Forum, etj. Po kështu, institucioni vlerëson dhe merr në konsideratë sugjerimet e studentëve dhe të rregullatorëve të tregut dhe shoqatave profesionale të ekonomisë.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</b></p>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Në programin e studimit Bachelor në: “Ekonomiks”, format e mësimdhënies përfshijnë leksione, seminare, projekte dhe detyra kursi individuale ose në grup, provime të ndërmjetme dhe përfundimtare, si edhe praktikën profesionale të zhvilluar pranë institucioneve dhe kompanive me të cilat FEUT ka marrëveshje bashkëpunimi. Këto forma janë të organizuara në jo më pak se 30 lëndë gjatë gjithë ciklit të parë të studimeve, të ndara në lëndë të detyrueshme dhe me zgjedhje (Rregullorja e programit të studimit, neni 8). Gjatë vizitës në institucion, GVJ konfirmoi zbatimin e këtyre formave të mësimdhënies. Në përfundim, GVJ vlerëson se ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Plani Mesimor Bachelor në Ekonomiks.pdf</i></li> <li>• <i>Rregullore e programit Bachelor FEUT.pdf</i></li> <li>• <i>Syllabuset e lëndëve.pdf</i></li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Guida Metoda Interaktive të mësimdhënies FEUT.pdf</i></li> <li>• <i>Strategjia institucionale për mësimdhënien në UT.pdf</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Format e ndryshme të mësimdhënies, të parashikuara në Rregulloren e programit të studimit, respektohen në mënyrë të vazhdueshme nga stafi akademik, gjë që u konfirmua nga GVJ gjatë bisedave të zhvilluara si me pedagogët, ashtu edhe me studentët. Fusha e studimit dhe specializimi i stafit akademik janë në përputhje me lëndët që ata mbulojnë, ndërkohë që institucioni u krijon atyre mundësi për trajnime dhe kualifikime të vazhdueshme, duke kontribuar kështu në rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe përditësimin e njohurive të tyre profesionale.</p> <p>Studentët u shprehën se ata ndjehen të përfshirë në procesin e mësimin dhe janë të nxitur të marrin pjesë në diskutime dhe në detyra individuale dhe në grup.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Vizita në Institucion</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve.</p>	<p>GVJ vlerëson se FEUT ka treguar një angazhim të qëndrueshëm në mbështetjen e stafit akademik për përmirësimin e vazhdueshëm të kompetencave të tyre didaktike dhe profesionale. Kjo mbështetje realizohet përmes përfshirjes së stafit në trajnime dhe aktivitete të ndryshme zhvillimore, të organizuara si në nivel institucional, ashtu edhe në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe shkëmbimit me universitete dhe institucione të tjera të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se politikat institucionale për nxitjen dhe përkrahjen e stafit janë të dokumentuara dhe të implementuara në praktikë. Në DVV u gjetën dokumenta që dëshmojnë për këto politika, përfshirë dokumentacion mbi trajnime, projekte bashkëpunimi dhe aktivitete të zhvillimit profesional. Ky informacion u konfirmua gjithashtu nga vetë stafi akademik, i cili gjatë intervistave vlerësoi mbështetjen që u ofrohet për përmirësimin e aftësive pedagogjike dhe për përditësimin e njohurive në përputhje me zhvillimet më të fundit në fushën e tyre të specializimit.</p> <p>Ky angazhim institucional reflekton qartë prioritetin e FEUT për të garantuar cilësi të lartë në procesin e mësimdhënies dhe për të siguruar që studentët të përfitojnë nga një staf i</p>

	<p>përgatitur dhe i përditësuar në nivel akademik dhe profesional.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Mobilitete personeli akademik.pdf</i></li> <li>• <i>Strategji institucionale për zhvillimin profesional.pdf</i></li> <li>• <i>Projekte të departamentit të Ekonomiksit.pdf</i></li> <li>• <i>Vizita në Institucion</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Personeli akademik që mbulon programin Bachelor në: “Ekonomiks” në FEUT ka një përvojë të gjatë dhe zotëron kualifikimet e nevojshme për të garantuar një proces mësimdhënieje të suksesshme dhe në përputhje me standardet akademike. Gjatë diskutimeve të zhvilluara me stafin, GVJ u informua se lektorët përdorin metoda të larmishme në procesin mësimor, duke kombinuar shpjegimin e koncepteve teorike me ilustrime përmes rasteve praktike. Kjo qasje siguron që studentët jo vetëm të kuptojnë më mirë bazat teorike, por edhe të aftësohen në aplikimin e tyre në situata konkrete.</p> <p>Disa nga format që aplikohen për të pasuruar procesin mësimor përfshijnë leksione të hapura me tematika bashkëkohore, vlerësim të vazhdueshëm gjatë vitit akademik, angazhim të studentëve në projekte praktike, si edhe pjesëmarrjen e tyre në konferencën studentore dhe konkurse të ndryshme. Këto forma krijojnë një mjedis dinamik dhe stimulojnë motivimin e studentëve, duke i përgatitur ata më mirë për tregun e punës dhe për sfida akademike të mëtejshme. Metodatat interaktive të përdorura nga stafi akademik ndihmojnë në zhvillimin e mendimit kritik, rritjen e pavarësisë intelektuale dhe nxisin aftësinë e studentëve për të marrë iniciativa në zgjidhjen e problemeve.</p> <p>Në përfundim, GVJ formoi opinionin se metodatat dhe format e mësimdhënies të aplikuara nga stafi akademik i FEUT për programin Bachelor në: “Ekonomiks” janë të përshtatshme dhe të orientuara drejt sigurimit të një procesi mësimor cilësor, duke kontribuar në arritjen e plotë të objektivave të programit të studimit.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Aktivitete projekti Jean Monnet Chair.pdf</i></li> <li>• <i>Simulation game-Progresi i zhvillimit dhe politikat sektoriale.pdf</i></li> <li>• <i>Tabelat përmbledhëse.pdf</i></li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Cv Stafit Akademik.pdf</i></li> <li>• <i>Vizita në Institucion</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>GVJ konfirmoi se njësia përgjegjëse për ofrimin e programit Bachelor në: “Ekonomiks” vlerëson dhe përmirëson format dhe metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike. Studentët përfshihen aktivisht në këtë proces përmes pyetësorëve të zhvilluar në përfundim të çdo semestri, ku ata japin vlerësimin për lëndët dhe pedagogët. Gjatë vizitës në institucion, GVJ vuri re dhe konfirmoi përfshirjen e studentëve në procesin e përmirësimit të mësimdhënies dhe reflektimin e mendimeve dhe këshillave të tyre në ndryshimet e programit. Departamenti përgjegjës për programin, në bashkëpunim me dekanatin dhe NJSBC-në, vlerësojnë në mënyrë dinamike programin çdo vit akademik dhe dokumentojnë vlerësimet përfundimtare në fund të vitit akademik. Kjo praktikë tregon përkushtimin institucional për të siguruar cilësi të vazhdueshme në procesin mësimor dhe për të integruar sugjerimet dhe nevojat e studentëve në përmirësimin e programeve. GVJ shprehet për përmbushjen e plotë të këtij kriteri.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Raporti Vjetor i Departamentit të Ekonomiksit.pdf</i></li> <li>• <i>Manual i sigurimit të cilësisë UT.pdf</i></li> <li>• <i>Manual i vlerësimit të personelit akademik.pdf</i></li> <li>• <i>Rezultatet e vlerësimit të paketës të instrumentave të cilësisë.pdf</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe</p>	<p>Në përmbushje të nenit 38 të Ligjit 80/2015, FEUT ka ngritur Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC), i cili është struktura kryesore përgjegjëse për garantimin e cilësisë së programeve dhe të institucionit në tërësi. Në nivel institucional, strukturat që mbikëqyrin dhe sigurojnë cilësinë përfshijnë Senatin Akademik, Komisionin e Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë (KPGSC) dhe Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC).</p> <p>UT ka zhvilluar dhe implementuar një seri instrumentesh dhe manualesh të dedikuara për sigurimin e cilësisë, përfshirë manualin e sigurimit të cilësisë, manualin e vlerësimit të stafit akademik dhe paketën e instrumenteve të monitorimit të cilësisë. Këto mjete ofrojnë mbështetje të drejtpërdrejtë për njësitë akademike, duke i ndihmuar në përmirësimin e</p>

<p>zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>programeve, zhvillimin e metodave të mësimdhënies dhe trajnimin e vazhdueshëm të stafit akademik.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ pati mundësinë të konstatojë zbatimin e këtyre politikave dhe instrumenteve, si dhe angazhimin e strukturave përkatëse në mbikëqyrjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe programeve. Në përfundim, GVJ vlerëson se ky kriter përmbushet plotësisht dhe reflektuar qartë në punën e strukturuar të institucioneve përgjegjëse.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Statuti UT.pdf</i></li> <li>• <i>Rregullorja për sigurimin e cilësisë në UT.pdf</i></li> <li>• <i>Raporti i NJSBC.pdf</i></li> <li>• <i>Strategji plan veprimi për sigurimin e brendshëm të cilësisë.pdf</i></li> <li>• <i>Manual i sigurimit të cilësisë UT.pdf</i></li> <li>• <i>Manual i vlerësimit të personelit akademik.pdf</i></li> </ul>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se programi ofron mekanizma të qëndrueshëm për vlerësimin dhe përmirësimin e metodave dhe formave të mësimdhënies, duke përfshirë studentët aktivisht dhe duke reflektuar mendimet dhe sugjerimet e tyre në përditësimin e programeve. Stafi akademik ka përvojë të gjatë dhe kualifikim të duhur, përdor metoda të larmishme didaktike, projekte, seminare, diskutime dhe aktivitete praktike, duke nxitur mendimin kritik, pavarësinë dhe aftësitë praktike të studentëve.</i></p> <p><i>Strukturat institucionale për sigurimin e cilësisë, përfshirë Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, Senatin Akademik dhe Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, monitorojnë dhe mbështesin përmirësimin e vazhdueshëm të programeve dhe zhvillimin profesional të stafit akademik.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p><b>Standardi III.2</b>  <b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>

<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Në Rregulloren e Institucionit (neni 57) dhe në Rregulloren e Programit të Studimit (neni 24) përcaktohen mënyrat e vlerësimit të njohurive për lëndët e ofruara në programin Bachelor në: “Ekonomiks”. Në FEUT, format e kontrollit kombinojnë vlerësimin e vazhdueshëm gjatë vitit akademik, përmes testimeve me shkrim dhe gojë, detyrave të kursit, projekteve, punës në grup, prezantimeve, eseve dhe performancave të ndryshme, me vlerësimin përfundimtar, i cili realizohet përmes provimit me shkrim në fund të semestrit .Rregullorja e programit (neni 30) përcakton gjithashtu kriteret për kalimin e lëndës, duke i lidhur me notat dhe pikët përkatëse. Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se studentët njiheshin qartë me kriteret dhe mënyrat e vlerësimit që në fillim të lëndës, përmes prezantimit të syllabusit nga pedagogët.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Rregullore e programit Bachelor FEUT.pdf</i></li> <li>• <i>Syllabuset e lëndëve.pdf</i></li> <li>• <i>Rregullorja e Universitetit të Tiranës.pdf</i></li> <li>• <i>Vizita në Institucion</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Gjatë diskutimeve me studentët e programit Bachelor në: “Ekonomiks”, GVJ konstatoi se studentët janë të informuar qartë që në fillim të çdo lënde për përmbajtjen e saj, përfshirë temat, materialet mësimore dhe mënyrën e shpërndarjes së tyre, detyrimet për frekuentimin e lëndës dhe detyrat specifike si projekte, detyra kursi apo ese. Informacioni mbi testimin e dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore është gjithashtu i aksesueshëm përmes platformës MS Teams, duke siguruar transparencë dhe qartësi në procesin e mësimdhënies. Praktika e shtjellimit të syllabusit në orën e parë të mësimit është një aktivitet i zakonshëm dhe i konsoliduar, i konfirmuar gjatë vizitës së GVJ nga studentët dhe stafi akademik. Kjo tregon përkushtimin e institucionit për të siguruar që studentët të kuptojnë qartë pritshmëritë dhe kriteret e vlerësimit, duke kontribuar në një proces mësimor të organizuar dhe cilësor.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Syllabuset e lëndëve.pdf</i></li> <li>• <i>Format Vlerësimi.pdf</i></li> <li>• <i>Guida Metoda Interaktive të mësimdhënies FEUT.pdf</i></li> </ul>

<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Në përputhje me Rregulloren e Programit të Studimit përsa i përket mënyrës së testimit të njohurive (neni 24 &amp; 25), dhe siç pasqyrohet në syllabuset e të gjitha lëndëve të shqyrtuara nga GVJ, si dhe në Tabelën 15 të RVB, format e kontrollit të dijeve për programin Bachelor në: “Ekonomiks” përfshijnë: aktivizim, detyra kursi, teste të ndërmjetme (20-40%) dhe provimin përfundimtar (60-80%). GVJ është e bindur se ky kompozim i detyrimeve u mundëson studentëve të demonstrojnë aftësitë e tyre në modalitete të ndryshme, si me shkrim (provimet) ashtu edhe me gojë (prezantimi i projekteve të kursit), në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë vitit, duke shmangur varësinë nga një mënyrë e vetme e testimit. Paralelisht, <i>GVJ sugjeron rishikimin e disa lëndëve për të balancuar më mirë shpërndarjen e vlerësimit dhe për të ulur peshën e provimit përfundimtar në 60-65%.</i></p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Syllabuset e lëndëve.pdf</i></li> <li>• <i>Format Vlerësimi.pdf</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>GVJ konstatoi se njësia bazë dhe personeli akademik për programin Bachelor në: “Ekonomiks” zhvillon një proces të vazhdueshëm vlerësimi dhe përmirësimi të formave dhe metodave të mësimdhënies. Ky proces përfshin përditësimin e literaturës bazë të lëndëve dhe moduleve, si dhe iniciativa konkrete për përmirësimin e programeve të lëndëve, të cilat janë pjesë e projekteve ku stafi akademik është i angazhuar. Për shpërndarjen e materialeve dhe informacionit, përdoren platforma digjitale si MS Teams, duke garantuar qasje të vazhdueshme për studentët. Përveç kësaj, instrumentet e paketës së sigurimit të cilësisë, të administruara nga NjSBC, përfshijnë pyetësorë vlerësimi nga studentët, të dhënat e të cilëve përpunohen dhe bëhen pjesë e analizave periodike të kryera në departament. Kjo praktikë demonstroi përfshirjen aktive të studentëve në procesin e përmirësimit të mësimdhënies dhe reflekton një qasje të strukturuar dhe të qëndrueshme ndaj zhvillimit cilësor të programeve. GVJ konfirmoi analizën e kryer nga Institucioni dhe shkallën e përfshirjes së studentëve në të duke u shprehur se ky kriter përmbushet plotësisht.</p>

	<b>Referenca:</b>			
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Guida Metoda Interaktive të mësimdhënies FEUT.pdf</i></li> <li>• <i>Raporti Vjetor i Departamentit të Ekonomiksit.pdf</i></li> <li>• <i>Paketa e instrumenteve të cilësisë.pdf</i></li> </ul>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	<p>Nga diskutimet me studentët e programit Bachelor në: “Ekonomiks”, GVJ konstatoi se mënyra e organizimit të procesit mësimor inkurajon përdorimin e metodave të larmishme për përcjelljen e dijeve. Detyrat dhe projektet, individuale dhe në grup, nxisin punën e pavarur të studentëve dhe i vendosin ata në kushte të ngjashme me ato të punës në terren, duke forcuar aftësitë praktike dhe kompetencat profesionale.</p> <p>Në përgjithësi, GVJ arriti në bindjen se organizimi i orëve të mësimit, së bashku me mundësimin nga ana e institucionit të sallave të pajisura në mënyrë adekuate me mjete multimediale, krijon kushtet e nevojshme për përfitim të njohurive dhe përmbushjen e objektivave formues të programit të studimit. Stafit u shprehën të motivuar nga niveli i angazhimit dhe interesimit të studentëve të programit por edhe studentët u shprehën entuziastë për eksperiencën që kishin në aktivitetet mësimore dhe kërkimore dhe mbështetjen e vazhdueshme që merrnin nga profesorët e tyre.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Vizita në Institucion</i></li> </ul>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ konstaton se personeli akademik përmirëson dhe përditëson periodikisht metodat dhe format e mësimdhënies, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar sugjerimet e tyre. Metodatat e larmishme, përfshirë projekte, detyra individuale dhe grupe, seminare, leksione të hapura dhe aktivitete jashtë auditorit, nxisin punën e pavarur, mendimin kritik dhe aftësitë praktike të studentëve.</i></p> <p><i>Organizimi adekuat i orëve dhe pajisja multimediale e sallave mësimore mbështesin arritjen e objektivave formues. Në përfundim, GVJ vlerëson se standarti është plotësisht i përmbushur dhe siguron një proces mësimor cilësor dhe të orientuar drejt zhvillimit akademik dhe profesional të studentëve.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

<b>Standardi III.3</b>	
<b>Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në përputhje me Rregulloren e Programit të Studimit përsa i përket mënyrës së testimit të njohurive (neni 24 &amp; 25), dhe siç pasqyrohet në syllabuset e të gjitha lëndëve të shqyrtuara nga GVJ, si dhe në Tabelën 15 të RVB, format e kontrollit të dijeve për programin Bachelor në: “Ekonomiks” përfshijnë: aktivizim, detyra kursi, teste të ndërmjetme (20-40%) dhe provimin përfundimtar (60-80%). Vlerësimi i këtyre komponentëve gjendet edhe në syllabuset e lëndëve të programit të studimit, sa GVJ shqyrtoi dosjen e syllabuseve. Ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Rregullore e programit Bachelor FEUT.pdf</i></li> <li>• <i>Syllabuset e lëndëve.pdf</i></li> <li>• <i>Rregullorja e Universitetit të Tiranës.pdf</i></li> <li>• <i>Format Vlerësimi.pdf</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Në RVB për këtë kriter, Institucioni shprehet se ka përdorur forma elektronike të vlerësimit si Platforma CleanScore, dhe platforma Teams, gjatë kohës së pandemisë. GVJ ndeshi evidencë në DVV vetëm për njoftimet përkatëse për përdorimin e platformave, dhe u informua gjatë vizitës në Institucion se pjesëtarë të stafit akademik përdorin metodat elektornike të vlerësimit për të garantuar një vlerësim sa më të drejtë të rezultateve dhe njohurive të studentëve.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Manual përdorimi microsoft teams.pdf</i></li> <li>• <i>Clean score.pdf</i></li> <li>• <i>Vizita në Institucion</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e UT (neni 60), rregulloren e programit të studimit (neni 30) dhe programet e lëndëve, GVJ evidentoi se praktikat e vlerësimit të studentëve janë në përputhje me aktet rregullative përkatëse. Vlerësimi përfundimtar i studentëve realizohet mbi bazën e pikëve, të cilat shndërrohen në notën përkatëse dhe janë të detyrueshme. Gjithashtu,</p>

	<p>mënyrat dhe kriteret e vlerësimit u bëhen të ditura studentëve në fillim të çdo semestri gjatë prezantimit të syllabus-it nga pedagogët përkatës.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Rregullore e programit Bachelor FEUT.pdf</i></li> <li>• <i>Rregullorja e Universitetit të Tiranës.pdf</i></li> <li>• <i>Syllabuset e lëndëve.pdf</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>GVJ konstatoi se procesi i vlerësimit të njohurive dhe aftësive të studentëve në programin e studimit shoqërohet me komente dhe feedback të vazhdueshëm nga ana e stafit akademik. Studentët janë të informuar mbi oraret e konsultave me pedagogët, të cilat shërbejnë si mundësi për të marrë këshilla mbi përmirësimin e procesit të të nxënimit. Përveç konsultave, përdorimi i platformës MS Teams lehtëson komunikimin e vazhdueshëm dhe ndërveprimin midis stafit dhe studentëve. Paralelisht, platforma E-Student përdoret për publikimin e vlerësimeve paraprake, mundësinë e rishikimit të testit me kërkesë të studentit, si dhe për publikimin e notës përfundimtare, vetëm pasi studenti është ballafaquar me testimin e tij. Ky mekanizëm i kombinuar siguron transparencë, ofron komente të dobishme dhe ndihmon studentët të përmirësohen në vijimësi.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Manual përdorimi e -student.pdf</i></li> <li>• <i>Përdorues të Sim-print screen.pdf</i></li> <li>• <i>Struktura mësimore.pdf</i></li> <li>• <i>Orari mësimor.pdf</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>GVJ konstatoi se në FEUT janë të parashikuara mekanizma institucionale për të shmangur plagjiaturën dhe kopjimin në provime apo detyra. Studentët kryejnë vetëdeklarimin mbi autenticitetin e punimeve të tyre, ndërkohë që Statuti i UT (neni 137) dhe Kodi i Etikës (neni 5) përcaktojnë qartë përgjegjësitë disiplinore që mbajnë studentët në rast shkeljesh të rregullave të etikës dhe detyrimeve të përcaktuara. Pedagogët kanë detyrimin të kontrollojnë origjinalitetin e detyrave të kursit dhe eseve dhe të refuzojnë ato që nuk përmbushin standardet e kërkuara. Gjithashtu, kontakti i vazhdueshëm i studentëve me pedagogët, si dhe udhëzimi i</p>

	<p>tyre gjatë procesit të hartimit të mikrotezës, kontribuojnë në shmangien e këtij fenomeni. <i>GVJ sugjeron që në të ardhmen të përdoret një platformë e dedikuar për detektimin e plagjiaturës, e cila do të mundësonte rritjen e mëtejshme të cilësisë dhe transparencës në këtë drejtim.</i></p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Kodi i Etikës UT.pdf</i></li> <li>• <i>Plan pune për mikrotezën.pdf</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>GVJ konstatoi se në FEUT procesi i vlerësimit të studentëve zhvillohet në përputhje me nenin 60 të Rregullores së UT dhe nenin 30 të rregullores së programit të studimit, duke garantuar objektivitet dhe transparencë. Pas përfundimit të provimit, studentët njoftohen mbi zgjidhjet e tezës dhe mbi datën e publikimit të rezultateve. Korrigjimi i provimeve kryhet nga komisioni i ngritur nga përgjegjësi i departamentit, ndërsa rezultatet shpallen në sistemin elektronik brenda 10 ditëve, duke u dhënë studentëve të drejtën e ankimimit. Procesverbalet e rezultateve dorëzohen në sekretarinë mësimore brenda dy ditëve nga trajtimi i kërkesave të studentëve për sqarime. Për disa lëndë, aplikohet gjithashtu platforma <i>Clean Score</i> për korrigjimin elektronik të provimeve, duke rritur besueshmërinë dhe saktësinë e procesit të vlerësimit. GVJ vlerëson se ky mekanizëm siguron që rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale të bazohen në meritë dhe të jepen në kohën e përcaktuar, duke përmbushur plotësisht kriterin.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Rregullore e programit Bachelor FEUT.pdf</i></li> <li>• <i>Rregullorja e Universitetit të Tiranës.pdf</i></li> <li>• <i>Clean score.pdf</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut,</p>	<p>GVJ konstatoi se në përputhje me Statutin e UT dhe rregulloret e programit Bachelor në: “Ekonomiks”, institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me rezultatet e vlerësimit, për të paraqitur kërkesa për rishikim dhe për të marrë përgjigje të dokumentuara, përfshirë edhe fotokopjet e testimeve të tyre. Pas përfundimit të provimit, studentëve u afishohen zgjidhjet e sakta, duke siguruar transparencë të plotë mbi procesin e vlerësimit.</p>

rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	<p>Rezultatet e të gjitha provimeve regjistrohen në platformën elektronike në përputhje me afatin e shpallur nga pedagogu i lëndës, duke garantuar aksesin e studentëve në kohë reale.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Rregullore e programit Bachelor FEUT.pdf</i></li> <li>• <i>Rregullorja e Universitetit të Tiranës.pdf</i></li> </ul>			
<b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	<p>Çdo kërkesë për rishikim shqyrtohet fillimisht nga komisioni i provimit dhe, kur është e nevojshme, nga një komision i posaçëm i ngritur për këtë qëllim. Procedura ndiqet në mënyrë transparente, dokumentohet dhe arkivohet sipas kërkesave ligjore dhe institucionale, duke siguruar një proces të drejtë dhe të besueshëm për të gjitha palët e përfshira.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Rregullore e programit Bachelor FEUT.pdf</i></li> <li>• <i>Rregullorja e Universitetit të Tiranës.pdf</i></li> </ul>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ vlerëson se ky standard është i përmbushur në shkallë të plotë, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe konfirmuar gjatë vizitës në Institucion, FEUT për programin Bachelor në: “Ekonomiks” zbatojnë metoda vlerësimi në përputhje të plotë me rregulloret përkatëse dhe syllabuset e lëndëve. Procedurat e vlerësimit kryhen brenda afateve të përcaktuara, janë transparente dhe sigurojnë një vlerësim të drejtë dhe të besueshëm për studentët.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.4</b>	
<b>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit Bachelor në: “Ekonomiks” ka për qëllim kryesor të pajisë studentët me kompetenca të përgjithshme dhe të specializuara kryesisht në fushën e ekonomiksit, duke përfshirë edhe njohuri themelore në financë dhe menaxhim. Përveç zhvillimit të bazës teorike, programi synon të rrisë kompetencat profesionale të studentëve, me fokus të veçantë tek aftësitë praktike që mundësojnë aplikimin e njohurive në kontekste reale të punës. Struktura e programit, përmes

	<p>lëndëve dhe moduleve të përfshira, si dhe përmes praktikës profesionale të zhvilluar në institucione dhe kompani partnere, krijon një ekuilibër të harmonizuar midis formimit teorik dhe asaj profesionale. Përgatitja e diplomës, e konceptuar të jetë pjesërisht aplikative, është një komponent kyç që konsolidon aftësitë profesionale të studentëve, duke kontribuar në përgatitjen e tyre të plotë për tregun e punës dhe sfidat praktike që lidhen me fushat e ekonomiksit.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Rregullore e programit Bachelor FEUT.pdf</i></li> <li>• <i>Syllabuset e lëndëve.pdf</i></li> <li>• <i>Plani i Zhvillimit i Departamentit të Ekonomiksit.pdf</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>GVJ, bazuar në shqyrtimin e Planit Mësimor dhe të syllabuseve të Programit të Studimit Bachelor në: “Ekonomiks”, vlerëson se programi garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushat e përcaktuara nga ky kriter. Programi ofron mundësi të qarta për thellimin e njohurive në fushën e teknologjisë së informacionit përmes lëndëve si “Softe aplikative”, “Matematikë e zbatuar”, “Statistikë e zbatuar” dhe “Hyrje në Ekonometri”, të cilat kontribuojnë në ndërtimin e aftësive analitike dhe teknike të studentëve. Gjithashtu, programi adreson zhvillimin e aftësive humane, sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit përmes lëndëve të sociologjisë, psikologjisë dhe gjuhëve të huaja, duke nxitur integrimin e njohurive ndërdisiplinore dhe rritjen e kapaciteteve ndërpersonale të studentëve.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Syllabuset e lëndëve.pdf</i></li> <li>• <i>Plani i Zhvillimit i Departamentit të Ekonomiksit.pdf</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton</p>	<p>Në programet lëndore, në përputhje me kërkesat e VKM nr. 41, GVJ vëren se përfshihet një element i rëndësishëm, ai i “Rezultateve të të nxëniet nga studentët”, i cili pasqyron qartë përfitimet që studentët marrin nga secila lëndë. Megjithatë, nga shqyrtimi i syllabuseve vërehet se mungon një përmbyllje ose përsëritje e temave në fund të javëve, e cila do të shërbente si orientim shtesë për studentët.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Raporti Vjetor i Departamentit të Ekonomiksit.pdf</i></li> </ul>

<p>studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Syllabuset e lëndëve.pdf</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuarra kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Sipas Planit Mësimor të programit të studimit, në semestrin e fundit parashikohet zhvillimi i praktikës profesionale, e cila synon të aftësojë studentët në mënyrë më të drejtpërdrejtë për integrimin në tregun e punës. Gjatë vizitës në Institucion, GVJ u informua nga stafi i përfshirë në programin e studimit për mbështetjen e vazhdueshme që i ofrohet studentëve, si përmes nxitjes së diskutimeve gjatë orëve të mësimi, ashtu edhe përmes krijimit të një atmosfere bashkëpunuese dhe pozitive. Stafi shprehet i gatshëm të kontribuojë në zhvillimin e ideve të reja, duke përfshirë në mënyrë të rregullt lektorë të ftuar, përfaqësues nga bota e biznesit, institucione partnere si edhe ish-studentë të programit.</p> <p>Përveç kësaj, studentët inkurajohen të marrin pjesë në aktivitete plotësuese të formimit teorik, si konkurse studentore, konferenca shkencore, botime në revista akademike, si edhe të aplikojnë për mobilitete dhe shkëmbime në institucione partnere ndërkombëtare. Në gjykimin e GVJ, këto veprimtari kontribuojnë në zgjerimin e horizontit akademik dhe profesional të studentëve dhe i motivojnë ata drejt arritjes së objektivave formues të programit.</p> <p>Në tërësi, duke marrë në konsideratë organizimin e procesit mësimor, mundësitë për përfshirjen në aktivitete akademike shtesë dhe bashkëpunimin e gjerë me institucionet partnere brenda dhe jashtë vendit, GVJ konfirmon përmbushjen e plotë të këtij kriteri.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Raporti Vjetor i Departamentit të Ekonomiksit.pdf</i></li> <li>• <i>Vizita në Institucion</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, ka realizuar orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja në fushën e shkencës dhe teknologjisë, përfshirë 24 orë leksione me lektorë të huaj në kuadër të projekteve nderkombetare. Aktivitetet e evidentuara në DVV dhe të konfirmuara nga studentët kontribuojnë në pasurimin e formimit akademik, ndaj kriteri vlerësohet si i përmbushur plotësisht.</p> <p><b>Referenca:</b></p>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Konferencat shkencore Departamenti i Ekonomiksit (2021-2025).pdf</i></li> <li>• <i>Botimet shkencore Departamenti i Ekonomiksit (2021-2025).pdf</i></li> <li>• <i>Projekte të departamentit të Ekonomiksit.pdf</i></li> </ul>								
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ vlerëson se programi i studimit Bachelor në: “Ekonomiks” në FEUT arrin të balancojë formimin teorik me atë praktik, duke i pajisur studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale. Praktika profesionale, përgatitja e diplomës me qasje aplikative dhe përfshirja në aktivitete si konkurse, konferenca studentore, botime shkencore dhe mobilitete ndërkombëtare, kontribuojnë në rritjen e përgatitjes profesionale dhe në aftësimin e studentëve për tregun e punës dhe mjedisin akademik ndërkombëtar. Roli i personelit akademik reflektohet në mbështetjen dhe krijimin e një klime bashkëpunimi, përmes përdorimit të metodave interaktive, angazhimit të lektorëve të ftuar dhe organizimit të seminareve e leksioneve të hapura, edhe në kuadër të projekteve ndërkombëtare. Në përfundim, GVJ konstaton se tërësia e veprimtarive të programit siguron përmbushjen në shkallë të plotë të kriterëve të këtij standardi.</i></p>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<b>Standardi III.5</b>	
<b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.</p>	<p>Për procesin e diplomimit studentët e programit të studimit Bachelor në: “Ekonomiks” në FEUT përgatisin një punim diplome. Te gjithë studentët që janë vlerësuar kalues në të gjitha lëndët kanë të drejtën për të mbrojtur punimin e diplomës. Në procesin e përgatitjes së temës studenti drejtohet nga një pedagog. Ky proces përcaktohet në Rregulloren e UT (nenet 67- 70), Rregulloren e programit të studimit (Kreu V). Këto rregullore u bëhen me dije studentëve të cilët, të pyetur gjatë vizitës në Institucion u shprehën të informuar në lidhje me mënyrën e diplomimit në këtë program studimi.</p>

	<p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Rregullorja e Universitetit të Tiranës.pdf</i></li> <li>• <i>Rregullore e diplomimit.pdf</i></li> <li>• <i>Rregullore e programit Bachelor FEUT.pdf</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>GVJ konstaton se strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik në FEUT ofrojnë mbështetje të vazhdueshme për studentët në përmbushjen e detyrimeve përfundimtare të programit të studimit. Institucioni ka hartuar një udhëzues të posaçëm për përgatitjen e diplomës, ku studentët informohen mbi kërkesat e përgjithshme, strukturën dhe standardet që duhet të respektojnë punimi.</p> <p>Gjithashtu, pedagogu drejtues i diplomës mban kontakte të rregullta me studentin, nëpërmjet takimeve individuale, komunikimit me email dhe përdorimit të platformës MS Teams, duke ofruar udhëzime dhe sqarime të nevojshme gjatë gjithë procesit. Këto mekanizma garantojnë orientim të qartë, mbështetje efektive dhe ndihmojnë studentët të realizojnë një punim përfundimtar në përputhje me standardet akademike të kërkuara.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Udhëzues punim Diplome.pdf</i></li> <li>• <i>Rregullore e diplomimit.pdf</i></li> <li>• <i>Plani Mesimor Bachelor në Ekonomiks.pdf</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>NA</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës.</p>	<p>GVJ konstaton se personeli akademik, në rolin e udhëheqësit të diplomës, ofron mbështetje të vazhdueshme studentëve gjatë gjithë procesit të përgatitjes së punimit të diplomës. Sipas rregullores së diplomimit të UT (neni 5), udhëheqësi i diplomës inkurajon studentët të shqyrtojnë literaturën e duhur, asiston në përzgjedhjen e metodologjisë së përshtatshme,</p>

<p>Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>ndihmon në përpunimin dhe nxjerrjen e rezultateve, dhe jep udhëzime gjatë të gjithë procesit të punimit. Ai garanton cilësinë e punimit dhe jep miratimin për paraqitjen e tij para komisionit. Pedagogu udhëheqës caktohet në fillim të semestrit dhe temat e punimeve përzgjidhen nga një listë e përcaktuar e fushave kërkimore, duke siguruar që procesi të jetë i qartë dhe transparent për studentët.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Rregullore e diplomimit.pdf</i></li> <li>• <i>Rregullore e programit Bachelor FEUT.pdf</i></li> <li>• <i>Udhëzues punim Diplome.pdf</i></li> <li>• <i>Plan pune për mikrotezën.pdf</i></li> <li>• <i>Fusha kërkimore e departamentit.pdf</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Pedagoget përkatës që janë udhëheqës të punimeve të diplomimit mbështesin studentin për realizimin me sukses të punimit duke ofruar infrastrukturën teknike të institucionit kryesisht laboratorët si dhe të dhe database që kane në dispozicion.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Rregullore e diplomimit.pdf</i></li> <li>• <i>Rregullore e programit Bachelor FEUT.pdf</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>GVJ konstaton se në përputhje me rregulloret e UT dhe të programit të studimit, mikroteza trajtohet si lëndë e detyrueshme për diplomim dhe vlerësohet me 6 ECTS. Mbrojtja e mikrotezës zhvillohet para Komisionit të Provimit të Diplomës, ku çdo anëtar i komisionit jep vlerësimin e tij të veçantë në pikë. Kjo procedurë siguron një proces të drejtë dhe transparent vlerësimi, duke reflektuar meritën individuale të studentit dhe përputhshmërinë me standardet akademike.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Rregullore e diplomimit.pdf</i></li> <li>• <i>Rregullore e programit Bachelor FEUT.pdf</i></li> <li>• <i>Plani Mesimor Bachelor në Ekonomiks.pdf</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të</p>	<p>GVJ konstaton se, në përputhje me Rregulloren e programit të studimit (neni 39) dhe Rregulloren e UT, studentët që kalojnë me sukses mikrotezën dhe të gjitha detyrimet e programit Bachelor në: “Ekonomiks” pajisen me diplomën përkatëse.</p>

<p>miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Diploma lëshohet nga Dekani i Fakultetit dhe Rektori i UT dhe shoqërohet me Suplementin e Diplomës, i cili përshkruan nivelin, përmbajtjen, rezultatet e studimeve dhe fushën e punësimit, sipas kërkesave të Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë. Para lëshimit, të gjitha diplomat dhe certifikatat regjistrohen në regjistrin shtetëror të diplomave dhe të certifikatave të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor (QSHA). GVJ konfirmon përmbushjen e plotë të këtij kriteri, bazuar në dokumentacionin e ofruar dhe verifikimet gjatë vizitës në Institucion.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Rregullore e diplomimit.pdf</i></li> <li>• <i>Rregullore e programit Bachelor FEUT.pdf</i></li> <li>• <i>Statuti UT.pdf</i></li> <li>• <i>Rregullorja e Universitetit të Tiranës.pdf</i></li> <li>• <i>Udhëzim për përmbajtjen dhe formën e diplomës të lëshuar nga IAL.pdf</i></li> <li>• <i>Suplementi i diplomës -Bachelor.pdf</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>GVJ konfirmoi se në Rregulloren e Sekretarise Mesimore te FEUT parashikohej ruajtja e dokumentacionit të studentit në (neni 4). Gjatë vizitës GVJ pati mundësinë të verifikonte ruajtjen e të dhënave për studentët në dosjet e arkivës. Pasi kontrolloi me zgjedhje dosjet e disa studentëve, GVJ konfirmon rregullsinë dhe plotësinë e tyre dhe shprehet për përmbushjen e plotë të këtij kriteri.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Rregullore e sekretarisë mësimore.pdf</i></li> <li>• <i>Rregullore për funksionimin e sistemit informatik.pdf</i></li> <li>• <i>Manual i arkivës.pdf</i></li> <li>• <i>Rregullore e diplomimit.pdf</i></li> </ul>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ vlerëson se programi Bachelor në: “Ekonomiks” në FEUT përmbush plotësisht standardin për menaxhimin e procesit diplomues dhe administrimin e dokumentacionit të studentëve. Personeli akademik orienton dhe asiston studentët gjatë përzgjedhjes së temave dhe zhvillimit të punimeve të diplomës, duke garantuar cilësinë e rezultateve dhe respektimin e udhëzuesve të miratuar. Mikroteza si element përfundimtar i programit vlerësohet në përputhje me rregulloret, para një Komisioni të Provimit të Diplomës, dhe</p>

	<p><i>studentët pajisen me diplomën përkatëse bashkë me suplementin, sipas procedurave të parashikuara. Gjithashtu, administrimi i dokumentacionit të studentëve realizohet në mënyrë të rregullt dhe të sigurt, duke garantuar ruajtjen e plotë dhe të dokumentuar të të dhënave. Bazuar në informacionet dhe verifikimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se të gjitha këto praktika dhe procedura kontribuojnë në arritjen e objektivave formues të programit dhe sigurojnë zbatimin korrekt të rregullave dhe standardeve përkatëse.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të</b>	<p>Mbeshtetur në statistikatat e vëna në dispozicion ku rezulton se</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>personeli akademik (PAE dhe PAK) i angazhuar përgjatë tre viteve të fundit akademike në këtë program studimi janë rreth 71% me tituj dhe grada shkencore dhe rreth 29% në përfundim të studimeve doktorale.</li> <li>rreth 90% e stafit është PAE dhe 10% PAK</li> </ul> <p>theksojmë që numri i tyre është në përputhje me kërkesat e akteve ligjore në fuqi.</p> <p>Përbërja e stafit akademik, sipas titujve e gradave, për tre vite akademike për programin e studimit Bachelor në: “Ekonomiks” paraqitet në tabelën e mëposhtme: :</p>

programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

Tituj/Grada	2022-2023		2023-2024		2024-2025	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.dr	7	1	6	-	6	1
Prof.Asc.Dr	14		14	1	14	-
Dr/Doc	13	2	14	2	18	1
Dr.proc	7	-	4	-	5	-
Msc	8	5	12	4	9	4
<b>Totali</b>	<b>49</b>	<b>7</b>	<b>50</b>	<b>7</b>	<b>52</b>	<b>6</b>

Gjithashtu, nga CV rezulton se niveli i kualifikimit, fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e antarëve të personelit akademik efektiv dhe të atij të punësuar me kontratë janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.

**Referenca:**

- CV Stafit akademik
- Tabelat 6.1; 6.2; 6.3; 7; 12.1; 12.2; 12.3)
- Syllabuset e lëndëve

**Kriteri 2.** Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Nga konsultimi i tabelave me të dhëna statistikore për tre vitet e fundit rezulton se personeli akademik me kohë të plotë mbulon mbi 80 % të ngarkesës mësimore, ndërkohë që sipas VKM 418, Maj 2017 PAE duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore për çdo program studimi. Këtë e dëshmo edhe tabela e mëposhtme:

Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)
2022-2023	4350	3555	795	81.7%/ 18.3%
2023-2024	4320	3555	765	82%/ 18%
2024-2025	4140	3480	660	84%/ 16%

**Referenca:**

- Evidenca 05: Tabela permbledhese 12

<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Nga takimi me stafin e Departamentit dhe me Njësinë e Burimeve Njerëzore u informuam se personeli akademik është i qëndrueshëm në vijimësi. Nuk ka patur lëvizje të qënësishme. Personeli është i pajisur me kontratat e punësimit dhe për të paguhen rregullisht sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. Një nga faktorët që ka ndikuar në qëndrueshmërinë e stafit është edhe mjedisi i ngrohtë shoqëror dhe marrëdhëniet hierarkike e profesionale të mira të krijuara si një traditë në Departament.</p> <p>Qëndrueshëria e personelit akademik provohet edhe nga fakti që aty ka personel akademik të punësuar për më shumë se 15 vjet.</p> <p>Dega e Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-Arshivës merret me përgatitjen e kontratave të punës për të gjithë punonjësit akademikë dhe administrativë të Universitetit, si rrjedhojë edhe për personelin e këtij Departamenti. Çdo kontratë hartohet duke respektuar ligjin dhe rregullat në fuqi që lidhen me marrëdhëniet e punës si Kodin e Punës, Ligjin e Arsimit të Lartë, Statutin e UT-së dhe aktet ligjore e nënligjore përkatëse. Gjithashtu, një instrument i rëndësishëm për të realizuar procedurat e punësimit është edhe Manuali mbi punësimin e personelit akademik.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion na u vu në dispozicion një dosje e plotë e PAK dhe PAE, të cilat rezultuan të ishin të mbajtura me kujdes dhe me të gjithë informacionin dokumentar të nevojshëm</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Procedurë rekrutimi tip</i></li> <li>• <i>Model kontrate pune personel akademik me kohë të plotë</i></li> <li>• <i>Model kontrate pune personel akademik me kohë të pjesshme</i></li> <li>• <i>Manual mbi punësimin e personelit akademik në UT</i></li> <li>• <i>Vizita në IAL</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën,</p>	<p>Universiteti i Tiranës ka hartuar dhe zbaton një sistem të qartë dhe transparent për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullat e brendshme të institucionit. Procedurat e rekrutimit bazohen në Ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë”, Kodin e Punës, aktet nënligjore përkatëse si dhe Statutin dhe rregulloret e brendshme të UT-së. Si dhe në Manualin e Punësimit</p> <p>Përgjegjës për ndjekjen administrative të procesit është Drejtoria e Shërbimeve, në bashkëpunim me Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-Arkivën. Ky bashkëpunim siguron</p>

<p>modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>ndjekjen korrekte të të gjithë hapave të përcaktuara në manualin e punësimit.</p> <p>Njësitë akademike luajnë rol kyç në përcaktimin e kritereve të veçanta për pozicionet e shpallura, në bazë të nevojave të tyre, të cilat miratohen nga Rektori. Këto kritere përfshijnë përvojën në mësimdhënie, veprimtarinë kërkimore-shkencore, publikimet, angazhimet në projekte dhe të tjerë elementë të cilësuar, të cilët vlerësohen përmes një sistemi pikëzimi me prag minimal.</p> <p>Procesi i rekrutimit është transparent dhe i drejtë, vendet e lira publikohen në Buletinin e APP-së dhe në faqen zyrtare të fakultetit dhe aplikimet vlerësohen nga një komision ad hoc në dy faza: shqyrtimi i dokumentacionit dhe intervistimi i kandidatëve të kualifikuar. Janë përcaktuar qartë edhe afatet për ankime dhe procedurat deri në nënshkrimin e kontratës nga Rektori.</p> <p>Dokumentacioni i vënë në dispozicion gjatë vizitës konfirmon që Institucioni ndjek procedura të mirëpërcaktuara rekrutimi dhe vlerësimi, të bazuara në kritere të publikuara, të cilat sigurojnë përzgjedhjen e stafit akademik me nivelin e nevojshëm të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimit.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Manual mbi punësimin në UT</i></li> <li>• <i>Procedurë rekrutimi tip</i></li> <li>• <i>Njoftim për vend të lirë pune</i></li> <li>• <i>Vizita në Institucion</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Pranë Departamentit është angazhuar personali ndihmës akademik i nevojshëm për funksionimin e laboratorëve dhe përditësimin e programeve të nevojshme për realizimin e seminareve /laboratorëve, në mënyrë specifike në modulet Hyrje në Ekonometri dhe Statistikë e aplikuar.</p> <p>Në to realizohen dhe mbikqyren edhe projektet individuale të studentëve.</p> <p>Dega e Menaxhimit dhe Mirëmbajtjes me një numër total prej 9 punonjësish siguron mirëmbajtjen e mjediseve dhe laboratorëve</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Tabelat përmbledhëse (tabela 16)</i></li> <li>• <i>Organigrama FEUT</i></li> <li>• <i>Të dhëna mbi kapacitetin e sallave dhe pajisjet</i></li> <li>• <i>Foto nga laboratorët</i></li> <li>• <i>Vizita në Institucion</i></li> </ul>

<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Dega e Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-Arshivës administron dokumentacionin e plotë që lidhet me rekrutimin e stafit të ri, përditësimin e të dhënave të stafit ekzistues, si dhe ndjekjen e procedurave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet kontraktuale të tyre me institucionin. Ruajtja e të dhënave bëhet përmes një dosjeje fizike personale, e cila përditësohet një herë në vit me të dhëna mbi titujt, gradat, trajnimet dhe CV-në, si dhe përmes një dosjeje elektronike, që përditësohet vazhdimisht mbi bazën e informacionit të paraqitur pranë kësaj dege. Drejtuesja e Degës së Burimeve njerëzore na informoi se aktualisht po mbledh të dhënat e përditësuara të stafëve, proces që ndodh çdo fillim viti akademik. Të dhënat mbi veprimtarinë mësimore dhe kërkimore-shkencore të stafit akademik mblidhen dhe raportohen nga departamentet. Këto përfshijnë ciklin dhe programin e studimit ku angazhohet pedagogu, lëndët dhe ngarkesën mësimore në çdo semestër, si edhe veprimtarinë kërkimore e publikimet. Drejtuesi i Departamentit mbikqyr shpërndarjen e ngarkesës mësimore sipas Udhëzimit të MAS Nr. 29, datë 10.09.2018 (i ndryshuar), duke përcaktuar ngarkesën vjetore të ndarë në dy semestra dhe sipas veprimtarive mësimore. Në fund të vitit akademik, ngarkesa faktike dokumentohet përmes formularëve të plotësuar nga stafi akademik.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Dosje e personelit akademik, Departamenti i Burimeve njerëzore -fizikisht në IAL</i></li> <li>• <i>Tabelat 4; 12.1; 12.2)</i></li> <li>• <i>Vizita në Institucion</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën</p>	<p>FEUT i ka kushtuar rëndësi bashkëpunimit me institucione e biznese, për të mundur përshtatjen e procesit mësimor me realitetin dhe praktikën. Ai ka nënshkruar marrëveshje me 45 institucione të ndryshme publike, sipërmarrje private dhe organizata për realizimin e praktikave profesionale në të dy ciklet e studimit, 13 prej të cilave janë nënshkruar në periudhën 2022-2024.</p> <p>Praktikat profesionale zhvillohen jo vetëm në institucionet me të cilat FEUT ka marrëveshje të formalizuara, por edhe në institucione të tjera sipas udhëzimeve të pedagogëve mentorë apo udhëheqës të praktikave</p> <p>Departamenti përcakton pedagogët përgjegjës për ndjekjen e studentëve gjatë praktikave, sipas një programi të miratuar. Për këtë qëllim përcaktohet personeli i duhur e i kualifikuar për</p>

<p>profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale në institucionin pritës. Praktikrat profesionale në ciklin e parë të studimeve udhëhiqen vetëm nga PAE.</p> <p>FEUT ka rreth 27 marrëveshje aktive ndërinstitucionale me institucione qendrore, kompani publike dhe private, autoritete rregullatore dhe organizata për realizimin e praktikave mësimore në fushën e ekonomiksit. Gjatë vizitës në Institucion u pyetën pedagogët lidhur me angazhimin në mbikëqyrjen e praktikave dhe rezultoi se ata janë të angazhuar dhe asistojnë studentët gjatë kryerjes së praktikave. I vetmi shqetësim ishte i lidhur me faktin që praktikrat zhvillohen paralelisht me procesin mësimor, gjë që e kompromenton cilësinë e tyre</p> <p>Në RVB mungon informacioni këtu lidhur me punimin e diplomës, por informacioni mbi to është dhënë në raport më poshtë dhe në evidencat e dorëzuara.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Marrëveshje ndërinstitucionale</i></li> <li>• <i>Pedagogët udhëheqës të diplomës dhe praktikës</i></li> <li>• <i>Vizita në Institucion</i></li> </ul>
<p><b>Kriter 8.</b> Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Praktika profesionale zhvillohet në institucionet pritëse, kryesisht në ato me të cilat FEUT ka marrëveshje bashkëpunimi. Udhëzimet përcaktohen në programin e praktikës. Personeli mbikqyrës në institucionin pritës ndjek nga afër ecurinë e praktikës dhe udhëzon studentin në përgatitjen e raportit përfundimtar. Në përfundim të praktikës, studentët i nënshtrohen një procesi vlerësimi që kryhet si nga pedagogu drejtues, ashtu edhe nga komisionet e ngritura nga Departamenti i Ekonomiksit. Praktika zhvillohet për një periudhë vetëm 2 javore. Personeli mbikqyrës në ambientet pritëse angazhohet në procesin e vlerësimit të studentëve përmes formularit të vlerësimit të praktikës mësimore, ku ai shprehet lidhur me angazhimin e studentëve gjatë praktikës, njohuritë që kanë marrë dhe vlerëson ecurinë e këtij angazhimi.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Formulari i vlerësimit nga kompanitë për praktikën mësimore</i></li> <li>• <i>Formulari miratimit Praktika mësimore Bachelor</i></li> <li>• <i>Formulari raporti përfundimtar i Praktikës mësimore</i></li> </ul>

<b>Konkluzione</b>	<p><i>Nga konsutimi i dokumentacionit dhe takimet në IAL rezultojn se personeli akademik që mbulon programin e studimit “Ekonomiks” paraqitet i qëndrueshëm, përmbush standardet për sa i takon numrit dhe raporteve që lidhen me ngarkesën mësimore, kualifikimin shkencor, realizimin e angazhimeve të mësimdhënies si leksionet, seminarët, praktikat e temat e diplomave, në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit. IAL disponon dokumentacionin dhe ndjek hapat proceduralë ligjorë , të formalizuara në dokumenta zyrtarë, që lidhen me rekrutimet dhe karrierën. Janë të miratuara procedurat e praktikave mësimore dhe realizimi i tyre si edhe procesi i vlerësimit të tyre bëhet në mënyrë të formalizuar dhe integron vlerësimin e institucionit pritës.</i></p> <p><i>Rekomandim : Praktikave duhet t’u dedikohet një periudhë kohe e veçantë, pra të mos zhvillohen paralelisht me procesin mësimor dhe të zgjatet periudha e praktikës</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht <b>X</b>

<b>Standardi IV.2</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	<p>Gjatë vizitës në institucion pamë që ai ka siguruar mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor. Procesi mësimor zhvillohet në dy godina A, B me një sipërfaqe të përgjithshme prej 9905 m<sup>2</sup> dhe laboratorin në Godinën Liria (Laborator GL) me një sipërfaqe prej 64 m<sup>2</sup>. Godinat janë të rikonstruara, përmbushin standardet bashkëkohore për të zhvilluar një veprimtari akademike cilësore dhe mësimdhënëse teorike dhe laboratorike për programin e studimit Bachelor në: “Ekonomiks”.</p> <p>Godinat janë të ajrosura, të ndriçuara dhe plotësojnë kushtet higjieno – sanitare për personelin akademik, personelin administrativ dhe për studentët duke shmangur në këtë mënyrë elementët e rrezikshmërisë.</p> <p>Mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e mësimin për numrin e studentëve që ndjekin studimet Bachelor në: “Ekonomiks” për tre vitet e fundit akademike (84 – 101).</p>

	<p>Mjediset e FEUT janë në funksion të zhvillimit të veprimtarisë mësimore në 5 ditë të javës nga ora 8:30-20:30. Në total FEUT ka në funksion të mësimdhënies 24 salla leksionesh (24 nga të cilat janë në formë amfiteatri, me kapacitet nga 42 në 110 ndenjëse), 15 salla seminaresh (me kapacitet nga 20 në 68 ndenjëse), 10 laboratorë informatike ku mund të akomodohen maksimalisht 305 studentë, të dhëna që dëshmojnë se sallat e leksioneve, seminareve dhe laboratorët ku zhvillohet mësimdhënia për programin e studimit Bachelor në: “ Ekonomiks” kanë kapacitete të mjaftueshme dhe janë të përshtatshme për zhvillimin e mësimit sipas standardeve bashkëkohore, duke siguruar ndriçim të mjaftueshëm, ajrim të përshtatshëm, sistem ngrohje/ftohje si edhe sistem të mbrojtjes nga zjarri).</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Të dhëna për numrin e studentëve</i></li> <li>• <i>Orari mësimor Bachelor Ekonomiks</i></li> <li>• <i>Tabela 16</i></li> <li>• <i>Të dhëna mbi kapacitetin e sallave dhe pajisjet</i></li> <li>• <i>Vizita në Institucion</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>FEUT i ka kushtuar vëmendjen e duhur përdorimit të metodave bashkëkohore të mësimdhënies dhe futjes së teknologjisë së re. Të gjitha klasat, janë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor. Ato ofrojnë mjete moderne si projektorë, kompjuterë, tabela dhe pajisje të tjera teknologjike që mundësojnë aplikimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies. Fakulteti i Ekonomisë disponon 10 laboratorë të pajisur me 305 kompjuterë dhe laptopë, ku janë instaluar programe të ndryshme si Apache, Eclipse, Microsoft Office, EViers, STATA, SPSS dhe R. Këto përdoren në mënyrë specifike për seminarët dhe detyrat praktike në lëndë si Statistikë, Statistikë e Aplikuar, Hyrje në Ekonometri dhe Informatikë (Softe Aplikative).Përveç infrastrukturës fizike, Fakulteti ofron edhe platforma dixhitale që lehtësojnë procesin e të mësuarit si platforma <i>e-student</i>, e cila u jep studentëve mundësinë të ndjekin progresin e tyre akademik, ndërsa Microsoft Teams u siguron akses në materialet mësimore, komunikimin me pedagogët dhe organizimin e detyrave. Gjithashtu, e gjithë godina A mbulohet me shërbim</p>

	<p>Wi-Fi, duke garantuar akses të plotë në internet për studentët dhe stafin.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Të dhëna mbi kapacitetet e sallave dhe pajisjet</i></li> <li>• <i>Foto nga laboratorët</i></li> <li>• <i>Manual përdorimi e-student</i></li> <li>• <i>Manual përdorimi Microsoft teams</i></li> <li>• <i>Vizita në Institucion</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Laboratorët (laboratorë informatike dhe laboratorë për lëndët) në të cilat janë instaluar 305 PC dhe laptop, janë të pajisur me mjetet në funksion të nevojave të mësimdhënies dhe realizimit të detyrave praktike. Programet e instaluar si apache, eclipse, Microsoft office, e-views, stata, SPSS, R, por dhe programe të dedikuara për Programin e Studimit të veçanta si Adobe, java, Kontabiliteti alpha web, etj, ndihmojnë në realizimin cilësor të procesit mësimor. Nga pedagogët dhe studentët e Ekonomiksit përdoren disa software si Eviews, STATA, SPSS, R dhe Microsoft office. për të realizuar seminarët dhe detyrat praktike në lëndët Statistikë e Aplikuar dhe Hyrje në Ekonometri. Gjatë takimit pedagogët dhe studentët vlerësuan se këto instrumente ndihmojnë në rritjen e cilësisë së mësimdhënies.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Tabelat tabela 16; 14</i></li> <li>• <i>Të dhëna mbi kapacitetin e sallave dhe pajisjet</i></li> <li>• <i>Foto nga laboratorët</i></li> <li>• <i>Vizita në Institucion</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Duke marrë parasysh specifikat e disa lëndëve për programin Bachelor në: “Ekonomiks” prej 5 vitesh, Institucioni ka vënë në dispozicion një laborator specifik për të zhvilluar leksionet dhe seminarët e dy lëndëve, të cilat zhvillohen në semestrin e tretë dhe të katërt të programit të studimit. Kështu për vitin akademik 2024-2025 në dispozicion të mësimdhënies në lëndët Statistikë e Aplikuar dhe Hyrje në Ekonometri janë vënë laboratorit A206 dhe A207 me 30 poste pune. Në pajisjet e këtij laboratorit janë të instaluar programet: apache, eclipse, Microsoft office, Eviews, STATA, SPSS, R.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Tabelat përmbledhëse (tabela 16)</i></li> <li>• <i>Foto nga laboratorët</i></li> </ul>

	• <i>Vizita në Institucion</i>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Nga shqyrtimi i dokumentacionit si edhe vizita në IAL rezulton se Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion auditorë, klasa seminaresh, laboratorë, bibliotekë, pra mjedise mësimore të përshtatshme me stadardet bashkëkohore dhe të mjaftueshme për realizimin e një procesi mësimdhënës cilësor në programin e studimit Ekonomiks që i shërben jo vetëm formimit teorik por edhe atij praktik të studentëve. Mjediset janë të pajisura me aparatura e instrumenta që mundësojnë një mësimdhënie të përshtatur me teknologjitë inovative.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi IV.3

**Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Syllabuset e lëndëve në FEUT përmbajnë informacionin e nevojshëm mbi literaturën e detyruar dhe atë të rekomanduar, e cila u bëhet e ditur studentëve në fillim të semestrit nga titullari i lëndës. Ato përfshijnë tekste bazë, shpesh edhe të përkthyer nga fakulteti me mbështetjen e donatorëve, si dhe cikle leksionesh të përgatitura e të miratuara nga njësitë bazë. Shumica e literaturës ofrohet në gjuhën shqipe, duke qënë se edhe program i studimit aktualisht zhvillohet vetëm në gjuhën shqipe, por studentët kanë në dispozicion edhe materiale në gjuhë të huaja, kryesisht anglisht.</p> <p>Përveç literaturës së ofruar drejtpërdrejt nga titullarët e lëndëve, studentët kanë akses të plotë në fondin e bibliotekës së FEUT dhe në bibliotekat dixhitale të UT-së. Që nga dhjetori i vitit 2020, personeli akademik dhe studentët kanë qasje në miliona artikuj, revista dhe libra shkencorë përmes platformës online JSTOR, si dhe në U-Library të krijuar nga projekti për qendrat ndëruniversitare dhe rrjetin tematik. Ky fond i gjerë literature mbështet procesin mësimor, punën kërkimore-shkencore dhe garanton sigurimin e njohurive të parashikuara nga programet e studimit.</p> <p><b>Referenca:</b></p>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Tabelat përmbledhëse (tabela 14)</i></li> <li>• <i>Syllabuset e lëndëve</i></li> <li>• <i>Marrëveshja e UT me JSTOR</i></li> <li>• <i>Manual përdorimi U library</i></li> <li>• <i>Vizita në Institucion</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Gjatë takimit na u theksua se FEUT ka fonde të mjaftueshme në dispozicion për të përmbushur nevojat e tyre për literaturë bashkëkohore. Njësitë bazë për çdo vit përcjellin nevojat, bazuar në kërkesat e pedagogëve për pasurimin e literaturës në fondin e bibliotekës. Përgjegjësi i departamentit përcjell nevojat e departamentit tek administratori i FEUT-së. Gjatë tre viteve të fundit fondit të bibliotekës të FEUT-së iu shtuan gjithsej 423 tituj libra të rinj. Ndërsa Departamenti i Ekonomiksit ka pasuruar literaturën e blerjeve me tituj të rinj, për vitin akademik 2023-2024 me 43 tituj libra të rinj ose 106 copë libra. Pasurimi i literaturës është dhe një nga objektivat e bibliotekës. Por nga vëzhgimi i syllabuseve na rezultoi se ka raste që literatura e rekomanduar nuk është e viteve të fundit (Historia e ekonomise boterore, Mikroekonomi, etj)</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Kërkesa për libra të rinj Departamenti i Ekonomiksit</i></li> <li>• <i>Objektivat e bibliotekës</i></li> <li>• <i>Vizita në Institucion</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka e FEUT ka një sipërfaqe prej 525.1 m<sup>2</sup>, pra me përmasa të konsiderueshme. Ajo shërben për të plotësuar nevojat e studentëve dhe pedagogëve për materiale studimore dhe kërkimore. Biblioteka ofron një kapacitet prej 200 vendesh leximi të shpërndara në dy salla dhe ofron shërbime nëpërmjet pikës së huazimit dhe sallës me fonde të hapura. Biblioteka ka stafin e mjaftueshëm për të përballuar nevojat e studentëve dhe pedagogëve. Janë të angazhuar tre punonjës – përgjegjësi, specialisti i katalogimit dhe specialisti i sallës së fondeve të hapura – të cilët raportojnë drejtpërdrejt te zv. dekani për gradat dhe titujt shkencorë.</p> <p>Nga takimi me studentët rezultoi se ata kishin akses të lehtë në bibliotekë dhe e përdornin atë gjatë realizimit të detyrave e projekteve. Çdo student pa dallim e kishte të drejtën e përdorimit.</p>

	<p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Informacion nga Biblioteka e FEUT, 2025</i></li> <li>• <i>J. Limprecht_Historiku biblioteka</i></li> <li>• <i>Rregullore e bibliotekës</i></li> <li>• <i>Foto e bibliotekës</i></li> <li>• <i>Tabelat përmbledhëse (tabela 16; 17)</i></li> <li>• <i>Vizita në Institucion</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 4. Biblioteka</b> duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka e Fakultetit të Ekonomisë (FEUT) ofron literaturën fizike të nevojshme për të gjitha programet e studimit, përfshirë edhe atë të ciklit Bachelor në: “Ekonomiks”. Fondi i bibliotekës “Joseph Limprecht” përmban një numër të konsiderueshëm titujsh përfshirë tekste, revista, etj si në gjuhën shqipe ashtu edhe në gjuhë të huaja, kryesisht anglisht. Në total raportohen rreth 5,703 tituj, që përfshijnë libra, revista, doktoratura dhe mikroteza. Prej tyre, 2,526 janë në gjuhën shqipe dhe 2,754 në gjuhë të huaj. Aktualisht, biblioteka ka në dispozicion 282 revista periodike, si dhe 423 libra të rinj në gjuhën angleze të shtuar gjatë tre viteve të fundit akademikë.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Informacion për Bibliotekën FEUT, 2025</i></li> <li>• <i>Informacion për Bibliotekën FEUT, 2022</i></li> <li>• <i>Vizita në Institucion</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 5. Institucioni</b> duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Studentët dhe personeli akademik i Universitetit të Tiranës kanë akses në një gamë të gjerë burimesh dixhitale. Në bashkëpunim me Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF), UT ka nënshkruar marrëveshje për abonimin në bibliotekën digjitale JSTOR, e cila ofron mbi 12 milionë artikuj akademikë, 85.000 libra dhe 2 milion dokumente në 75 disiplina. Për të lehtësuar përdorimin, është përgatitur edhe një manual udhëzues për studentët dhe pedagogët.</p> <p>Një mundësi tjetër është platforma U-Library, e zhvilluar në kuadër të projektit për krijimin e Qendrës Ndëruniversitare të Shërbimeve dhe Rrjetit Telematik Universitar, e financuar nga qeveria shqiptare.</p> <p>Gjithashtu, biblioteka e FEUT është pjesë e programit COBISS+, i cili siguron qasje online në katalogun e përbashkët të bibliotekave, në katalogët lokalë të të dhënave, në baza të specializuara të sistemit COBISS, si dhe në burime të tjera vendore dhe ndërkombëtare të informacionit.</p>

	<p>Studentëve dhe personelit akademik u mundësohet aksesimi pa pagesë në këto biblioteka.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Marrëveshje e UT-së me JSTOR</i></li> <li>• <i>Manual përdorimi Jstor</i></li> <li>• <i>Manual përdorimi U-library</i></li> <li>• <i>Tabelat 17</i></li> <li>• <i>Vizita në Institucion</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Biblioteka e FEUT-së ofron për studentët 11 kompjutera të lidhur me internet, të cilët mundësojnë kërkimin në bibliotekën online dhe përdorimin pa kufizim të një sërë programesh si Apache, Eclipse, Microsoft Office, EViews, STATA, SPSS dhe R. Përveç kësaj, studentët kanë në dispozicion edhe laboratorë të dedikuar, të pajisur me të gjitha programet e nevojshme për realizimin e detyrave të kursit dhe punimeve të diplomës.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Informacion për Bibliotekën FEUT, 2025</i></li> <li>• <i>Të dhëna mbi kapacitetet e sallave dhe pajisjet</i></li> <li>• <i>Foto nga laboratorët</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 7.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka është në shërbim të studentëve dhe stafit akademik nga e hëna në të premte, në orarin 08:30–19:30, me përjashtim të ditëve zyrtare të pushimit. Gjatë periudhës së provimeve, ajo qëndron e hapur çdo ditë të javës, nga ora 08:00 deri në 22:00, duke iu përshtatur nevojave të studentëve të të gjitha cikleve të studimit.</p> <p>Në takimin me punonjëset e bibliotekës ato shprehën se në rast se kërkohet nga studentët mund të jenë në dispozicion edhe përtej orareve dhe ditëve të javës.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Informacion për Bibliotekën FEUT, 2025</i></li> <li>• <i>Rregullore e Bibliotekës</i></li> <li>• <i>Vizita në Institucion</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 8.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në</p>	<p>FEUT i kushton rëndësi të veçantë pasurimit të fondit të bibliotekës me literaturë për të gjitha ciklet e studimit. Për këtë qëllim, në buxhetin e fakultetit parashikohet zëri “Blerje fond libri”, me një alokim vjetor prej 5 milionë lekësh sipas buxheteve të miratuara 2022–2024. Çdo vit, njësitë bazë përcjellin nevojat e tyre për literaturë të re, të specifikuar nga titullarët e lëndëve me të dhëna mbi titullin, autorin, shtëpinë</p>

<p>shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>botuese, vitin e botimit dhe numrin e kopjeve. Gjatë tre viteve të fundit, fondit të bibliotekës së FEUT i janë shtuar gjithsej 423 tituj të rinj. Vetëm Departamenti i Ekonomiks-it, në vitin akademik 2023–2024, ka pasuruar fondin me 43 tituj të rinj dhe 106 kopje librash.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Buxheti i miratuar 2024</i></li> <li>• <i>Informacion për Bibliotekën FEUT, 2025</i></li> <li>• <i>Kërkesa për libra të rinj nga Departamenti i Ekonomiksit</i></li> </ul> <p><i>Shpenzime të realizuara, grupuar sipas destinacionit FEUT</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>FEUT dhe Departamenti i Ekonomiksit kanë siguruar që programi i studimit Ekonomiks të ketë në përgjithësi në dispozicion literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies. Kështu, biblioteka është e pajisur me një numër të konsiderueshëm titujsh, në gjuhën shqipe si edhe në gjuhë të huaja, kryesisht anglisht. Në mënyrë të formalizuar përditësohet fondi, por nuk ka një instrument që të masë cilësinë dhe efektvitetin e përdorimit, bazuar në përdorimin e tij nga studentët dhe pedagogët. Në disa syllabuse rezultojnë që literatura të mos jetë e viteve të fundit Gjithashtu janë siguruar mjediset e mjaftueshme, biblioteka ka një sipërfaqe të konsiderueshme dhe programe online cilësore.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
			X	

<p><b>Standardi IV.4</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me</p>	<p>Njësitë kryesore të UT-së administrojnë të dhënat bazë të studentëve, duke përfshirë informacionin personal, rezultatet akademike, diplomat dhe suplementet përkatëse, të gjitha të formatuara sipas standardeve shtetërore dhe të ruajtura në mënyrë të përhershme, si në formë të shkruar ashtu edhe</p>

<p>studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>elektronike, në përputhje me Rregulloren e UT-së. Në FEUT, është formalizuar sistemi i menaxhimit të të dhënave për studentët dhe studimet. Kështu, sekretaria mësimore, bazuar në Rregulloren e saj, është përgjegjëse për mbajtjen e regjistrit të studentëve, ku përfshihen të dhënat personale, arritjet akademike dhe data e lëshimit të diplomës. Ajo administron gjithashtu dosjet e regjistrimit sipas udhëzimeve të MAS, procesverbalet e provimeve, dokumentet e transferimeve dhe ekuivalentimet e programeve apo lëndëve. Të gjitha këto dokumente origjinale ruhen në sekretari dhe në Zyrën e Protokoll-Arkivës dhe shërbejnë si bazë për lëshimin e vërtetimeve për studentët, UT-në dhe MAS-in. Paralelisht, të dhënat e studentëve regjistrohen edhe në sistemin e-student, që u ofron pedagogëve të UT-së mundësinë të menaxhojnë grupet mësimore, të hedhin notat, si dhe të kontrollojnë kërkesat për përmirësim apo ankimim të vlerësimeve.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Rregullore e Universitetit të Tiranës</i></li> <li>• <i>Rregullore e Sekretarisë Mësimore</i></li> <li>• <i>Manual përdorimi e-Student</i></li> <li>• <i>Upgrade i aplikimit softëare e-Student UT</i></li> <li>• <i>Vizita në Institucion</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Dokumentacioni që lidhet me aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik dhe personelit administrativ menaxhohet nga Dega e Burimeve Njerëzore dhe Departamentet respektive. Dokumentacioni që lidhet me aktivitetin e personelit akademik e atij ndihmës gjendet në dosjet personale që ruhen në Degën e Burimeve Njerëzore. Nuk rezulton të ketë partnerë zyrtarë të angazhuar në realizimin e programi të studimit Ekonomiks.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Dosja e personelit akademik me kontratë -Fizikisht në IAL</i></li> <li>• <i>Vizita në Institucion</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe</p>	<p>Aksesi i dedikuar dhe konfidencial u ofrohet studentëve, personelit akademik dhe ndihmës akademik përmes platformës e-student. Studentët aksesojnë këtë sistem përmes llogarive personale, po ashtu edhe personeli. Sistemi është mjaft i nevojshëm për studentët pasi përmes tij ata mund të ndjekin progresin akademik të tyre.</p>

<p>studentët e programit të studimit.</p>	<p>Gjithashtu përdoret edhe platforma Ms Teams, për marrë të gjithë informacionet e nevojshme në lidhje me kursin, si syllabusin, prezantimet në power point, detyrat e kursit, esetë etj.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Manual përdorimi e-student</i></li> <li>• <i>Manual përdorimi Microsoft teams</i></li> <li>• <i>Rregullore për funksionimin e sistemit informatik</i></li> <li>• <i>Vizita në Institucion</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Universiteti i Tiranës ka vënë në dispozicion të studentëve dhe personelit akademik platformën MS Teams, e cila përdoret për organizimin e klasave, shpërndarjen e syllabusit dhe materialeve mësimore, literaturës së rekomanduar, si dhe për menaxhimin e orareve, provimeve dhe notave. Platforma ofron komunikim interaktiv dhe shkëmbim informacioni në kohë reale midis pedagogëve dhe studentëve, duke lehtësuar ndjeshëm procesin mësimor..Aksesimi bëhet përmes adresave personale të email-it me domain <b>unitir.edu.al</b>, pjesë e paketës Office 365 të menaxhuar nga Microsoft. Kjo siguron që çdo student dhe pedagog të ketë një identitet unik brenda sistemit, duke e bërë komunikimin më të shpejtë dhe më të thjeshtë. Ky është një instruent shumë efektiv për një komunikim permanent të studentëve me pedagogët, i cili u vlerësua edhe gjatë takimeve me studentët.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Manual përdorimi i sistemit Microsoft Teams</i></li> <li>• <i>Detyra shtëpie Ms Teams</i></li> <li>• <i>Vizita në Institucionh</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Platforma digjitale MS Teams garanton në kohë reale ndjekjen e aktivitetit akademik dhe administrativ të personelit akademik, ndihmës akademik. Përmes saj gjenerohen të dhëna të cilat u shërbejnë njërive të caktuara për të përgatitur raportet pranë organeve drejtuese etj. Sistemi i brendshëm i komunikimit mundëson gjithashtu shkëmbimin e të dhënave në kohë reale tek titullarët dhe organet drejtuese. Informacioni për studentët dhe të gjithë të interesuarit përcillet edhe përmes faqes së internetit të FEUT/UT</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Rregullore për funksionimin e sistemit informatik</i></li> <li>• <i>Vizita në Institucion</i></li> </ul>

<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Fakulteti i Ekonomisë i UT-së publikon rregullisht në faqen e tij zyrtare informacione mbi programet e studimit, personelin akademik, strukturën dhe oraret mësimore, datat e provimeve dhe mbrojtjet e diplomave, si dhe mbi aktivitete të ndryshme me studentët, praktikat dhe mundësitë e mobilitetit. Të dhëna të ngjashme mbi programet dhe aktivitetet institucionale gjenden edhe në faqen zyrtare të Universitetit të Tiranës, si në gjuhën shqipe ashtu edhe në atë angleze.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Publikimi i informacioneve nga FEUT dhe UT</li> </ul>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Pranë FEUT funksionon sistemi i brendshëm i menaxhimit institucional i cili është në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit. Platformat dixhitale si e student dhe MS Teams ndihmojnë në komunikim permanent të studentëve me pedagogët si edhe ndihmojë studentët për ndjekje e ecurisë së tyre. Gjithashtu ato janë një instrument për të gjeneruar të dhëna që nevojiten për përgatitjen e raporteve të punës së strukturave të ndryshme dhe për raportim sipas shkallës së hierarkisë institucionale</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p><b>Standardi IV.5</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për</p>	<p>Veprimtaria e Universitetit të Tiranës financohet nga burime të ndryshme, përfshirë buxhetin e shtetit, tarifat e studentëve, të ardhurat nga shërbimet dhe marrëdhëniet me palë të treta, donacionet, projektet kërkimore-shkencore dhe burime të tjera të ligjshme, në përputhje me nenin 144 të Statutit. Menaxhimi financiar është përgjegjësi e Bordit të Administrimit/Administratorit, ndërsa planifikimi buxhetor afatmesëm hartohet në konsultim me strukturat akademike,</p>

<p>të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>miratohet në parim nga Senati Akademik dhe merr miratimin përfundimtar nga Bordi i Administrimit.</p> <p>Buxheti i UT-së shpërndahet sipas njësive kryesore, që janë edhe njësi shpenzuese. Institucioni harton analiza të kostos së tarifave të shkollimit për programet Bachelor të FEUT (Ekonomiks, Administrim Biznesi, Financë dhe Informatikë Ekonomike), si dhe dokumente të tjera financiare si plani buxhetor afatmesëm, plani vjetor dhe plani strategjik i zhvillimit. Gjithashtu, përgatitet raporti financiar vjetor, pjesë e raportit të përgjithshëm të institucionit, ku pasqyrohen të ardhurat sipas burimeve, shpenzimet dhe realizimi i objektivave.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Statuti i UT-së</i></li> <li>• <i>Buxheti i miratuar 2025</i></li> <li>• <i>Analizë financiare</i></li> <li>• <i>Info për grantet 2022-2023</i></li> <li>• <i>Info për grantet 2023-2024</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Nuk është hartuar një plan financimi i veçantë për këtë program studimi. Por IAL mban parasysh kostot e institucionit dhe këto reflektohen në propozimin e Njësive kryesore për kuotat dhe tarifat e studimit.</p> <p>Të dhënat për financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë janë të përllogaritura në nivel njësie kryesorë dhe jo në nivel njësie bazë .</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Buxheti i miratuar 2025</i></li> <li>• <i>Kuotat e studentëve 2023-2024</i></li> <li>• <i>Kuotat e studentëve 2024-2025</i></li> <li>• <i>Info për grantet 2022-2023</i></li> <li>• <i>Info për grantet 2023-2024</i></li> </ul>

<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Universiteti i Tiranës, si institucion publik, i nënshtrohet auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe nga Ministria përgjegjëse për Arsimin. Gjithashtu, brenda strukturës së tij administrative funksionon edhe Drejtoria e Auditit të Brendshëm, në strukturën e së cilës janë punësuar shtatë punonjës. Kjo njësi mbikqyr përputhshmërinë dhe performancën, kryen auditimin financiar të të gjitha njësive shpenzuese dhe realizon auditime të kombinuara për të siguruar përdorimin sa më efektiv dhe efikas të fondeve, në përputhje me nenin 17 të Rregullores së Administratës. Kjo drejtori është në varësi të Bordit të Administrimit. Auditimi bëhet sipas një njoftimi zyrtar dhe programi paraprak.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Informacion mbi raportin e auditimit nga KLSH dhe reflektimi i rekomandimeve</i></li> <li>• <i>Program auditimi nga BA për FEUT</i></li> <li>• <i>Shkresa Nr. 103 Prot., datë 18.01.2024, Njoftim për fillim auditimi, KLSH –Fizikisht në IAL</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Bordi i Administrimit të Universitetit të Tiranës shqyrton dhe miraton raportet dhe analizat financiare periodike të hartuara nga Drejtoria Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse në Rektorat dhe nga Administratori i UT-së. Raportet i përcillen për dijeni Senatit Akademik dhe MAS-it, ruhen dhe publikohen në faqen e transparencës së UT-së. Ato përmbajnë të dhëna të detajuara mbi realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, përfshirë pagat, sigurimet shoqërore, shpenzimet operative dhe investimet. Planifikimet dhe ndërhyrjet financiare parashikohen në buxhetet afatmesme, të cilat synojnë garantimin e funksionimit dhe mbarëvajtjes së të gjitha programeve të studimit. Nuk na rezulton të ketë raportim deri në nivelin e njësisë bazë.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Rregullore e brendshme e punës të administratës</i></li> <li>• <i>Analiza financiare</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë</p>	<p>Garancia financiare e institucionit dhe e programit është e siguruar pasi ekzistojnë burime të sigurt dhe të mjaftueshme për këtë qëllim. Të ardhurat e Fakultetit të Ekonomisë përbëhen nga granti i mësimdhënies, rimbursimi i tarifave, të ardhurat dytësore dhe fondet e trashëguara nga vitet e mëparshme. Këto burime financimi janë të mjaftueshme për të mbështetur objektivat e fakultetit në mësimdhënie, kërkim</p>

<p>normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>shkencor dhe aktivitete studentore. Planifikimet dhe ndërhyrjet financiare pasqyrohen në buxhetet afatmesme, të cilat synojnë sigurimin e funksionimit dhe mbarëvajtjes së të gjitha programeve të studimit. Nuk raportohet të ketë procedura që lidhen me “rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare ku institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve”.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Tabelat përmbledhëse (tabela 18)</li> <li>• Info për grantet 2022-2023</li> <li>• Info për grantet 2023-2024</li> <li>• Buxheti i miratuar 2025</li> </ul>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>FEUT siguron garanci financiare pasi ekzistojnë burime të sigurta dhe të mjaftueshme për këtë qëllim. Të ardhurat e Fakultetit të Ekonomisë përbëhen nga granti i mësimdhënies, rimbursimi i tarifave, të ardhurat dytësore dhe fondet e trashëguara nga vitet e mëparshme. Këto burime financimi janë të mjaftueshme për të mbështetur objektivat e fakultetit në mësimdhënie, kërkim shkencor dhe aktivitete studentore. Planifikimet dhe ndërhyrjet financiare pasqyrohen në buxhetet afatmesme, të cilat synojnë sigurimin e funksionimit dhe mbarëvajtjes së të gjitha programeve të studimit. Aktiviteti financiar është i kontrolluar përmes auditimeve. Por duhet të sigurohen raporte financiare në nivel njësie bazë.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p> <p>X</p>

<p><b>Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës IV</b></p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p> <p>X</p>
----------------------------------------------------------------	----------------------	-----------------------------	----------------------------	--------------------------------------

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

### Standardi V.1

**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.**

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>UT ka hartuar dhe miratuar dokumentet strategjike që rregullojnë hapat proceduralë që ndiqen në procesin e hyrjes dhe daljes së studentëve, duke përfshirë edhe transferimin apo mbarimin dhe heqjen e statusit të studentit si dhe pezullimin e afatit të studimeve, në ciklin e studimit bachelor. Dokumentat bazë në nivel IAL janë: Statuti i UT, Rregullorja e UT, Rregullore për diplomimin UT, por përveç tyre janë miratur dhe dokumente në nivel Fakulteti si Rregullorja e programi Bachelor e FEUT.</p> <p>Kushtet e pranimit dhe regjistrimit të studentëve janë të përcaktuara në Rregulloren e Universitetit. Kriteret e pranimit janë të përcaktuara në Rregulloren e programit Bachelor. Përmes një rregulloreje të posacme ndiqen hapat për diplomimin e studentëve të UT.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Statuti UT</i></li> <li>• <i>Rregullore e UT</i></li> <li>• <i>Rregullore e programit Bachelor FEUT</i></li> <li>• <i>Rregullore për diplomimin UT</i></li> <li>• <i>Kriteret e pranimit 2025-2026</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>FEUT si pjesë e Universitetit të Tiranës garanton lirinë akademike dhe mundësitë e barabarta për të gjithë, në përputhje me ligjin 80/2015 dhe aktet nënligjore përkatëse. Parimet themelore të përcaktuara në Statut dhe në Rregullore mbështesin meritën akademike dhe përjashtojnë çdo formë diskriminimi. Kodi i Etikës i UT-së është harmonizuar me ligjin për barazinë gjinore, ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi dhe ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale. Institucioni ka miratuar gjithashtu planin e barazisë gjinore, ka ngritur Këshillin e Etikës dhe ka rregullore të dedikuara për funksionimin e tij, si dhe për mbrojtjen e të dhënave personale. Komisioni për mbarëvajtjen me studentët ndihmon në koordinimin e punës së stafit pedagogjik, administrativ dhe studentëve, duke monitoruar zbatimin e procedurave të miratuara. FEUT dhe Departamentit të Ekonomiksit, duke respektuar legjislacionin e sipërpërmendur, garantojnë barazi dhe zbatim të Kodit të Etikës por edhe nëpërmjet kuotave të planifikuara dhe miratuara për studentët nga Trojet Shqiptare dhe ata të huaj. Institucioni mbështet gjithashtu studentët nga shtresat në nevojë përmes kuotave të veçanta, lehtësirave në tarifa dhe bursave mujore. Përmes një dokumenti të veçantë</p>

	<p>rregullohen politikat dhe procedurat për eliminimin e dhunës, ngacmimin dhe ngacmimin seksual</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Statuti UT</i></li> <li>• <i>Kodi i Etikës</i></li> <li>• <i>Plani i barazisë gjinore</i></li> <li>• <i>Vendim për miratimin e planit të barazisë gjinore</i></li> <li>• <i>Vendim për miratimin dhe funksionimin e Këshillit të Etikës</i></li> <li>• <i>Dokument mbi politikat dhe procedurat për eliminimin e dhunës, ngacmimin dhe ngacmimin seksual</i></li> <li>• <i>Rregullore për organizimin dhe funksionimin e këshillit të etikës</i></li> <li>• <i>Rregullore për mbrojtjen, përpunimin e të dhënave personale</i></li> <li>• <i>Vendim SA nr.6 datë 13.03.2024 për miratimin e kuotave të pranimit</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Sipas Statutit, departamentet propozojnë ëdo vit akademik kuotat dhe kriteret e pranimit, të cilat miratohen nga Senati Akademik dhe publikohen çdo vit në faqen zyrtare të UT-së. Programi parashikon kuota dhe procedura të veçanta për studentët nga Kosova, kandidatët me origjinë shqiptare nga Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, si dhe për kategori të tjera si jetimët, personat me aftësi të kufizuara, kandidatët nga komuniteti rom dhe egjiptian, studentët që kërkojnë transferim studimesh dhe shtetasit e huaj. Për studentët e huaj janë përcaktuar procedurat ligjore për njohjen dhe ekuivalentimin e diplomave.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Rregullore e Programit të studimit Bachelor</i></li> <li>• <i>Statuti UT</i></li> <li>• <i>Kuotat e studentëve 2023-2024</i></li> <li>• <i>Kuotat e studentëve 2024-2025</i></li> <li>• <i>Propozim kuotash 2024-2025</i></li> <li>• <i>Kriteret e pranimit 2024 2025</i></li> <li>• <i>Kriteret e pranimit 2025 2026</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së</p>	<p>Transparenca me studentët në Fakultetin e Ekonomisë dhe në Universitetin e Tiranës sigurohet përmes publikimit të të gjitha kriterëve, procedurave të pranimit, përzgjedhjes dhe</p>

<p>studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>listave përfundimtare të fituesve në faqet zyrtare, duke i bërë ato lehtësisht të aksesueshme. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme, pasi janë shkruar me një gjuhë të thjeshtë në rregulloret përkatëse, të cilat u bëhen të njohura studentëve në fillim dhe përgjatë kursit të studimeve. Përveç këtyre, Departamenti i Ekonomiksit ka hartuar një Guidë të Departamentit dhe një Guidë studentore, të cilat ofrojnë informacion të detajuar mbi programin Bachelor në “Ekonomiks”. Studentët ndjekin edhe Programe Erasmus për të cilat u mundësohet njohja e studimeve përkatëse.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Rregullore e Universitetit të Tiranës</i></li> <li>• <i>Rregullore e programit Bachelor FEUT</i></li> <li>• <i>Rregullore për diplomimin UT</i></li> <li>• <i>Guida e departamentit të Ekonomiksit</i></li> <li>• <i>Guida studentore</i></li> <li>• <i>Studentë FE Erasmus</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Kriteret e aplikimit për programin Bachelor në: “Ekonomiks” publikohen çdo vit në faqen zyrtare të Fakultetit të Ekonomisë dhe të UT-së, pasi miratohen nga Senati Akademik, duke garantuar transparencë dhe akses për të gjithë kandidatët. Për studentët potencialë, Departamenti i Ekonomiksit ka përgatitur një Guidë informuese, ku jepen të dhëna mbi profilin e programit (“Çfarë studion Ekonomiksi”), mundësitë e punësimit pas diplomimit dhe këshilla të përgjithshme për zgjedhjen e degës.</p> <p>Departamenti merr pjesë aktivisht në fushata informuese dhe ditë të hapura me maturantët, duke ofruar informacion të detajuar mbi programin dhe mundësitë e studimit. Çdo vit, Fakulteti pret nxënës të shkollave të mesme për takime me Përgjegjësin e Departamentit dhe stafin akademik, ku prezantohet oferta studimore. Përveç guidës, departamenti ka përgatitur fletëpalosje dhe prezantime me video, duke përdorur teknologjinë për të afruar informacionin tek të rinjtë. Në dokumentacion shoqërohen gjithashtu evidenca fotografike nga këto aktivitete.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Statuti i UT -së</i></li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Kriteret e pranimit 2024 – 2025</i></li> <li>• <i>Fakulteti i Ekonomisë organizon open day</i></li> <li>• <i>Ëork and study një hap më afër maturantëve</i></li> <li>• <i>Dita e informimit Departamenti i Ekonomiksit</i></li> <li>• <i>Guida e departamentit të Ekonomiksit</i></li> <li>• <i>Guida studentore</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Senati i Universitetit të Tiranës miraton çdo vit kriteret e pranimit dhe kuotat për programet e studimit, duke përfshirë edhe ato për individë nga kategori të veçanta sociale si personat me aftësi të kufizuara, kandidatët nga pakicat dhe shtresat e marginalizuara. Për vitin akademik 2024–2025, për programin Bachelor në: “Ekonomiks” janë përcaktuar: 100 kuota për kandidatët brenda vendit, 2 kuota për program të dytë studimi, 10 kuota për transferim, 2 kuota për shtetas të huaj, 2 për jetimë, 2 për persona me aftësi të kufizuara, 2 për kandidatë romë dhe 10 kuota për studentë nga trojet shqiptare.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Kriteret e pranimit 2024 -2025</i></li> <li>• <i>Kriteret e pranimit 2025-2026</i></li> <li>• <i>Propozim kuotash 2024-2025</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Çdo vit akademik, programi i studimit parashikon kuota të dedikuara për studentët e huaj. Sipas nenit 13 të Rregullores së programit Bachelor, ata duhet të kryejnë konvertimin e diplomës, të plotësojnë kriteret ligjore të përcaktuara nga ligji 80/2015, kriteret e pranimit të vendosura nga Fakulteti i Ekonomisë, si dhe kriterin e notës mesatare të përcaktuar me VKM. Për vitin akademik 2024–2025 janë caktuar 2 kuota për studentët e huaj.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Rregullore e programit Bachelor</i></li> <li>• <i>Propozim kuotash 2024-2025</i></li> <li>• <i>Kriteret e pranimit 2024 2025</i></li> <li>• <i>Kriteret e pranimit 2025-2026</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për</p>	<p>Politikat në lidhje me bursat dhe tarifat e reduktuara janë të përcaktuara nga legjislacioni kombëtar dhe VKM përkatëse. UT ndjek dhe zbaton kriteret e përcaktuara për ofimin e bursave/tarifave të reduktuara. Departamenti i Ekonomiksit dhe Fakulteti i Ekonomisë nuk kanë programe studimi prioritare.</p>

zhvillimin ekonomik të vendit.	<b>Referenca:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• VB-29, tarifat e regjistrimit dhe shkollimit</li> <li>• Tarifë shkollimi bachelor e reduktuar 50%</li> <li>• Tarifë shkollimi vjetore Bachelor program i dytë</li> <li>• Tarifë shkollimi vjetore Bachelor program i parë</li> </ul>			
<b>Konkluzione</b>	FEUT si pjesë e UT zbaton politika dhe procedura të formalizuara në rregulloret përkatëse në nivel IAL dhe Fakulteti për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit. FEUT dhe Departamenti i Ekonomiksit ka hartuar edhe dokumnetacion specifik siç është Guida e Programit dhe Guida Studentore. FEUT ndjek procedura dhe politika lidhur me bursat, mbshetjen e shtresave në nevojë, studentët e huaj , studentët nga trojet, në zbatim të kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<b>Standardi V.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Në rregulloret e UT-së dhe të programit Bachelor ka informacion mbi kalimin e studentëve nga një vit në tjetrin, kreditet që duhet të marrin si edhe kalimi në sezonin pasardhës. Progresi akademik monitorohet përmes platformës e-student, ku çdo student ka qasje individuale mbi notat, kreditet dhe ngarkesën mësimore. Përveç kësaj, informacioni u ofrohet studentëve përmes faqes zyrtare të Fakultetit, përgjegjësit të Departamentit, stafit akademik, sekretarisë mësimore dhe koordinatorit të programit, ndërsa rregulloret janë të publikuara online dhe të aksesueshme për të gjithë.  <b>Referenca:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rregullore për diplomimin UT</li> <li>• Rregullore e Universitetit të Tiranës</li> <li>• Rregullore e programit Bachelor FEUT</li> <li>• Ëëbsite i FEUT <a href="http://ëë.feut.edu.al">ëë.feut.edu.al</a></li> </ul>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në	Në përputhje me ligjin 80/2015 dhe udhëzimet e Ministrisë së Arsimit, dhe Sportit, Universiteti i Tiranës ka të përcaktuara

<p>lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>qartë procedurat për njohjen e kualifikimeve të mëparshme dhe transferimin e studentëve. Ato janë formalizuar përmes Statutit dhe Rregullores së UT dhe Rregullores së Programit Bachelor. Procedurat, të harmonizuara edhe me udhëzimet e Qendrës së Shërbimeve Arsimore, janë transparente dhe të publikuara në faqen zyrtare të UT-së.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Statuti UT</i></li> <li>• <i>Rregullore e UT</i></li> <li>• <i>Rregullore e programit Bachelor FEUT</i></li> <li>• <i>Website <a href="http://www.unitir.edu.al">www.unitir.edu.al</a></i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Studentët e programit Bachelor në: “Ekonomiks” informohen që në fillim të vitit akademik mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit, të cilat pasqyrohen në syllabus-in e çdo lënde. Për secilin modul përcaktohen format e kontrollit të vazhdueshëm dhe pesha e tyre në vlerësimin përfundimtar. Në përputhje me rregulloret e UT-së dhe të programit Bachelor, vlerësimi bazohet në kombinimin e kontrollit të vazhdueshëm gjatë vitit (përmes testeve me shkrim e me gojë, detyrave të kursit, projekteve, prezantimeve, eseve dhe formave të tjera të angazhimit) dhe provimit përfundimtar. Gjatë takimit me pedagogët e Departamentit si dhe nga konsultimi i syllabuseve u informuam se raporti i pikëve mes vlerësimit të vazhdueshëm dhe provimit përfundimtar varion sipas lëndëve në nivelet 30%-70% ose 20%-80%. Në këndvështrimin tonë raporti duhet të rishikohet, në mënyrë që të ketë më shumë peshë vlerësimi i vazhdueshëm përmes projekteve e detyrave të kursit, për ta bërë procesin e mësimdhënies më të lidhur me praktikën dhe me metodat inovative. Në rregullore përcaktohen edhe kriteret për të hyrë në provim që lidhen me frekuentimin e leksioneve dhe seminareve dhe shlyerjen e projekteve të kursit. Gjithashtu përcaktohet edhe numri i pikëve përkundrejt totalit që duhet të fitohen për të marrë notë kaluese. Të gjitha rregulloret përkatëse janë të publikuara në faqen zyrtare të UT-së dhe/ose të Fakultetit të Ekonomisë.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Rregullore e Universitetit të Tiranës</i></li> <li>• <i>Rregullore e programit Bachelor FEUT</i></li> <li>• <i>Format Vlerësimi</i></li> <li>• <i>Plan Seminari Hyrje në Ekonomi</i></li> </ul>

<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Syllabuset e lëndëve</i></li> </ul> <p>Punimi dhe mbrojtja e diplomës përbëjnë një element të detyrueshëm të planit mësimor të programit Bachelor në: “Ekonomiks”. Në fillim të semestrit të dytë të vitit të tretë, studentët informohen nga përgjegjësi i departamentit mbi procedurat dhe kriteret teknike të diplomimit, ndërsa pas caktimit të pedagogut udhëheqës marrin udhëzime më të detajuara prej tij. Departamenti ka përgatitur një Udhëzues të posaçëm për përgatitjen e temës, në formë elektronike dhe fizike, ku përcaktohen qartë standardet e origjinalitetit, formatit, stilit të shkrimit, mënyrës së citimit dhe kërkesat akademike, duke theksuar trajtimin e një problematike të lidhur me fushën e studimit.</p> <p>Procedurat e diplomimit janë të parashikuara në rregulloret e UT-së dhe të programit Bachelor, ndërsa datat e mbrojtjes publikohen në faqen e FEUT. Studentët udhëzohen gjithashtu nga pedagogu drejtues për dorëzimin e punimit, CD-së dhe vetëdeklarimit të origjinalitetit.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Rregullore e Universitetit të Tiranës</i></li> <li>• <i>Rregullore për diplomimin UT</i></li> <li>• <i>Rregullore e programit Bachelor FEUT</i></li> <li>• <i>Udhëzues punim diplome</i></li> <li>• <i>Plani mësimor Bachelor Ekonomiks</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Departamenti i Ekonomiksit ka hartuar një Guidë të Departamentit, fletëpalosje informuese, prezantime video dhe ka vendosur materiale në faqen zyrtare të Fakultetit të Ekonomisë. Krahas këtyre, në kuadër të aktiviteteve promovuese të organizuara nga FEUT dhe UT, departamenti ka marrë pjesë në panairë si Work &amp; Study 2025, i zhvilluar në disa qytete të vendit, si dhe në aktivitetin Open Day të Fakultetit të Ekonomisë, përmes të cilave u jeoet maturantëve informacion i plotë mbi programin e Ekonomiksit.</p> <p>Gjithashtu, Guida studentore dhe Guida e departamentit shërbejnë si mjete praktike për studentët, duke përcjellë informacion të rëndësishëm mbi programin e studimit dhe jetën akademike.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Vendim për emërtimin e koordinatorit të programit të studimit</i></li> <li>• <i>Fakulteti i Ekonomisë organizon Open Day</i></li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Ëork and Study, një hap më afër maturanteve</i></li> <li>• <i>Dita e informimit Departamenti i Ekonomiksit</i></li> <li>• <i>Guida e departamentit të Ekonomiksit</i></li> <li>• <i>Guida studentore</i></li> </ul>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Institucioni i arsimit të lartë siguron informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program. Informimi i studentëve bëhet për të gjithë hapat e ndjekjes së studimeve. Për këtë qëllim bëhen transparente Rregulloret e UT por edhe dokumentat e posaçme të FEUT/Departamenti i Ekonomiksit si Guida e programit dhe guida studentore. Studentët informohen edhe mbi kriteret e vlerësimit, të ndjekjes së leksioneve e seminareve si dhe pikët për të qënë kalues.</i></p> <p><i>Rekomandim: Të ketë një raport më të drejtë në funksion të njohurive praktike: më shumë pikë për vlerësimin e vazhduar në raport me provimin përfundimtar</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	<p>Fakulteti i Ekonomisë ofron informacion të detajuar për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit të ciklit të parë në Ekonomiks si në në faqen zyrtare ashtu edhe përmes Guidës së Departamentit të Ekonomiksit. Gjithashtu, çdo fillim viti akademik organizohet një takim informues nga Përgjegjësi i Departamentit me studentët e vitit të parë, ku marrin pjesë edhe pedagogët dhe shpërndalet guida përkatëse. Gjithashtu, Universiteti i Tiranës ka ngritur një komision për mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe marrëdhënieve me studentët, që funksionon sipas një rregulloreje specifike. Ky komision bashkërendon punën ndërmjet stafit pedagogjik, administrativ dhe studentëve, dhe monitoron zbatimin e procedurave për procesin mësimor në aspektin e mësimdhënies dhe mësimnxënies.</p> <p><b>Referenca:</b></p>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Rregullore e programit bachelor FEUT</i></li> <li>• <i>Guida e departamentit të Ekonomiksit</i></li> <li>• <i>Rregullore e komisionit të mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe marrëdhëniet me studentët</i></li> <li>• <i>Takim me studentët e vitit të parë 2023 2024</i></li> <li>• <i>Vizita në Institucion</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Stafi akademik i programit të studimit në Ekonomiks u vë në dispozicion studentëve syllabusin e lëndës, në të cilin jepet informacion mbi literaturën bazë të detyrueshme si edhe burimet plotësuese të informacionit. Në syllabus specifikohen gjithashtu format e kontrollit të dijeve dhe afatet për shlyerjen e detyrimeve. Informacioni shpërndahet në forma të ndryshme, në varësi të pedagogut: në version të printuar, përmes email-it zyrtar, ose në MS Teams. Për lëndët me detyra shtëpie apo detyra kursi, pedagogu jep udhëzime të qarta në përputhje me programin e studimit.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Detyra shtëpie (Hyrje në ekonomi)</i></li> <li>• <i>Detyra shtëpie (mikroekonomi)</i></li> <li>• <i>Syllabuset e lëndëve</i></li> <li>• <i>Detyrë shtëpie MS Teams</i></li> <li>• <i>Screenshot email me temat e kursit</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Informimi dhe krijimi i mundësive të punësimit bazohet në:</p> <p>a) marrëveshjet e bashkëpunimit me organizata, ndërmarrje dhe institucione, (45 të tilla të vnëshkruara) ku studentët zhvillojnë praktikën profesionale (internship) dhe kanë mundësi të punësohen, b) javën e orientimit, c) aktivitetet e Zyrës së Karrierës, ku studentët informohen për mundësitë e punësimit pas studimeve.</p> <p>Gjithashtu, ata mbështeten edhe nga pedagogët udhëheqës të diplomës dhe përgjegjësi i departamentit, duke ndihmuar dhe këshilluar në përzgjedhjen e vendit të praktikës me potencial punësimi.</p> <p>Veçohet si ngjarje e rëndësishme për këtë qëllim edhe Panairi i Punës, i organizuar çdo vit nga FEUT, ku studentët takohen me institucione publike dhe kompani private për mundësi punësimi.</p> <p>Njoftime për oferta pune ka dhe Programi Kombëtar i Praktikave të Punës publikohen në faqen zyrtare të fakultetit.</p>

	<p>Pas panairit, shpërndahen pyetësorë vlerësimi për studentët dhe kompanitë, dhe mbi bazën e tyre, Zyra e Karrierës harton një raport vlerësimi për përmirësimin e vazhdueshëm të aktivitetit.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Aktivitete të zyrës të karrierës</i></li> <li>• <i>Raport mbi ditën e Karrierës</i></li> <li>• <i>Njoftime punësimi</i></li> <li>• <i>Panairi i Punës FEUT</i></li> <li>• <i>Raport dita e karrierës 2025</i></li> <li>• <i>Formular vlerësimi kompanitë në ditën e karrierës</i></li> <li>• <i>Formular vlerësimi studentët në ditën e karrierës</i></li> <li>• <i>Marrëveshjet ndërinstucionale</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Studentët informohen nga Përgjegjësi i Departamentit, pedagogët dhe koordinatori i programit mbi organizimin e procesit mësimor, infrastrukturën dhe shërbimet mbështetëse të institucionit. Ata gjithashtu, udhëzohen për të përdorur faqen zyrtare të fakultetit, ku gjenden: struktura mësimore për çdo semestër, orari i mësimit, mjediset dhe emrat e pedagogëve përgjegjës. Për informimin dhe mbështetjen e tyre janë përgjegjës Dega Mësimore dhe Dega e Procesit Mësimor, nën mbikqirjen e Zv. Dekanit për anën Mësimore, Aktivitetet Studentore dhe Komunikimin. Informacion i përgjithshëm ofrohet edhe përmes Guidës së Studentit FEUT, që përfshin të dhëna për bibliotekën, laboratorët, zyrën e karrierës, etj. Të gjithë studentët pajisen me një adresë zyrtare emaili dhe përmes saj marrin njoftime mbi aktivitete dhe programe shkëmbimi. Për ndjekjen e ecurisë akademike, ata përdorin platformën e-Student.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Struktura Mësimore</i></li> <li>• <i>Orari mësimor bachelor në Ekonomiks</i></li> <li>• <i>Guida e departamentit të Ekonomiksit</i></li> <li>• <i>Vendim për emërtimin e koordinatorit të programit të studimit</i></li> <li>• <i>Përdorues të SIM -print screen</i></li> <li>• <i>Manual përdorimi e-student</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të</p>	<p>Për të ofruar informacion pedagogët përdorin platformën MS Teams, ndërsa Institucioni përdor faqen zyrtare të Fakultetit të Ekonomisë (<a href="http://www.feut.edu.al">www.feut.edu.al</a>), e cila rifreskohet në kohë reale. Gjatë takimit me studentët u theksua se ata kanë akses</p>

<p>menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>lehtësisht në të dhe vlerësohet nga studentët si e thjeshtë në përdorim. Informacionet mbi procesin mësimor, rregulloret, mundësitë e punësimit dhe aplikimet në programe si Erasmus+ publikohen në faqen e FEUT dhe në faqen zyrtare të UT: <a href="http://www.unitir.edu.al">www.unitir.edu.al</a></p> <p>Për ndjekjen e progresit akademik, studentët përdorin platformën e-Student, e cila është funksionale dhe e aksesueshme për të gjithë studentët e regjistruar. Studentët progresin akademik të tyre mund ta ndjekin në e- Student, platformë funksionale online për të gjithë studentët e regjistruar. Studentët konfirmojnë përdorimin e kësaj platforme lehtësisht dhe e vlerësojnë atë si funksionale dhe të dobishme për ndjekjen e ecurisë së tyre.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Manual përdorimi e-student,</li> <li>• Manual përdorimi microsoft teams</li> <li>• Përdorues të SIM print screen</li> </ul>								
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Institucioni i arsimit të lartë ka marrë të gjitha masat për të vënë në dispozicion të studentëve informacion të plotë, të thjeshtë dhe të hollësishëm mbi objektivat e programit të studimit, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit. Informacioni sigurohet përmes instrumentave të ndryshëm si Guida, website, por edhe përmes takimeve të organizuara me studentët në nivel Departamenti. Informimi i studentëve bëhet në vijimësi, duke u bazuar në nevojat e tyre që nga hyrja në Universitet e deri tek mundësitë e punësimit pas përfundimit të ciklit të studimeve. Institucioni, përmes marrëveshjeve me kompani apo dikastere të ndryshme, synon të krijojë akses të studentëve në tregun e punës.</i></p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="595 1458 775 1536">Nuk përmbushet</th> <th data-bbox="775 1458 963 1536">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="963 1458 1161 1536">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1161 1458 1378 1536">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<p><b>Standardi V.4</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon</b></p>	<p>Departamenti i Ekonomiksit i Fakultetit të Ekonomisë mban statistika vjetore mbi numrin e studentëve të diplomuar në</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

<p>dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>ciklin e parë të studimeve. (kështu, na u vu në dispozicion shifrat që lidhen me numrin e të diplomuarve për vitin akademik 2023–2024, janë 59 studentë që përfaqësojnë rreth 70% të studentëve të vitit të tretë). Sttistikat shërbejnë edhe si inpute për Raportin vjetor të punës, që përgatitet nga Departamenti. Këto inpute i shërbejnë vlerësimit me tregues sasiore të mësimdhënies përmes treguesve të matshëm si numri i të diplomuarve dhe nota mesatare. Ky raport shërben si bazë për raportin e veprimtarisë së Fakultetit. Pedagogët mbajnë gjithashtu regjistra individualë me të dhëna të detajuara për studentët. Statistikat janë të disponueshme edhe në sistem dhe në sekretarinë mësimore. Kështu, vlerësimet e diplomës hidhen në sistemin online të UT nga pedagogët e komisionit dhe janë të aksesueshme për studentët. Procesverbalet dorëzohen gjithashtu në sekretarinë mësimore, e cila administron regjistrat zyrtarë të notave dhe diplomimeve.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Raport Vjetor Departamenti Ekonomiksit 2023-2024</i></li> <li>• <i>Raporti vjetor FEUT 2022-2023</i></li> <li>• <i>Raporti vjetor FEUT 2023-2024</i></li> <li>• <i>Studente te regjistruar FE 2022-2023</i></li> <li>• <i>Studente te regjistruar FE 2023-2024</i></li> <li>• <i>Të dhëna për numrin e studentëve</i></li> <li>• <i>Regjistër i seminareve</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Fakulteti i Ekonomisë administron statistika vjetore mbi: numrin e studentëve të regjistruar në programet e ciklit të parë, tërheqjet nga programi, largimet ose mospërfundimet me sukses të vitit akademik. Këto statistika mbahen në regjistrat përkatës, si: Regjistri themeltar i studentëve, Regjistri i arritjeve akademike, Regjistri i diplomave dhe certifikatave. Të dhënat ruhen dhe përpunohen në sistemin informatik të UT, ku informacioni arsimor hidhet nga pedagogët pas përfundimit të provimeve, sipas afateve të përcaktuara. Më pas, këto të dhëna arkivohen nga sekretaria mësimore. Çdo pedagog dorëzon në departament edhe një përmbledhje mbi kalueshmërinë dhe notën mesatare. Këto të dhëna përfshihen në Raportin Vjetor të Departamentit dhe Raportin Vjetor të Fakultetit të Ekonomisë (FEUT).</p> <p>Gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore konsultuam regjistrat përkatës dhe u njohëm me informacionin përkatës. Vumë re se nga Ministria ishin vënë në dispozicion disa regjistra të</p>

	<p>formateve tepër të mëdha, të cilat ishin të papërshtatshëm. Kjo problematikë u ngrit edhe nga Sekretaria mësimore.</p> <p>Numri i studentëve të regjistruar për tri vite akademike është si më poshtë:  2022-2023:101 studentë  2023-2024: 89 studentë  2024-2025: 84 studentë</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Rregullore e UT</i></li> <li>• <i>Rregullore e sekretarisë mësimore FE</i></li> <li>• <i>Raport Vjetor Departamenti Ekonomiksit 2023-2024</i></li> <li>• <i>Raporti vjetor FEUT 2022-2023</i></li> <li>• <i>Raporti vjetor FEUT 2023-2024</i></li> <li>• <i>Tabelat përmbledhëse (tabela 21)</i></li> <li>• <i>Të dhëna për numrin e studentëve</i></li> <li>• <i>Përdorues të SIM – print screen</i></li> <li>• <i>Vizita në Institucion</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Universiteti i Tiranës (UT) përdor një sistem të brendshëm elektronik për menaxhimin e të dhënave akademike të studentëve. Të dhënat statistikore përgatiten dhe ruhen në mënyrë elektronike dhe fizike nga personeli i autorizuar, kryesisht sekretaria mësimore. Sistemi informatik për sekretarinë mësimore përfshin të gjithë aspektet që lidhen me ecurinë e studentëve si të dhëna për regjistrimin e studentëve, të dhënat personale në sistem, regjistrimin në grupe mësimore, kalimin e studentëve në vitin pasardhës sipas krediteve të fituara, regjistrimin e studentëve të transferuar, listën e notave për studentët aktivë, etj</p> <p>Të gjitha dokumentet janë të kontrollueshme dhe të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Rregullore e sekretarisë mësimore FE</i></li> <li>• <i>Rregullore për funksionimin e sistemit informatik</i></li> <li>• <i>Rregullorja e Universitetit të Tiranës</i></li> <li>• <i>Vizita në Institucion</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë</p>	<p>Nga ana institucionale procesi sigurohet përmes Degës Mësimore dhe Degës së Procesit Mësimor që drejtohen nga Zv. Dekani për Anën Mësimore, Aktivitetet Studentore dhe Komunikimin. Aktiviteti i tyre formalizohet përmes</p>

<p>njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Rregullores së sekretarisë mësimore, për kontrollin e saktësisë së informacionit dhe dokumentacionit lidhur me studentët dhe aktivitetet përkatëse, në përputhje me Rregulloren e UT.</p> <p>Universiteti i Tiranës përdor një sistem të brendshëm informatik për menaxhimin e informacionit akademik, i cili përpunon dhe menaxhon të gjitha të dhënat arsimore të UT. në sistem, sipas Rregullores për funksionimin e sistemit informatik. Auditimi përfshin kontrole sistematike dhe sporadike të procedurave funksionale për të verifikuar përputhshmërinë me rregulloret përkatëse, dhe në përfundim hartohet një relacion i detajuar i auditimit.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Rregullore e sekretarisë mësimore</i></li> <li>• <i>Rregullore e Universitetit të Tiranës</i></li> <li>• <i>Rregullore për funksionimin e sistemit informatik</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Departamenti i Ekonomiksit mbledh të dhëna periodike mbi ecurinë akademike të studentëve, duke nisur nga regjistrimi, nota mesatare hyrëse dhe progresi akademik në çdo semestër. Këto të dhëna përfshihen në raportin vjetor të departamentit dhe shërbejnë për analizë dhe përmirësim të programeve të studimit. Gjithashtu është bërë edhe një studim lidhur me punësimin përmes të cilit jepen të dhëna mbi numrin e studentëve të punësuar, profilin, sektorët ku punësohen, rajonin ku mund të punësohen, etj.</p> <p>Databaza ALUMNI është burim i rëndësishëm për informacion mbi punësimin dhe zhvillimin profesional të të diplomuarve, dhe përditësohet vazhdimisht.</p> <p>Specialisti për këshillimin e karrierës bashkëpunon me departamentet për gjurmimin dhe përditësimin e të dhënave mbi punësimin e studentëve, dhe menaxhon informacionin për vendet e punës, programet e internship-it dhe shërbimet e tjera që ofron FEUT.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Raport Vjetor Departamenti Ekonomiksit 2023-2024</i></li> <li>• <i>Studimi i tregut të punës UT 2022</i></li> <li>• <i>Studimi i tregut të punës i Departamentit të Ekonomiksit</i></li> <li>• <i>Aktivitete të zyrës të karrierës</i></li> <li>• <i>Raport mbi Qendrën e Karrierës</i></li> </ul>

<b>Konkluzione</b>	<i>Institucioni i arsimit të lartë ka organizuar strukturat dhe ka miratuar aktet që rregullojnë procesin e mbledhjes, administrimit, përditësimit të të dhënave të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre. Konkretisht ky sistem ka në përbërje Degën Mësimore, degën e procesit mësimor si edhe zyrën e Karrierës, të cilat bashkëpunojnë ngushtë më Departamentin për përgatitjen e raporteve vjetore që analizojnë ecurinë e studimeve. Nuk ka raport për cilësinë e punësimit me masa konkrete për përmirësimin e situatës.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	<p>Universiteti i Tiranës garanton përfaqësimin e studentëve në organet drejtuese dhe vendimmarrëse, në përputhje me ligjin 80/2015 dhe Statutin e UT-së. Studentët kanë të drejtë të kenë përfaqësues në Senatin Akademik, Këshillin e Etikës, komisionet e përhershme dhe në këshillat studentorë. Për këshillat studentorë të fakulteteve është miratuar një rregullore që parashikon pesë anëtarë me mandat dyvjeçar, përfaqësues nga çdo vit i programeve Bachelor dhe Master.</p> <p>Studentët marrin pjesë edhe në proceset zgjedhore si pjesë e Komisionit Institucional të Zgjedhjeve, komisioneve të fakulteteve dhe qendrave të votimit. Statuti dhe rregulloret përcaktojnë kriteret për zgjedhjen e tyre. Në organet kolegjiale të UT-së, përfaqësimi i studentëve është i strukturuar si vijon: 4 në Senatin Akademik, 3 në Komisionin e Marrëdhënieve me Studentët, 3 në Komisionin e Sigurimit të Cilësisë, 2 në Komisionin e Kurrikulës dhe 2 në Këshillin e Etikës. Studentët që takuam nuk kishin shumë informacion për përfaqësuesit e tyre në këto struktura</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Statuti UT</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Rregullore e KIZ-it për organizmin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe senatin e UT,</i></li> <li>• <i>Rregullore për zgjedhjet e para të këshillave të studentëve, UT</i></li> <li>• <i>Vizita në Institucion</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Universiteti i Tiranës garanton përfshirjen e studentëve në nivele të ndryshme të vendimmarrjes dhe veprimtarive, në përputhje me Statutin e tij. Studentët janë të përfshirë në Grupet e Vlerësimit të Brendshëm (GVB) si në proceset e akreditimit institucional, ashtu edhe në akreditimin e programeve të studimit, si dhe kanë përfaqësim në NJSBC. Gjatë takimit të GVB, ne u njohëm edhe me studenten që ishte pjesë e këtij grupi.</p> <p>Nga intervistat dhe dokumentet mbështetëse evidentohet se studentët kontribuojnë me mendime dhe propozime konkrete për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, kurrikulave dhe adresimin e shqetësimeve të tyre. Këto sugjerime përcillen përmes takimeve me koordinatorët e programeve të studimit, diskutohen në nivel departamenti dhe pasqyrohen në procesverbale dhe raporte vjetore. Vërehet se pjesëmarrja e tyre shoqërohet me veprime konkrete, duke e bërë përfshirjen e studentëve të matshme, të verifikueshme dhe të dobishme për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë akademike.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Shkresa për GVB</i></li> <li>• <i>Përbërja e komisionit të NJSBC 2024-2025</i></li> <li>• <i>Tabela përmbledhëse (tabela 24)</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Përfaqësimi i studentëve në procese të rëndësishme vendimmarrëse sigurohet përmes faktit që ata janë pjesë e Grupeve të Vlerësimit të Brendshëm (GVB) dhe Komisionit të Kurrikulës. Gjithashtu, çdo semestër shpërndahen formularë vlerësimi të cilët plotësohen nga studentët përpara sezonit të provimeve. Praktika e shpalljes së rezultateve pas përfundimit të provimeve garanton objektivitet dhe shmang çdo mundësi ndikimi në vlerësim. Të dhënat e mbledhura përpunohen nga NJSBC dhe përcillen në mënyrë të sintetizuar tek Drejtuesi i Departamentit. Gjetjet dhe problematikat e evidentuara diskutohen në mbledhjet e departamentit dhe përfshihen në raportin vjetor të punës. Pyetësori i studentëve nuk përmban në fakt pyetje konkrete për programin e studimit Vërehet gjithashtu se, përveç mekanizmave formalë, studentët</p>

	<p>kanë mundësi të shprehin sugjerime ose shqetësime edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë pranë pedagogëve dhe përgjegjës të departamentit. Këto praktika tregojnë se ekziston një sistem i hapur dhe funksional komunikimi, që ndihmon në identifikimin dhe adresimin e shpejtë të çështjeve të ngritura nga studentët.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Paketa e instrumenteve të cilësisë UT</i></li> <li>• <i>Raport Vjetor Departamenti Ekonomiksit 2023-2024</i></li> <li>• <i>Raporti i NJSBC</i></li> <li>• <i>Rezultatet e vlerësimit të paketës të instrumentave të cilësisë</i></li> <li>• <i>Model formulari vlerësimi i lëndës nga studenti</i></li> <li>• <i>Vizita në Institucion</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Procesi i vlerësimit të studentëve në Universitetin e Tiranës zhvillohet në përputhje me rregulloren e programit Bachelor dhe syllabus-in e çdo lënde, duke garantuar transparencë dhe respektim të standardeve akademike. Në bazë të neneve 61 dhe 62 të Rregullores së UT-së dhe nenit 31 të Rregullores së programit Bachelor, studentëve u njihet e drejta e ankimimit të strukturuar: brenda 24 orëve për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit dhe brenda 48 orëve për vlerësimin përfundimtar, duke iu drejtuar drejtuesit të njësisë bazë.</p> <p>Në praktikë, studentët informohen zyrtarisht për zgjidhjen e tezës dhe datën e shpalljes së rezultateve, duke u garantuar e drejta për të parë provimin, për të marrë fotokopjen e tij dhe, në rast ankimimi të mëtejshëm, për të kërkuar rivlerësim nga një komision i posaçëm. Evidencat tregojnë se këto të drejta janë respektuar me korrektësi nga departamenti, duke siguruar një mekanizëm funksional dhe të besueshëm për adresimin e ankesave të studentëve.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Rregullore e Universitetit të Tiranës</i></li> <li>• <i>Rregullore e programit Bachelor FEUT</i></li> </ul>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>FEUT përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese. Studentët kanë të drejtë të kenë përfaqësues në Senatin Akademik, Këshillin e Etikës, komisionet e përhershme dhe në këshillat studentorë si edhe në GVB. Studentët në takime të organizuara si edhe në komunikime me koordinatorët e programit dhe pedagogët japin mendime në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e</i></p>

	<i>përmirësimin të programeve të studimit. Gjatë vizitës në institucion u informuam për një rast konkret lidhur me një lëndë e cila u spostua nga viti i parë në të dytin bazuar në kërkesën e studentëve. FEUT ka miratuar procedurat që lidhen me vlerësimin dhe ankimimin dhe studentët i njohin dhe shprehen të kënaqur me to. Në kudër të sigurimit të cilësisë studentët kontribuojnë përmes pyetësorëve, por pyetësorët nuk përmbajnë rubrikë që lidhet me programin e studimit</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi V.6

**Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	<p>Universiteti i Tiranës ka ngritur struktura të dedikuara për informimin dhe shërbimin ndaj studentëve, të cilat funksionojnë në përputhje me rregulloret e brendshme, të cilat sigurojnë një komunikim të vazhdueshëm, duke mbështetur jetën studentore, bashkëpunimin me pedagogët tutorë dhe përmirësimin e mbarëvajtjes akademike.</p> <p>Në nivel fakulteti, FEUT ka ngritur struktura të posaçme si Dega e Ekselencës dhe Zhvillimit të Karrierës dhe Dega e Komunikimit dhe IT, të cilat bashkëpunojnë me njësitë bazë dhe me zëvendës dekanët për të ofruar informacion mbi procesin mësimor, aktivitetet studentore, mundësitë e praktikave dhe njoftimet për punësim. Studentëve u ofrohen shërbime të drejtpërdrejta në sportelin e posaçëm, ndërsa informacioni shtesë shpërndahet përmes ekraneve të mëdha elektronike të vendosura në mjediset e Fakultetit. Gjithashtu, sekretaria mësimore ka një rol qendror në ofrimin e shërbimeve administrative, duke u kujdesur për regjistrimin në provime, lëshimin e vërtetimeve dhe procedura të tjera akademike. Një mjet i rëndësishëm për informim është edhe faqja zyrtare e Fakultetit të Ekonomisë (<a href="https://feut.edu.al/">https://feut.edu.al/</a>), e</p>

	<p>cila ofron të dhëna të përditësuara mbi veprimtarinë akademike dhe administrative.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Rregullore e brendshme e punës të administratës</i></li> <li>• <i>Struktura organizative Fakulteti i Ekonomisë, 2023</i></li> <li>• <i>Organigrama FEUT, 2025</i></li> <li>• <i>Rregullore e Sekretarisë Mësimore, FE</i></li> <li>• <i>Vizita në Institucion</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Përveç strukturave të përmendura më sipër, të cilat janë pjesë e sistemit të informimit dhe të ndjekjes së procesit mësimor në Fakultetin e Ekonomisë të UT-së janë përcaktuar pedagogë mentorë për studentët e cikleve të ndryshme të studimit, bazuar në vendimin e dekanatit. Ky sistem mentorimi synon mbledhjen e informacionit mbi problematikat që hasin studentët, këshillimin dhe mbështetjen e tyre për përparimin akademik. Departamenti i Ekonomiksit ofron konsultime të vazhdueshme për studentët, duke u ardhur në ndihmë atyre që kanë paqartësi ose vështirësi në përmbushjen e detyrimeve akademike apo në përvetësimin e lëndëve. Gjithashtu, studentët orientohen dhe informohen përmes faqes zyrtare të Fakultetit të Ekonomisë, ku gjenden të publikuara rregulloret, informacion mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, si dhe të dhëna mbi infrastrukturën dhe shërbimet që mbështesin procesin mësimor. Këto elementë demonstrojnë ekzistencën e një sistemi transparent dhe funksional për informimin dhe mbështetjen e studentëve.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Departamenti i Ekonomiksit, Konsultimet, Vjeshtë, Shtator 2024, Bachelor</i></li> <li>• <i>Rregullore e Sekretarisë Mësimore, FEUT</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me</p>	<p>Në Fakultetin e Ekonomisë funksionon Zyra e Karrierës, e cila ofron shërbime të këshillimit profesional për studentët e ciklit të parë dhe të dytë të studimeve. Zyra është e angazhuar në këshillim të vazhdueshëm, në ofrimin e mundësive për punësim, praktika profesionale (internship), trajnime, shkolla verore/dimërore, si dhe në organizimin e aktiviteteve të rregullta si Panairi i Punës. Ky panair, i zhvilluar çdo vit, sjell së bashku institucione shtetërore dhe kompani private, duke u ofruar studentëve një pasqyrë reale të tregut të punës dhe duke rritur mundësitë e tyre për punësim. Zyra e Karrierës</p>

<p>kompletimin e procesit mësues, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>mban kontakte dhe zhvillon takime të vazhdueshme me biznese private dhe institucione publike, me qëllim krijimin e mundësive për punësim dhe praktikë për studentët. Që prej vitit 2022, fakulteti shpërndan edhe informacion për Programin Kombëtar të Praktikave të Punës, duke rritur më tej opsionet për përfshirjen e studentëve në tregun e punës. Një praktikë e mirë është mbajtja e kontakteve me kompanitë dhe institucionet ku studentët kryejnë internship ose janë të punësuar, për të vlerësuar përputhjen e aftësive dhe kompetencave të fituara në fakultet me ato të kërkuara nga tregu i punës. Ky feedback merret parasysh në analizën vjetore të punës së departamenteve dhe kontribuon në përmirësimin e programeve të studimit.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Aktivitete të zyrës të karrierës</i></li> <li>• <i>Raport mbi qendrën e karrierës</i></li> <li>• <i>Njoftime punësimi</i></li> <li>• <i>Panairi i Punës FEUT</i></li> <li>• <i>Udhëzim për funksionimin e zyrës të karrierës</i></li> <li>• <i>Vizita në institucion</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Në Fakultetin e Ekonomisë, specialisti për këshillimin e karrierës, në bashkëpunim me Departamentin e Ekonomiksit, ndjek dhe përditëson të dhënat mbi punësimin e studentëve dhe të diplomuarve. Zyra e Karrierës menaxhon gjithashtu informacionin e publikuar nga FEUT lidhur me vendet e lira të punës, programet e internship-it dhe mundësitë e tjera të karrierës, duke i bërë ato të aksesueshme për studentët. Nga takimet e zhvilluara me përgjegjësin e departamentit dhe me pedagogët, mblidhen të dhëna mbi sektorët ku punojnë ish-studentët, përputhshmërinë mes studimeve të kryera dhe pozicioneve të punës, si dhe kohën e nevojshme për punësimin e tyre të parë. Përveç kësaj, ish-studentëve u dërgohet një pyetësor i strukturuar, që u mundëson të japin informacion në mënyrë komode dhe të plotë mbi përvojën e tyre profesionale. Këto praktika dokumentojnë ekzistencën e një sistemi të organizuar gjurmimi dhe monitorimi të punësimit të studentëve, i cili përdoret si burim informacioni për përmirësimin e mëtejshëm të programeve të studimit dhe për forcimin e lidhjes midis studimeve akademike dhe tregut të punës.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Aktivitete të zyrës të karrierës</i></li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Raport mbi Qendrën e Karrierës</li> <li>• Vizita në Institucion</li> </ul>								
<b>Konkluzione</b>	<p><i>FEUT ka ngritur strukturat dhe ka miratuar procedurat për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët. Në Fakultetin e Ekonomisë funksionon Zyra e Karrierës, e cila ofron shërbime të këshillimit profesional për studentët e ciklit të parë dhe të dytë të studimeve. Ndihon në ofrimin e mundësive për punësim, praktika profesionale (internship), trajnime, shkolla verore/dimërore, si dhe në organizimin e aktiviteteve të rregullta si Panairi i Punës. Përveç kësaj, ish-studentëve u dërgohet një pyetësor i strukturuar, që u mundëson të japin informacion në mënyrë komode dhe të plotë mbi përvojën e tyre profesionale. Këto praktika dokumentojnë ekzistencën e një sistemi të organizuar gjurmimi dhe monitorimi të punësimit të studentëve, i cili përdoret si burim informacioni për përmirësimin e mëtejshëm të programeve të studimit dhe për forcimin e lidhjes midis studimeve akademike.</i></p> <p><i>Rekomandojmë që në pyetësorin që u shpërndahet studentëve të ketë një rubrikë për vlerësimin e programit të studimit.</i></p>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

<b>Standardi VI.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin</b>	Universiteti i Tiranës, në përputhje me Statutin dhe strategjitë zhvillimore, garanton lirinë akademike dhe krijon një mjedis që integron mësimdhënien me kërkimin shkencor dhe

dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.

inovacionin. Në vitet e fundit, institucioni ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për modernizimin e qasjeve didaktike, duke miratuar Strategjinë e Mësimdhënies 2022–2027 dhe Planin Strategjik për Zhvillimin Profesional të Personelit 2023–2028. Objektivat kryesorë të tyre lidhen me zhvillimin e potencialit të studentëve, përshtatjen e kurrikulave me tregun e punës, promovimin e metodave inovative të mësimdhënies dhe formimin e vazhduar të stafit. Për të mbështetur këto objektiva, UT ka ngritur Qendrën Virtuale të Zhvillimit Profesional, ku organizohen trajnime me ekspertë të jashtëm mbi metodologjinë e mësimdhënies dhe përdorimin e teknologjisë në auditor. Paralelisht, fakultetet dhe departamentet, si ai i Ekonomiksit, kanë ndërmarrë iniciativa konkrete për rritjen e cilësisë: leksione të hapura me pedagogë të huaj, guida mbi teknikat interaktive të mësimdhënies dhe përfshirje të gjerë në programe ndërkombëtare si Erasmus+. Procesi i mësimdhënies në këtë departament bazohet në një kombinim të qasjeve tradicionale (leksione, diskutime në auditor), metodave bashkëkohore interaktive (punë në grup, mësimdhënie me bazë rastesh, simulime), si dhe përdorimit të të dhënave dhe mjeteve digjitale për analiza e hulumtime. Ky diversitet metodash pasqyron një përpjekje të vetëdijshme për të vendosur studentin në qendër të procesit dhe për të zhvilluar kompetenca të aplikueshme në tregun e punës. Në tërësi, vlerësohet se Universiteti i Tiranës ka ngritur një kuadër të qartë strategjik dhe institucional për forcimin e cilësisë së mësimdhënies, duke mbështetur njëkohësisht zhvillimin profesional të stafit dhe përfshirjen aktive të studentëve. FEUT është pjesë e këtij kuadri, por nuk ka Udhëzues specifikë në nivel Fakulteti/Departamenti për përdorimin e metodave inovative.?

**Referenca:**

- *Strategjia e zhvillimit e UT -2023-2028*
- *Plani i Zhvillimit i Departamentit të Ekonomiksit*
- *Strategjia institucionale për mësimdhënien*
- *Strategjia institucionale për zhvillim profesional*
- *Vendim për ngritjen e qendrës virtuale të zhvillimit profesional dhe trajnimit*
- *Rregullore për funksionimin e komisionit të promovimit akademik*
- *Aktivitetet e projektit përcaktuesit e inovacioneve të gjelbra*

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Vizita në institucion</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</b></p>	<p>Universiteti i Tiranës ka ngritur struktura të qarta dhe ka miratuar instrumente të posaçme për monitorimin dhe vlerësimin e aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik. Roli qendror i Senatit Akademik në sigurimin e cilësisë garanton mbikëqyrjen institucionale. Në këtë kuadër, janë miratuar Rregullorja për Sigurimin e Cilësisë, Manuali i Vlerësimit të Performancës së Personelit Akademik dhe instrumente të tjera që rregullojnë edhe vlerësimin e personelit ndihmës.</p> <p>Procesi i vlerësimit është periodik dhe i shumëplanëshëm, duke përfshirë: Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, Njësine e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel universiteti dhe fakulteti, si dhe degët e sigurimit të cilësisë pranë njësive përkatëse. Këto struktura, me përfaqësim të gjerë nga akademikë, studentë garantojnë mbledhjen dhe analizimin e informacionit mbi performancën mësimdhënëse.</p> <p>Nga takimi me 2 përfaqësues së NJSBC rezultoi se ata nuk kanë një informacion të plotë dhe kontribut të qënësishëm në procesin e vlerësimit të cilësisë dhe në raportimet përkatëse sipas shkallës hierarkike si edhe në këtë proces nuk përfshihen ekspertë të jashtëm.</p> <p>Mekanizmat e përdorur për monitorim janë të drejtpërdrejtë dhe të lidhur me kriterin: vlerësimi i lëndës nga studentët, vlerësimi i pedagogut dhe analizat e ecurisë në nivel departamenti. Këto instrumente sigurojnë mbledhjen e feedback-ut dhe përmirësimin e vazhdueshëm të aftësive mësimdhënëse dhe inovative.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik</i></li> <li>• <i>Rregullore mbi vlerësimin punës të personelit ndihmës akademik dhe administrativ ne UT</i></li> <li>• <i>Vendim për zgjedhjen e komisionit të sigurimit të cilësisë UT</i></li> <li>• <i>Rregullore për sigurimin e cilësisë UT</i></li> <li>• <i>Udhëzues për funksionimin e Njesisë të Brendshme të Sigurimit të cilësisë</i></li> <li>• <i>Rezultat e vlerësimit të paketës të instrumenteve të cilësisë</i></li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Vizita në institucion</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Universiteti i Tiranës ka mekanizma të qartë për të siguruar përfshirjen e studentëve në procesin e vlerësimit. Pyetësorët e strukturuar zhvillohen në fund të çdo semestri në nivel institucional dhe fakulteti, duke u administruar nga NJSBC dhe Degët e Cilësisë. Përmes tyre, studentët japin opinione mbi cilësinë e mësimdhënies, mënyrën e vlerësimit të dijeve, si dhe mbi organizimin e procesit mësimor. Pyetësorët përfshijnë komponentë që mbulojnë programin e studimit, lëndët dhe pedagogët, duke ofruar një panoramë të plotë mbi procesin e mësimdhënies. Përveç kësaj, Fakulteti i Ekonomisë siguron përfshirjen e studentëve edhe në sondazhin kombëtar të studentëve të organizuar nga ASCAL çdo tre vjet. Pedagogët në nivel departamenti realizojnë gjithashtu pyetësorë të brendshëm për lëndë specifike, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të zhvillimit të tyre. Sa i përket trajtimit të ankimimeve, UT ka përcaktuar një rrugë të qartë procedurale: studentët mund t'i drejtohen fillimisht pedagogut të lëndës, më pas Përgjegjësit të Departamentit ose Zv. Dekanit, dhe nëse çështja nuk zgjidhet, ndiqet procedura e përcaktuar në Rregulloren e UT dhe të programeve.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion pedagogët theksuan se edhe pyetësorët që përdorin ata vetë i ndihmojnë për tërheqjen e opinioneve të studentëve për aspekte të ndryshme të mësimdhënies.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Raporti vjetor i departamentit të ekonomiksit</i></li> <li>• <i>Raporti i NJSBC</i></li> <li>• <i>Rezultat e vlerësimit të paketës të instrumenteve të cilësisë</i></li> <li>• <i>Model Formulari Vlerësimi për pedagogun</i></li> <li>• <i>Model formulari vlerësimi i lëndës nga studenti</i></li> <li>• <i>Model formulari vlerësimi i studentëve që diplomohen</i></li> <li>• <i>Pyetësor vlerësimi Ekonomiksi i Mjedisit JM-AEEC-EU</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Strukturat e sigurimit të cilësisë në UT (KPSSC, NJSBC dhe Degët e Sigurimit të Cilësisë) veprojnë në përputhje me planin e veprimit 2024–2028 dhe zhvillojnë pyetësorë të rregullt për vlerësimin e mësimdhënies. Rezultatet e këtyre pyetësorëve publikohen sipas rregulloreve institucionale, duke respektuar legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave</p>

	<p>personale. Informacioni përmbledhës dhe rekomandimet reflektohen në raportet vjetore të cilësisë, të cilat janë të aksesueshme për studentët, stafin dhe aktorët e tjerë të interesuar. Gjithashtu, departamentet marrin në mënyrë të rregullt rezultatet e vlerësimeve të studentëve për lëndët dhe mësimdhënien, i diskutojnë ato në mbledhjet e stafit akademik dhe i përfshijnë në raportet e punës vjetore. Kjo tregon se ekziston një cikël i qartë publikimi dhe përdorimi i rezultateve në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>NJSBC aktiviteti dhe baza ligjore</i></li> <li>• <i>Raporti i NJSBC</i></li> <li>• <i>Raporti i NJSBC 2024-2025-Semestri I</i></li> <li>• <i>Rezultat e vlerësimit të paketës të instrumenteve të cilësisë</i></li> <li>• <i>Plan veprimi për SC në UT, 2024-2028</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Universiteti i Tiranës ka ngritur mekanizma të qartë për identifikimin dhe promovimin e praktikave të mira në mësimdhënie. Në FEUT, praktikat e mira evidentohen në raportet vjetore të departamenteve dhe të NJSBC-ve dhe shpërndahen ndërmjet njësive për të nxitur përmirësim të mëtejshëm. Stafi akademik inkurajohet të marrë pjesë në trajnimet pedagogjike të organizuara nga Qendra e Zhvillimit Profesional, duke kontribuar në rritjen e cilësisë së mësimdhënies në nivel institucional. Për më tepër, inkurajohet angazhimi në projekte të brendshme dhe ndërkombëtare, të cilat forcojnë zhvillimin profesional dhe ndikojnë pozitivisht në përmirësimin e mësimdhënies. Raportet vjetore të performancës pasqyrojnë arritjet individuale dhe institucionale, duke i kthyer ato në mjete njohjeje dhe motivimi për stafin, si dhe duke shpërndarë praktika të mira për t'u replikuar apo përshtatur në njësi të tjera. Praktikrat më të mira vetëm evidentohen por nuk na u bë i ditur ndonë mekanizëm promovimi specifik.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Vendim për miratim granti për prezantim në konferenca dhe botime</i></li> <li>• <i>Programe të fituara nga anëtarët e departamentit</i></li> <li>• <i>Thirrje për projekte UT 2023</i></li> <li>• <i>Projekte ndërkombëtare që zbatohen në UT</i></li> <li>• <i>Projekte kombëtare FE</i></li> <li>• <i>Aktivitete me projektin USE_IPM</i></li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Aktivitetet projekti-Integrimi i vendeve të Ballkanit Perëndimor në këndvështrimin e konkureshmërisë dhe efikasitetit ekonomike</i></li> <li>• <i>Projektet e Departamentit të Ekonomisë (2021-2025)</i></li> <li>• <i>Mobilitete personeli akademik 2023-2024</i></li> </ul>								
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Institucioni ka struktura funksionale dhe mekanizma periodikë për monitorimin dhe vlerësimin e aftësive të personelit. UT garanton përfshirjen aktive të studentëve në vlerësimin periodik të mësimdhënies dhe vlerësimin të dijeve, si dhe ofron mekanizma funksionale për trajtimin e ankimeve. Rezultatet e vlerësimeve bëhen publike në mënyrë të rregullt dhe transparente, duke u reflektuar në raportet vjetore dhe duke u bërë të aksesueshme për palët e interesuara. Institucioni nxit personelin akademik për zhvillim të mëtejshëm përmes trajnimeve, projekteve dhe shpërndarjes së praktikave të suksesshme. Nuk ka ndonjë mekanizëm specifik për promovimin e praktikave më të mira. Nga takimi me përfaqësues të NJSBC rezultoi se është e nevojshme që ata të kenë një informacion dhe kontribut më të qënësishëm në procesin e vlerësimit të cilësisë dhe raportimet përkatëse sipas shkallës hierarkike dhe të përfshojnë ekspertë të jashtëm në vlerësim.</i></p> <p><i>Rekomendojmë të përgatitet një Udhëzues specifik në nivel Fakulteti/Departamenti për përdorimin e metodave inovative.</i></p>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <tr> <td><i>Nuk përmbushet</i></td> <td><i>Përmbushet pjesërisht</i></td> <td><i>Përmbushet kryesisht</i></td> <td><i>Përmbushet plotësisht</i></td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </table>	<i>Nuk përmbushet</i>	<i>Përmbushet pjesërisht</i>	<i>Përmbushet kryesisht</i>	<i>Përmbushet plotësisht</i>			X	
<i>Nuk përmbushet</i>	<i>Përmbushet pjesërisht</i>	<i>Përmbushet kryesisht</i>	<i>Përmbushet plotësisht</i>						
		X							

<b>Standardi VI.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënlige në fuqi dhe me	Universiteti i Tiranës e konsideron sigurimin e cilësisë së veprimtarisë mësimore dhe shkencore një nga prioritetet strategjike të zhvillimit të tij institucional. Universiteti bazohet tek kuadri legjislativ kombëtar, ligji 80/2015 si dhe aktet nënlige, Kodi i Cilësisë së Arsimit të Lartë, rregulloret dhe praktikave ekzistuese institucionale si dhe Standardet dhe Udhëzimet për Sigurimin e Cilësisë të

<p>aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Shoqatës Evropiane për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë. Struktura përgjegjëse për garantimin e standardeve të cilësisë në nivel institucioni është Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë (KPSSC), i cili bashkëpunon ngushtë me njësitë e sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel fakulteti. Për sigurimin e cilësisë, Senati Akademik ka miratuar Planin e Veprimit për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (2024–2028), në të cilin janë parashikuar masa konkrete që mbështesin sistemin e brendshëm të sigurimit të cilësisë Gjithashtu, institucioni ka miratuar edhe Manualin dhe Rregulloren për Sigurimin e Cilësisë, si dhe Paketa e Instrumenteve ku janë artikuluar politikat dhe parimet e menaxhimit të cilësisë, standardet e sigurimit të brendshëm të cilësisë, rolet dhe përgjegjësitë e organizmave akademike dhe ndihmës akademike për menaxhimin dhe sigurimin e cilësisë, procedurat dhe instrumentet përkatëse. Në nivel fakulteti, Fakulteti i Ekonomisë ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) dhe ka hartuar dokumente orientuese, për të standardizuar zhvillimin dhe përdorimin e metodave bashkëkohore dhe inovative të mësimdhënies.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Strategjia e Zhvillimit të UT-së 2023-2028, fq.5</i></li> <li>• <i>Plani i Veprimit për sigurimin e SC 2024-2028</i></li> <li>• <i>Plan Veprimi për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në UT 2021-2024</i></li> <li>• <i>Plan i veprimitarisë NJSBC 2024-2025</i></li> <li>• <i>Plani kalendarik i degës të sigurimit të cilësisë FE</i></li> <li>• <i>Rregullore për organizimin dhe funksionimin e NJSBC, UT</i></li> <li>• <i>Rregullore për Sigurimin e Cilësisë në UT</i></li> <li>• <i>Paketa e Instrumenteve të cilësisë</i></li> <li>• <i>Vendim për kodin e cilësisë së arsimit të lartë</i></li> <li>• <i>Manual i cilësisë UT</i></li> <li>• <i>Vendim nr.11 datë 28.09.2021 për miratimin e NJSBC në FEUT</i></li> <li>• <i>Përbërja e komisionit të NJSBC 2024-2025</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të</p>	<p>Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë vepron në mënyrë të strukturuar dhe të vazhdueshme, duke synuar përmirësimin e pandërprerë të cilësisë akademike dhe administrative. Në nivel universiteti, Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë</p>

<p>Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>drejtohet nga Senati Akademik dhe garantohet/mbështetet nga Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë (KPSSC) dhe Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë, të cilat bashkëpunojnë ngushtë me NJSBC-të në njësitë kryesore. Në përputhje me nenin 41, të Statutit, KPSSC përbëhet nga 11 anëtarë (8 personel akademik dhe 3 studentë). NJSBC pranë FEUT ka në përbërje 8 anëtarë, ndër të cilët një student, dhe funksionon si mekanizëm për të siguruar dhe garantuar mbikëqyrjen dhe vlerësimin e brendshëm ne FEUT. Përmes NJSBC, fakulteti garanton monitorimin sistematik të proceseve akademike, vlerësimin periodik të performancës dhe zbatimin e masave për zhvillim cilësor në përputhje me objektivat strategjike të institucionit. NJSBC pranë Fakultetit të Ekonomisë është e organizuar nga Njësia e Sigurimit të Cilësisë dhe Dega e Sigurimit të Cilësisë, të përbërë nga staf akademik dhe administrativ. Kjo njësi ka përcaktuar procedurat për sigurimin e brendshëm të cilësisë që ndiqen dhe respektohen sipas kalendarit të aktivitetit të NJSBC. Në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm, Fakulteti i Ekonomisë angazhon studentët, por jo ekspertët e jashtëm në proceset e vlerësimit të brendshëm, në përputhje me parimet e transparencës dhe gjithëpërfshirjes</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Rregullore për funksionimin e komisionit të përhershëm të kurrikulës</i></li> <li>• <i>Vendim për zgjedhjen e komisionit të sigurimit të cilësisë</i></li> <li>• <i>Vendim për zgjedhjen e komisionit të kurrikulës</i></li> <li>• <i>Vendim nr.11/2021 për miratimin e NJSBC FEUT</i></li> <li>• <i>Përbërja e NJSBC 2024-2025</i></li> <li>• <i>NJSBC aktiviteti dhe baza ligjore</i></li> <li>• <i>Formular Vlerësimi i Jashtëm i pedagogut dhe lëndës</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e</p>	<p>Universiteti i Tiranës zbaton tre instrumente kryesore për sigurimin e jashtëm të cilësisë: akreditimin institucional, akreditimin e programeve të studimit dhe pjesëmarrjen në Sondazhin Kombëtar të Studentëve. UT është akredituar institucionalisht për periudhën maksimale 6-vjeçare, sipas Vendimit nr. 04, datë 27.01.2023. Po ashtu, programi Master i Shkencave në: “Ekonomiks” pranë Departamentit të Ekonomiksit në Fakultetin e Ekonomisë është akredituar maksimalisht për 6 vite (Vendimi nr. 112, datë 20.10.2023).</p>

<p>krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>UT ka marrë pjesë në sondazhin kombëtar të studentëve në vitet 2022 dhe 2025, i organizuar nga ASCAL. Rezultatet e këtij sondazhi analizohen dhe përdoren për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, në përputhje me objektivat strategjike të institucionit. Në nivel fakulteti, përfshirja e studentëve në proceset e brendshme të sigurimit të cilësisë është e strukturuar përmes instrumenteve të tilla si: pyetësorët për vlerësimin e lëndës, vlerësimi i pedagogëve dhe vlerësimi në përfundim të studimeve. Këto instrumente administrohen nga NJSBC në bashkëpunim me Drejtorinë e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Sondazhi kombëtar i studentëve, 2022</i></li> <li>• <i>Strategjia e zhvillimit e UT 2023-2028</i></li> <li>• <i>Prani i Zhvillimit i Departamentit të Ekonomiksit</i></li> <li>• <i>Model formulari Vlerësim i studentëve që diplomohen Ekonomiks 2024</i></li> <li>• <i>Model formulari Vlerësimi i lendes nga studenti</i></li> <li>• <i>Model formulari Vlerësimi për pedagogun</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Universiteti i Tiranës realizon vlerësimin periodik të aftësive mësimdhënëse të stafit akademik përmes një bashkëpunimi ndërmjet strukturave të ndryshme institucionale, në zbatim të planit të veprimit për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Vlerësimi bazohet në instrumente të standardizuara dhe jep tregues të matshëm për performancën akademike. Mekanizmat kryesorë për vlerësimin e procesit mësimor përfshijnë: vlerësimin e pedagogëve nga studentët, raportin e vetëvlerësimit të lëndës nga vetë pedagogët, analizat e ecurisë të zhvilluara në nivel Departamenti. Departamentet hartojnë raport vjetor pune, i cili përfshin një analizë të detajuar të procesit mësimor, kompetencave të fituara nga studentët, si dhe të gjetjeve të NJSBC-së. Po ashtu, në raport përfshihet aktiviteti shkencor i stafit akademik, përmes analizës së publikimeve, pjesëmarrjes në konferenca dhe projekte. Për të nxitur zhvillimin profesional të stafit akademik, UT mbështet financiarisht pjesëmarrjen në konferenca dhe botime shkencore, si pjesë e strategjisë për rritjen e cilësisë në mësimdhënie dhe kërkim.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Plani i veprimit për SC në UT</i></li> <li>• <i>Paketa e instrumenteve të cilësisë</i></li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Raporti i NJSBC</li> <li>• Raporti i NJSBC 2024-2025-Semestri I</li> <li>• Raporti i NJSBC 2024-2025, Semestri II</li> <li>• Raporti vjetor i Departamentit të Ekonomiksit</li> <li>• Vendim për miratimin e garantit për prezantim në konferenca e botime.</li> </ul>								
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë funksionon në mënyrë të strukturuar dhe të vazhdueshme, duke siguruar përmirësimin e pandërprerë të cilësisë akademike dhe administrative. Në nivel universiteti, ky sistem drejtohet nga Senati Akademik dhe mbështetet nga Komisioni i Përherëshëm për Sigurimin e Cilësisë dhe Drejtoria përkatëse, ndërsa në nivel fakulteti vepron përmes Njësisë së Sigurimit të Cilësisë dhe NJSBC-së, të cilat monitorojnë dhe vlerësojnë sistematikisht proceset akademike dhe zbatimin e masave për zhvillim cilësor, në përputhje me objektivat strategjike të institucionit. NJSBC pranë FEUT duhet të ketë një rol më të qënësishëm dhe aktiv në proceset e vlerësimit të cilësisë. Rekomandim : Institucioni duhet të përdorë mekanizma promovues për mbështetjen e praktikave me performancë më të lartë</i></p>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

### Standardi VI.3

**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e</p>	<p>Fakulteti i Ekonomisë zbaton mekanizma të formalizuara për shqyrtimin dhe mbikëqyrjen periodike të programeve të studimit, në bashkëpunim me njësitë bazë dhe Njësinë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (NJSBC). Kjo njësi mbledh dhe analizon të dhëna përmes instrumenteve si pyetësorët e studentëve për mësimdhënien, të cilët administrohen në mënyrë anonime dy herë në vit për çdo program studimi. Në RVB theksohet se NJSBC harton raporte analitike bazuar në rezultatet e vlerësimeve dhe ua paraqet ato strukturave vendimmarrëse si departamentet, KPSSC, Komisioni i Kurrikulës dhe Senati Akademik. Në bashkëpunim me këto struktura, formulohen rekomandime</p>

<p>praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>për përmirësim të vazhdueshëm. Por, nga Raporti i NJSBC 2024-2025 vërejmë se ky është një raport jo analitik, por përshkruar procesin, i cili në fund vetëm me një fjali rekomandon bërjen e një analize serioze të outputeve të pyetësorëve nga Departamentet.</p> <p>Në nivel departamenti, rezultatet diskutohen në mbledhjet përkatëse dhe pasqyrohen në raportin vjetor të punës, i cili kontribuon në raportet vjetore të fakultetit dhe më tej në raportin institucional për vlerësimin e brendshëm nga GVB.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Raporti i NJSBC 2024-2025, Semestri II</i></li> <li>• <i>Raporti Vjetor i FEUT;</i></li> <li>• <i>Raporti Vjetor i Departamentit të Ekonomiksit</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamenti i Ekonomiksit në Universitetin e Tiranës realizojnë raportim të rregullt dhe gjithëpërfshirës për performancën akademike dhe kërkimore. Raporti i Departamentit të Ekonomiksit për vitin akademik 2023–2024 analizon performancën në mësimdhënie, vlerësimet nga studentët, aktivitetin kërkimor dhe statusin e programeve. Ai evidenton gjithashtu sfidat dhe prioritetet për përmirësim, duke reflektuar kontributet individuale të stafit.</p> <p>Vlerësimi periodik i pedagogëve, përmes feedback-ut të studentëve dhe analizave të strukturave përgjegjëse, shërben si bazë për identifikimin e kontributeve individuale dhe për planifikimin e zhvillimit të mëtejshëm profesional.</p> <p>Stafi inkurajohet të angazhohet në projekte kërkimore, si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar, gjë që kontribuon në rritjen e kapaciteteve akademike dhe ndërlidhjen e kërkimit me mësimdhënien. Arritjet individuale pasqyrohen në raportet institucionale, duke ndihmuar jo vetëm në motivimin dhe njohjen e kontributit, por edhe në shpërndarjen e praktikave të mira brenda dhe jashtë njësisë.</p> <p>Për më tepër, Departamenti i Ekonomiksit është aktiv në procesin e përshtatjes së kurrikulave në kuadër të projekteve Jean Monnet Module dhe iniciativave të Bashkimit Evropian, duke synuar përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe ndërkombëtarizimin e programeve të studimit.</p> <p>Kjo qasje e kombinuar krijon një kulturë të zhvillimit profesional dhe cilësisë në mësimdhënie, në përputhje me objektivat strategjike të institucionit.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Raporti Vjetor i FEUT</i></li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Raporti Vjetor i FEUT 2023-2024</i></li> <li>• <i>Raporti Vjetor i Departamentit të Ekonomiksit 2023-2024</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Institucioni përdor një gamë të gjerë metodash të dokumentuara dhe të strukturuar për të vlerësuar cilësinë dhe realizimin e programeve të studimit. Në kuadër të vlerësimit të mësimdhënies dhe didaktikës, përdoren pyetësorë të drejtuar studentëve për të marrë feedback mbi cilësinë e mësimdhënies dhe komunikimin e pedagogëve, si dhe organizohen diskutime grupore për ndarjen e praktikave të mira dhe identifikimin e sfidave. Përveç kësaj, procesi mësimor monitorohet me vëzhgime të drejtpërdrejta në auditor. Në aspektin e vlerësimit të kurrikulës dhe të mësuarit, përmbajtja e lëndëve rishikohet rregullisht në nivel fakulteti dhe departamenti, duke përdorur pyetësorë të organizuar nga njësitë përkatëse. Gjithashtu bëhet analizë dhe përditësim i literaturës sipas kërkesave akademike dhe të tregut të punës, ndërsa ecuria e studentëve ndiqet përmes analizës së rezultateve në nota, detyra dhe projekte praktike. Për të garantuar standarde të barabarta, kryhen vlerësime paralele të provimeve dhe detyrave, ku krahasohen rezultatet në grupe të ndryshme dhe zhvillohen diskutime për cilësinë e pyetjeve dhe performancën e studentëve në nivel departamenti. Gjithashtu, procesi mësimor dhe praktik i studentëve monitorohet përmes vëzhgimeve të drejtpërdrejta nga strukturat përgjegjëse, të cilat hartojnë raporte mbi mbarëvajtjen e mësimit dhe trajnimeve praktike. Këto mekanizma të ndryshëm sigurojnë një vlerësim gjithëpërfshirës dhe të vazhdueshëm të programeve, duke mbështetur përmirësimin e cilësisë së arsimit.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Paketa e instrumenteve të cilësisë</i></li> <li>• <i>Pyetësor vlerësimi – Ekonomiksi i Mjedisit</i></li> <li>• <i>Formular Vlerësimi i Jashtëm i pedagogut të lëndës</i></li> <li>• <i>Raporti Vjetor Departamenti i Ekonomiksit</i></li> <li>• <i>Raport i NJSBC</i></li> <li>• <i>Rezultat e vlerësimit të paketës të instrumenteve të cilësisë</i></li> <li>• <i>Raporti i NJSBC 2024-2025, -Semestri I</i></li> <li>• <i>Raporti i NJSBC 2024-2025, Semestri II</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e</p>	<p>Bazuar në Paketën e Instrumenteve të Cilësisë, Departamenti i Ekonomiksit në FEUT zbaton një sistem gjithëpërfshirës dhe të strukturuar për vlerësimin e cilësisë së programeve të</p>

<p>cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademi e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>studimit. Ky sistem përfshin aktorë të ndryshëm brenda dhe jashtë institucionit dhe përdor metoda të ndryshme për të siguruar një vlerësim të plotë dhe të objektivizuar. Studentët, përmes formularëve të vlerësimit të lëndës dhe pedagogut, ofrojnë feedback të drejtpërdrejtë mbi mësimdhënien dhe organizimin, duke u përdorur si burim i rëndësishëm për analizat e departamentit. Të diplomuarit kontribuojnë me informacion mbi përvojën e tyre dhe përshtatshmërinë e kompetencave në tregun e punës, duke siguruar një perspektivë të jashtme dhe afatgjatë mbi efektivitetin e programit. Personeli akademik dhe administrativ përfshihet në procesin e vlerësimit të brendshëm, duke siguruar një analizë të thelluar dhe sugjerime për zhvillimin e mëtejshëm të programeve. Për më tepër, opinioni i punëdhënësve dhe institucioneve partnere, mbledhur përmes pyetësorëve të dedikuar, është thelbësor për përshtatjen e programeve me kërkesat reale të tregut të punës dhe për përmirësimin praktik dhe përmbajtësor të tyre. Të gjitha të dhënat e mbledhura dokumentohen dhe analizohen sistematikisht dhe përfshihen në raportet vjetore të vlerësimit, të cilat shërbejnë si bazë për vendimmarrje strategjike dhe për përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit. Kjo qasje siguron një cikël të mbyllur të feedback-ut dhe optimizimit, duke kontribuar në zhvillimin e programeve që i përgjigjen më mirë nevojave të studentëve dhe tregut të punës. Nuk na u raportua mbi sondazhe me punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program. Vetëm vlerësimi nga punëdhënësi për praktikën është instrumenti që përdoret për këtë qëllim.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Paketa e Instrumenteve të Cilësisë</i></li> <li>• <i>Modeli i Formularit të Vlerësimit të Lëndës nga Studenti</i></li> <li>• <i>Modeli i Formularit të Vlerësimit për Pedagogun</i></li> <li>• <i>Raporti i NJSBC</i></li> <li>• <i>Raporti i NJSBC 2024-2025 - Semestri I</i></li> <li>• <i>Raporti i NJSBC 2024-2025, Semestri II</i></li> <li>• <i>Rezultatet e Vlerësimit të Paketës të Instrumenteve të Cilësisë</i></li> </ul>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Fakulteti i Ekonomisë zbaton mekanizma të formalizuar dhe të strukturuar për shqyrtimin dhe mbikëqyrjen periodike të</i></p>

	<p><i>programeve të studimit, duke punuar ngushtë me njësitë bazë dhe Njësinë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (NJSBC). Kjo njësi është përgjegjëse për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave të grumbulluara nga instrumente të ndryshme, përfshirë pyetësorët e studentëve për mësimdhënien, të cilët administrohen në mënyrë anonime dy herë në vit për çdo program studimi. Kjo praktikë siguron një vlerësim objektiv dhe të vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe ndihmon në identifikimin e aspekteve që kërkojnë përmirësim. Në bazë të rezultateve të grumbulluara, NJSBC harton raporte analitike të detajuara, të cilat i paraqen më pas strukturave vendimmarrëse të fakultetit, siç janë departamentet, Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë (KPSSC), Komisioni i Kurrikulës dhe Senati Akademik. Këto raporte shërbejnë si bazë për diskutime të thelluara dhe për formulimin e rekomandimeve konkrete që synojnë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve akademike dhe proceseve mësimore. Në nivel departamenti, rezultatet dhe rekomandimet nga raportet e NJSBC diskutohen në mbledhjet përkatëse, ku stafi akademik dhe administrativ bashkëpunojnë për të përcaktuar masat konkrete që duhet të ndërmerren. Këto diskutime dokumentohen dhe pasqyrohen në raportin vjetor të punës së departamentit, i cili më pas integrohet në raportin vjetor të fakultetit. Ky proces i koordinuar dhe i përsëritur siguron një qasje sistematike ndaj menaxhimit të cilësisë dhe mbështet objektivin strategjik të institucionit për zhvillimin e qëndrueshëm dhe përmirësimin e vazhdueshëm. Nuk na u raportua mbi sondazhe me punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi VI.4</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>

<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Politikat për sigurimin, hartimin dhe përmirësimin e cilësisë janë transparente dhe publike, duke synuar përfshirjen aktive të të gjitha palëve të interesuara përmes Paketës së Instrumenteve. Institucioni ka përcaktuar në statutin dhe rregulloren e tij përfshirjen e aktorëve të brendshëm në proceset e vlerësimit dhe përmirësimit të programeve të studimit. Studentët përfaqësohen në struktura kyçe si Senati Akademik, KPSSC, NJSBC-të dhe Grupet e Vlerësimit të Brendshëm. Për më tepër, realizohen pyetësorë dhe konsultime periodike me punëdhënës dhe bashkëpunëtorë të jashtëm për të mbledhur mendime dhe sugjerime për përmirësimin e programeve, ndërsa alumni përfshihen në vlerësimin e programeve dhe nevojave të tregut të punës. Këto mekanizma të integruara sigurojnë një proces gjithëpërfshirës, të qëndrueshëm dhe bashkëpunues, ku angazhimi i pedagogëve dhe stafit administrativ është i dukshëm dhe i domosdoshëm për suksesin e sistemit të cilësisë.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Statuti UT</i></li> <li>• <i>Rregullore për sigurimin e cilësisë UT</i></li> <li>• <i>Rregullore për organizimin dhe funksionimin e NJSBC</i></li> <li>• <i>Manual i sigurimit të cilësisë UT</i></li> <li>• <i>Paketa e instrumenteve të cilësisë</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>UT ka përcaktuar qartë përgjegjësitë dhe detyrat për të gjitha strukturat dhe aktorët e përfshirë në sigurimin e cilësisë nëpërmjet Manualit dhe Rregullores për Sigurimin e Cilësisë. Këto dokumente përshkruajnë rolet e njësive institucionale dhe njësive kryesore, përfshirë staf akademik, studentë dhe komisione si KPSSC dhe NJSBC. Zbatimi i detyrave mbështetet nga struktura të specializuara si Drejtoria e Sigurimit të Cilësisë në Rektoratin e UT dhe Degët për Cilësinë në nivel fakulteti, duke garantuar funksionimin e qëndrueshëm dhe me përgjegjësi të sistemit të brendshëm të cilësisë. Detyra dhe përgjegjësi janë përcaktuar për drejtuesit të njësive kryesore, administratorit, drejtuesit të njësive bazë, njësive të sigurimit të brendshëm të cilësisë, grupit të vlerësimit të brendshëm.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Statuti UT</i></li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Rregullore për organizimin dhe funksionimin e NJSBC</i></li> <li>• <i>Manual i sigurimit të cilësisë UT</i></li> <li>• <i>Rregullore Për Sigurimin e Cilësisë, Kreu III</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.</p>	<p>UT garanton përfshirjen e plotë të njësisë bazë dhe kryesore, si dhe të aktorëve të tjerë relevantë në procesin e sigurimit të cilësisë së programeve të studimit. Në strukturat përkatëse marrin pjesë aktivisht personeli akademik, ndihmës akademik, administrativ dhe vetë studentët e programit, në përputhje me rregulloren institucionale dhe praktikat e miratuara të sigurimit të cilësisë. Në KPPSC, Fakulteti i Ekonomisë përfaqësohet me një anëtar, ndërsa në nivel fakulteti, Departamenti i Ekonomiksit ka gjithashtu përfaqësuesin e vet në strukturat përkatëse të sigurimit të cilësisë. KPSSC përbëhet nga 11 anëtarë (8 personel akademik dhe 3 studentë). NJSBC pranë FEUT ka në përbërje 8 anëtarë (6 personel akademik, 1 administrativ dhe 1 student), dhe funksionon si mekanizëm për të siguruar dhe garantuar mbikëqyrjen dhe vlerësimin e brendshëm në FEUT. Komisionet mbështeten në veprimtarinë e tyre nga Drejtoria e Kurrikulave dhe e Sigurimit të Cilësisë pranë Rektoratit të UT, e cila përbëhet nga 13 (trembëdhjetë) anëtarë (9 personel akademik, 2 studentë dhe 2 ndihmës akademik) dhe veprimtarie e saj është përcaktuar në rregulloren e administratës së rektoratit. FEUT ka ngritur Degën e Sigurimit të Cilësisë për të siguruar dhe garantuar sigurimin e cilësisë të programeve të studimit, strukturë që varet nga Zv. Dekani për Sigurimin e Cilësisë. Për të garantuar kontrollin dhe përmirësimin e programit në nivel departamenti, në Grupin e Vlerësimin të Brendshëm të Departamentit të Ekonomiksit është përfshirë edhe një student i programit, duke siguruar gjithë përfshirje dhe përfaqësim të drejtpërdrejtë të zërit të studentëve në këtë proces. Krahas pyetësorëve të NJSBC-së, Fakulteti dhe Departamenti kanë zhvilluar një pyetësor specifik për gjurmimin e të diplomuarve në programin Bachelor në Ekonomiks, me qëllim mbledhjen e mendimeve dhe sugjerimeve të tyre për përmirësimin e mëtejshëm të programit të studimit<sup>1</sup>.</p> <p><b>Referenca:</b></p>

<sup>1</sup> Linku i pyetësorit nga Departamenti: *Përfshirja në Tregun e Punës e Studentëve të Ekonomiksit*

Linku i pyetësorit nga Fakulteti nga Alumni: <https://forms.gle/wM2HvjWPJKoFdoKe7>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Statuti UT</i></li> <li>• <i>Vendim për zgjedhjen e komisionit të sigurimit të cilësisë UT</i></li> <li>• <i>Vendim nr.11/2021 për miratimin e NJSBC në FEUT</i></li> <li>• <i>Përbërja e NJSBC 2024-2025</i></li> <li>• <i>Vendim për zgjedhjen e komisionit të kurrikulës UT</i></li> <li>• <i>Rregullore e brendshme e punës së administratës</i></li> <li>• <i>Aktiviteti i NJSBC</i></li> <li>• <i>Shkresa për GVB</i></li> <li>• <i>Tabela përmbledhëse (tabela 24)</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Proceset e vlerësimit të brendshëm në Fakultetin e Ekonomisë janë realizuar në mënyrë gjithëpërfshirëse, duke respektuar integritetin akademik dhe parimet e barazisë. Përbërja e grupeve të vlerësimit ka qenë e balancuar, me përfshirjen e stafit akademik nga nivele të ndryshme dhe me përfaqësim të garantuar të studentëve, sipas Rregullores për Sigurimin e Cilësisë në UT. Përzgjedhja e anëtarëve është bërë mbi bazën e përvojës dhe kontributit të tyre të mundshëm, duke shmangur çdo formë diskriminimi apo trajtimi të pabarabartë. Gjithashtu, procesi i hartimit të raporteve ka qenë transparent dhe ka përfshirë të gjitha strukturat dhe individët përkatës të fakultetit, në përputhje me udhëzimet e ASCAL dhe në respektim të dispozitave ligjore në fuqi, veçanërisht Ligjit nr. 9887/2008, të ndryshuar me Ligjin nr. 48/2012 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Përdorimi i pyetësorëve është realizuar duke garantuar anonimitetin e stafit dhe studentëve, ç’ka ka rritur besueshmërinë dhe ndershmërinë e të dhënave të mbledhura.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT</i></li> <li>• <i>Rregullore mbi mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen e të dhënave personale</i></li> <li>• <i>Plani i barazisë gjinore</i></li> <li>• <i>Vendim i planit të barazisë gjinore</i></li> <li>• <i>Kodi i etikës</i></li> <li>• <i>Shkresa për GVB</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm</p>	<p>Në kuadër të proceseve të sigurimit të cilësisë, Fakulteti i Ekonomisë ka garantuar një rol aktiv edhe për aktorët e jashtëm, duke i përfshirë ata si burim i rëndësishëm ekspertize dhe vlerësimi. Përdorimi i instrumenteve si pyetësorët për të diplomuarit ka ofruar mundësi të vlefshme për mbledhjen e informacionit mbi nivelin e njohurive,</p>

<p>që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>aftësitë praktike dhe kompetencat komunikuese të studentëve, si dhe për identifikimin e nevojave për përmirësime të mëtejshme të programeve të studimit. Përtej instrumenteve të strukturuar, FEUT ka përfshirë ekspertë të jashtëm edhe përmes aktiviteteve akademike dhe profesionale si leksione të hapura, workshope dhe projekte të ndryshme departamentale.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Modeli formati i studentëve që diplomohen</li> <li>• Leksion i hapur - Siguria energjitike e Shqipërisë</li> <li>• Aktivitete projekti Jean Monnet Chair</li> <li>• Tryezë e rrumbullakët – Rëndësia e energjisë të rinovueshme e Shqipërisë</li> <li>• Aktivitete, projekti përcaktuesit e inovacioneve të gjelbra</li> <li>• Ëorkshop zhvillimi i menaxhimit të organizatave publike</li> </ul>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>Fakulteti i Ekonomisë ka demonstruar një proces vlerësimi të brendshëm të strukturuar, gjithëpërfshirës dhe të paanshëm, duke garantuar respektimin e integritetit akademik, transparencës dhe barazisë në përfshirjen e aktorëve të brendshëm. Ky proces përmbush në mënyrë të plotë kriterin e përfshirjes dhe aktivizimit të aktorëve të brendshëm në proceset e sigurimit të cilësisë. Fakulteti i Ekonomisë ka realizuar një proces të strukturuar për përfshirjen e të diplomuarve në sigurimin e cilësisë. Përfshirja e tyre ka ndihmuar në pasurimin e perspektivës mbi cilësinë e programeve, forcimin e lidhjes me tregun e punës dhe rritjen e besueshmërisë së mekanizmave të vlerësimit. Por më tepër duhet të bëhet për përfshirje të aktorëve të jashtëm.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p><b>Standardi VI.5</b>  <b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të</b></p>	<p>Fakulteti i Ekonomisë dhe Universiteti i Tiranës kanë zbatuar në mënyrë të plotë parimin e transparencës në lidhje me politikat, strategjinë, organizimin dhe veprimtaritë e sistemit</p>



<p>sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Dokumentacioni përkatës – përfshirë politikat, manualin dhe rregulloret për sigurimin e cilësisë, paketën e instrumenteve, aktet mbi funksionimin e KPPSC-së, vendimet e Bordit të Akreditimit. Në RVB theksohet se, <i>raportet e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm, si edhe raportet vjetore të UT-së – publikohet në faqet zyrtare të internetit të UT-së dhe FEUT-së, duke qenë i aksesueshëm për studentët dhe të gjithë palët e interesuara. Por në website të FEUT dhe UT nuk ka raporte të publikuara.</i></p> <p>Ky proces bazohet në dispozitat ligjore dhe rregullat përkatëse, përfshirë nenin 5, pika 6 dhe nenin 32, pika 4 të Rregullores për Sigurimin e Cilësisë, si dhe pikën 15 të Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në UT. Publikimi i rezultateve të vlerësimit dhe akreditimit është detyrim i përcaktuar qartë, duke siguruar jo vetëm informim të gjerë, por edhe besueshmëri dhe llogaridhënie institucionale.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Rregullore për sigurimin e cilësisë UT</i></li> <li>• <i>Rregullore për organizimin dhe funksionimin e NJSBC, UT</i></li> <li>• <i>Raport i NJSBC</i></li> <li>• <i>Raporti i NJSBC 2024-2025-Semestri I</i></li> <li>• <i>Raporti i NJSBC 2024-2025, Semestri II</i></li> <li>• <i>Rezultat e vlerësimit të paketës të instrumenteve të cilësisë</i></li> <li>• <i>Manual i sigurimit të cilësisë</i></li> <li>• <i>Ëbbsite <a href="http://www.feut.edu.al">www.feut.edu.al</a></i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Institucioni i Arsimit të Lartë ka siguruar një proces të qartë dhe të rregulluar për publikimin e rezultateve të vlerësimeve të programeve të studimit, duke respektuar parimet e lirisë dhe etikës akademike, si dhe legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. Nëpërmjet Paketave të Instrumenteve, mblidhen dhe përpunohen të dhëna për secilin program studimi. Ky informacion shpërndahet te palët e interesuara përmes raporteve vjetore, komunikimeve me studentët, si dhe publikimeve zyrtare, gjithnjë në përputhje me nenin 32, pika 4 të Rregullores për Sigurimin e Cilësisë.</p> <p>Vendimet dhe raportet përkatëse publikohen rregullisht në faqet zyrtare të UT-së dhe ASCAL-it, duke garantuar</p>

	<p>transparencë dhe akses publik. Ndërkohë, rezultatet e vlerësimeve të brendshme nga NJSBC bëhen publike duke respektuar rreptësisht rregulloret për mbrojtjen e të dhënave personale. <i>GVJ konstaton se nuk ka raporte në Website.</i> Pyetësorët e përdorur për mbledhjen e informacionit nga studentët janë hartuar dhe zbatuar në përputhje me Rregulloren për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në UT, e cila përcakton detyrimin e çdo punonjësi për ruajtjen e konfidencialitetit edhe pas përfundimit të detyrës.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Rregullore për Sigurimin e Cilësisë</i></li> <li>• <i>Paketa e Instrumenteve të cilësisë</i></li> <li>• <i>Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen e të dhënave personale</i></li> <li>• <i>Manual i sigurimit të cilësisë</i></li> <li>• <i>Raport i NJSBC</i></li> <li>• <i>Raporti i NJSBC 2024-2025-Semestri I</i></li> <li>• <i>Raporti i NJSBC 2024-2025, Semestri II</i></li> <li>• <i>Rezultat e vlerësimit të paketës të instrumenteve të cilësisë</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Universiteti i Tiranës është akredituar institucionalisht për periudhën maksimale prej 6 vitesh (vendimi nr. 04, datë 27.01.2023). Brenda tij, Departamenti i Ekonomiksit ka të akredituar programin Master i Shkencave në: “Ekonomiks” gjithashtu për 6 vite (vendimi nr. 112, datë 20.10.2023). Ndërkohë, programi Bachelor në: “Ekonomiks” ndodhet në procesin e parë të akreditimit, ku rekomandimet e dalë nga ky proces do të përdoren për të përmirësuar më tej programin. Po ashtu, programi i doktoraturës në “Shkenca Ekonomike” (nënfusha Ekonomiks) do të përfshihet në procesin e akreditimit. Në përputhje me nenin 32 dhe 33 të Rregullores për Sigurimin e Cilësisë në UT, raportet e NJSBC për programet e studimit u komunikohen njësisive kryesore dhe bazë, si dhe strukturave ndihmëse akademike, administrative dhe studentëve. Më tej, njësitë bazë dhe kryesore hartojnë plane veprimi në përgjigje të gjetjeve dhe rekomandimeve që dalin nga pyetësorët periodikë dhe proceset e vlerësimit. Fakulteti i Ekonomisë reflekton mbi këto gjetje në analizat vjetore të Departamentit, duke i përfshirë si bazë për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së programeve.</p> <p><b>Referenca:</b></p>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Rregullore për Sigurimin e Cilësisë</i></li> <li>• <i>Raporti Vjetor i FEUT 2022-2023</i></li> <li>• <i>Shkresa përcjellëse e raportit vjetor 22-23</i></li> <li>• <i>Raporti Vjetor i FEUT 2023-2024</i></li> <li>• <i>Shkresa përcjellëse e raportit vjetor 23-24</i></li> <li>• <i>Raport Vjetor i Departamentit të Ekonomiksit 2023-2204</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Fakulteti i Ekonomisë ka ndërtuar një mekanizëm të rregullt për vlerësimin e veprimtarive mësimore, shkencore dhe marrëdhënieve me studentët, duke bashkëpunuar ngushtë me njësitë bazë dhe njësitë ndihmëse akademike. Rezultatet e këtyre proceseve përmbledhen në raportet vjetore të departamenteve dhe fakultetit, të cilat diskutohen dhe miratohen nga strukturat përkatëse dhe më pas integrohen në raportin vjetor të Universitetit të Tiranës. Vlerësimi dhe monitorimi realizohen përmes Paketës së Instrumenteve që mat efektivitetin e mësimdhënies, funksionalitetin e programit dhe performancën e pedagogëve. Ky proces synon të vlerësojë efektivitetin dhe impaktin real të masave të marra, duke shërbyer si bazë për përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit. Përditësimi i literaturës, integrimi i praktikave bashkëkohore në mësimdhënie, nxitja e inovacionit dhe forcimi i lidhjes me studentët janë elementë konkretë që reflektojnë ndikimin e drejtpërdrejtë të këtij mekanizmi.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Raporti Vjetor i FEUT 2022-2023</i></li> <li>• <i>Raporti Vjetor i FEUT 2023-2024</i></li> <li>• <i>Raport Vjetor i Departamentit të Ekonomiksit 2023-2024</i></li> <li>• <i>Paketa e Instrumenteve të Cilësisë</i></li> <li>• <i>Manual i sigurimit të cilësisë në UT</i></li> <li>• <i>Manual i vlerësimit të personelit akademik të UT</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të</p>	<p>Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamenti i Ekonomiksit kanë zhvilluar një praktikë të qëndrueshme informimi dhe ndërgjegjësimi të studentëve dhe stafit mbi proceset e sigurimit të cilësisë. Në kuadër të procesit të akreditimit, studentët janë informuar mbi rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre në vlerësimin e brendshëm të programit Bachelor në: “Ekonomiks”, krahas takimeve periodike mbi vlerësimin e pedagogëve dhe lëndëve. Këto aktivitete kanë synuar rritjen e</p>

<p>cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>ndërgjegjësimin mbi rolin aktiv të studentëve dhe stafit në përmirësimin e cilësisë së studimeve. Njësitë përgjegjëse për sigurimin e cilësisë, si KPPSC dhe NJSBC, kanë hartuar dhe shpërndarë planet e veprimit dhe planet vjetore, duke i kthyer këto dokumente në udhërrëfyes për përmirësim të vazhdueshëm. Paralelisht, institucioni organizon aktivitete akademike e profesionale që forcojnë cilësinë e mësimdhënies, si ftesa për profesorë të huaj për të mbajtur leksione me përmbajtje bashkëkohore dhe shkëmbimin e përvojave në metodat mësimore. Përmes programeve Erasmus+, studentët dhe stafi akademik kanë përfituar nga mundësitë e trajnimit dhe shkëmbimeve ndërkombëtare, duke ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e standardeve akademike dhe kërkimore.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Takim me studentët e vitit të parë 2023-2024</li> <li>• Plani i Veprimit për SC në UT 2024-2028</li> <li>• NJSCB aktiviteti</li> <li>• Aktivitete Projekti Jena Monnet Chair</li> </ul>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Politika dhe praktikat e transparencës në sigurimin e cilësisë në FEUT janë të konsoliduara dhe të harmonizuara me kuadrin ligjor e rregullator. Publikimi i dokumenteve dhe rezultateve në kanalet zyrtare garanton akses, barazi informacioni dhe transparencë të plotë për studentët dhe aktorët e interesuar. Publikimi i rezultateve të sigurimit të cilësisë në UT respekton standardet e etikës akademike dhe legjislacionit për të dhënat personale, duke siguruar transparencë, besueshmëri dhe mbrojtje të integritetit të studentëve dhe stafit. Institucioni ka krijuar një cikël të plotë reflektimi dhe përmirësimi, ku çdo vlerësim shoqërohet me plane konkrete masash për adresimin e mangësive dhe dobësive të evidentuara. Kjo qasje garanton jo vetëm përputhjen me standardet ligjore dhe rregullatore, por edhe përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit. Institucioni ka ngritur një sistem të qëndrueshëm dhe funksional për monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë, i cili jo vetëm identifikon mangësitë, por edhe siguron që masat e marra të kenë ndikim të matshëm në përmirësimin e programeve</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X



Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në: “Ekonomiks” ofruar nga Universiteti i Tiranës.**

**Pikat e forta dhe afirmime:**

- Departamenti i Ekonomiksit ka një eksperiencë të gjatë akademike, e cila ka ndikuar pozitivisht në ndërtimin e një programi studimi cilësor dhe të qëndrueshëm.
- Programi i studimit është hartuar në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe reflekton praktikën bashkëkohore të mësimdhënies në fushën e ekonomisë.
- Kurrikula është e strukturuar mirë, me një balancë të qëndrueshme midis lëndëve bazë, karakterizuese dhe ndërdisiplinore, duke pasqyruar zhvillimet më të fundit ekonomike dhe proceset e integritit evropian.
- Programi arrin të kombinojë teorinë me praktikën, duke nxitur zhvillimin e aftësive analitike, kërkimore dhe profesionale të studentëve.
- Staf i akademik ka përvojë të gjerë, kompetenca të larta profesionale dhe përfshirje aktive në kërkime shkencore, projekte dhe bashkëpunime ndërkombëtare që mbështesin cilësinë e programit.
- Fakulteti ofron infrastrukturë dhe mbështetje teknologjike bashkëkohore, përfshirë laboratorë, platformën “e-student” dhe bibliotekën fizike e online me literaturë të përditësuar.
- Institucioni garanton qëndrueshmëri financiare dhe organizative, si dhe mbështet kërkimin shkencor përmes fondeve dhe programeve të posaçme.
- Numri i moderuar i studentëve mundëson komunikim më të ngushtë me pedagogët dhe krijon një mjedis mësimor mbështetës e motivues.
- Programi ofron mundësi reale për përgatitje profesionale, përfshirë praktika, mobilitete, konkurse dhe konferenca që nxisin zhvillimin personal dhe orientimin drejt tregut të punës.

### **Pika të dobta:**

- Pjesëmarrja e studentëve në rishikimin dhe përmbajtjen e programeve të studimit mbetet e kufizuar. (në pyetësorë nuk ka rubrikë me pyetje për programin e studimit) **(Standardi V/5, kriteri 3)**
- Literatura e disa lëndëve nuk është përditësuar në ciklin e rekomanduar, duke ndikuar në përputhshmërinë me zhvillimet më të fundit të fushës. **(Standardi IV/3, kriteri 2)**
- Struktura e menaxhimit të cilësisë funksionon më shumë në formë ad-hoc dhe nuk ka rol të plotë aktiv në ndjekjen sistematike të instrumenteve të cilësisë. **(Standardi VI/1, kriteri 2)**
- Mungesa e ofertës së programit në gjuhën angleze kufizon mobilitetin ndërkombëtar të studentëve dhe potencialin për bashkëpunime akademike. **(Standardi IV/3, kriteri 1)**
- **Rekomandime:**
- Të forcohet roli dhe përfaqësimi i studentëve në jetën akademike dhe në proceset e përmirësimit të programeve të studimit, duke përfshirë në pyetësorin që u shpërndahet studentëve një rubrikë për vlerësimin e programit të studimit.
- Të rritet atraktiviteti i programit dhe lidhja e tij me tregun e punës përmes bashkëpunimeve dhe praktikave profesionale konkrete.
- Të zgjerohet ndërkombëtarizimi i programit përmes ofrimit të tij në gjuhën angleze dhe rritjes së mundësive për mobilitete ndërkombëtare.
- Të përmirësohet transparencja institucionale dhe komunikimi publik, si dhe të implementohet një platformë për kontrollin e plagjiaturës.
- Praktikave duhet t'u dedikohet një periudhë kohe e veçantë, pra të mos zhvillohen paralelisht me procesin mësimor dhe të zgjatet periudha e praktikës.
- Në skemën e vlerësimi të studentëve duhet të rishikohet, raporti i vlerësimit në mënyrë që të ketë më shumë peshë vlerësimi i vazhdueshëm përmes projekteve e detyrave të kursit, për ta bërë procesin e mësimdhënies më të lidhur me praktikën dhe me metodat inovative.
- Të përgatitet një Udhëzues specifik në nivel Fakulteti/Departamenti për përdorimin e metodave inovative.
- Institucioni duhet të përdorë mëkanizma promovues për mbështetjen e praktikave me performancë më të lartë.
- Rekomandohet përditësimi i literaturës me botime nga pesë vitet e fundit.

### **Strengths and Affirmations**

- The Department of Economics has extensive academic experience, which has positively contributed to the development of a high-quality and sustainable study program.

- The study program is designed in accordance with international standards and reflects contemporary teaching practices in the field of economics.
- The curriculum is well-structured, maintaining a sustainable balance between core, specialized, and interdisciplinary courses, and it reflects the latest economic developments and European integration processes.
- The program combines theory with practice, fostering the development of students' analytical, research, and professional skills.
- The academic staff have extensive experience, high professional competence, and active involvement in scientific research, projects, and international collaborations that support the quality of the program.
- The faculty provides modern infrastructure and technological support, including laboratories, the "e-student" platform, and both physical and online libraries with up-to-date literature.
- The institution ensures financial and organizational sustainability and supports scientific research through dedicated funds and programs.
- The moderate number of students allows closer communication with lecturers, creating a supportive and motivating learning environment.
- The program offers real opportunities for professional development, including internships, mobility programs, competitions, and conferences that encourage personal growth and orientation toward the labor market.

### **Weaknesses**

- Student participation in the review and development of study program content remains limited. **(Standard V/5, criterion 3)**
- The literature for some courses has not been updated within the recommended cycle, affecting alignment with the latest developments in the field. **(Standard IV/3, criterion 2)**
- The quality assurance structure operates mostly on an ad-hoc basis and does not play a fully active role in the systematic monitoring of quality instruments. **(Standard VI/1, criterion 2)**
- The absence of the program in the English language limits students' international mobility and reduces potential for academic collaborations. **(Standard IV/3, criterion 1)**

## **Recommendations:**

- The role and involvement of students in academic life and in the improvement processes of the study program should be strengthened, including a section in the student questionnaire dedicated to the evaluation of it.
- The program's attractiveness and alignment with the labor market should be improved through concrete collaborations and professional internship opportunities.
- Internationalization of the program should be expanded by offering it in English and by increasing opportunities for international mobility.
- Institutional transparency and public communication should be improved, and a plagiarism detection platform should be implemented.
- Internships should be allocated for a dedicated period, rather than being conducted in parallel with the teaching process, and their duration should be extended.
- The student assessment scheme should be reviewed so that continuous assessment through projects and coursework carries greater weight, making the teaching process more practice-oriented and aligned with innovative methods.
- A specific Faculty/Department-level Guideline should be developed for the use of innovative teaching methods.
- The institution should employ promotional mechanisms to support and encourage best-performing practices.
- It is recommended that the literature be updated with publications from the last five years.



**Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
<b>I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				<b>X</b>
<b>II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR</b>				<b>X</b>
<b>III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT</b>				<b>X</b>
<b>IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				<b>X</b>
<b>V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE</b>				<b>X</b>
<b>VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR</b>				<b>X</b>
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				<b>X</b>

